

**Banka Popullore e Republikës së
Maqedonisë së Veriut**



Raporti vjetor i vitit 2020

Shkup, prill 2021

Përmbajtja

Fjala e guvernatorit.....	4
I. Politika monetare në vitin 2020.....	11
1.1. Qëllimet e politikës monetare.....	11
1.2. Pozicionimi i politikës monetare.....	12
II. Ambienti ndërkombëtar	16
III. Zhvillimet makroekonomike në vitin 2020	21
3.1. PBB dhe inflacioni	21
3.2. Tregu i punës	24
3.3. Financat publike.....	27
3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm	30
3.5. Agregatet monetarë dhe kreditorë.....	36
3.5.1. Agregatet monetar	36
3.5.2. Aktiviteti kreditues.....	38
IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2021 dhe 2023.....	41
V. Instrumentet monetare.....	44
Shtojca 1. Zhvillimet në tregun valutor dhe ndërhyrjet e Bankës Popullore.....	47
2. Zhvillimet në tregut ndërbankar të depozitëve të pasiguara dhe tregu dytësor i letrave në vlerë	50
VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore	53
6.1. Gjendja dhe ndryshimi i rezervave valutore	53
6.2. Kushtet e tregjeve ndërkombëtare financiare dhe qasje aktive në investimet e rezervave valutore	54
6.3. Struktura e rezervave valutore	55
6.4. Rezultatet nga menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore.....	56
Shtojca 3. Përsosja dhe ngritja profesionale e kapacitetit institucional	58
VII. Shërbimet pagesore dhe sistemet e pagesave.....	59
7.1. Harmonizim i legjistacionit kombëtar me atë evropian	59
7.2. Qarkullimi pagesor i realizuar me instrumente të pagesave jo të gatshme.....	60
7.2.1 Transferet kreditore.....	61
7.2.2 Kartelat pagesore	61
7.3. Infrastruktura pagesore.....	62
7.4. Sistemet e pagesave në vend.....	64
7.5. Mbikëqyrja e sistemit të pagesave në pajtim me standardet ndërkombëtare të pranuar.....	64

VIII.	Lëshimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut- operacionet e thesarit.....	66
8.1.	Paratë e lëshuara në qarkullim	66
8.2.	Furnizimi i bankave dhe qendrave të parasë me kartëmonedha dhe monedha.....	68
8.3.	Përpunimi dhe shkatërrimi i kartëmonedhave dhe monedhave	68
8.4.	Eksperizë për paratë e dyshimta /të falsifikuara	68
8.5.	Kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kritereve për punë me para në dorë te bankat dhe qendrat e parasë	70
8.6.	Shitja e monedhave për qëllime koleksionimit.....	70
IX.	Auditimi i brendshëm.....	71
X.	Menaxhimi me resurset njerëzore	72
XI.	Realizimi i Programit për punën për vitin 2020	74
	Qëllimi strategjik 1 - Ruajtja e stabilitetit të çmimeve përmes kursit stabil të denarit kundrejt euros.....	74
	Qëllimi strategjik 2 - Ruajtja e sistemit stabil dhe të sigurt bankar, si parakusht themelor për stabilitetin financiar dhe rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit.....	76
	Shtojca 4 Përmirësimi i rregullores me qëllim harmonizimin me dispozitat e rregullores evropiane për kërkesat kapitale dhe për efikasitetin e analizave të sistemit bankar dhe stabilitetit financiar	76
	Qëllimi strategjik 3 - Ruajtja dhe menaxhimi i rezervave valutore në përputhje me parimet e sigurisë dhe likuiditetit dhe sigurimi i kthimit optimal.....	80
	Qëllimi strategjik 4 - Rritja e efikasitetit të sistemit të furnizimit dhe përpunimit të kartëmonedhave dhe monedhave dhe rritja e cilësisë dhe funksionalitetit të parave të gatshme në qarkullim.....	80
	Qëllimi strategjik 7 - Nxitja dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i veprimtarisë hulumtuese në fushat që janë vendimtare për arritjen efikase të qëllimeve të Bankës Popullore.....	82
11.1.	Marrëdhëniet me publikun, bashkëpunimin me institucionet vendore dhe huaja, punë botuese	86
11.2.	Edukim dhe inkluzion financiar	87
11.3.	Aktivitet e muzeut, bibliotekës dhe arkivit	88
11.4.	Strategjia dhe preventiva	88
11.5.	Aktivitete të tjera të korporatës.....	90
	Qëllimi strategjik 11 - Ruajtja e sistemi dhe përmirësimi i tij në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare	91

Fjala e guvernatorit

Të nderuar,

Nuk ka dyshim se viti i kaluar ishte një vit i kthesës dramatike në të gjitha sferat e jetës - ndoshta viti më i vështirë për ekonominë globale që nga depresioni global i viteve 30-ta të shekullit të kaluar. Me fillimin e pandemisë dhe miratimin e masave për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe parandalimin e përhapjes së saj, të gjithë ne, përfshirë edhe bartësit e politikave, jemi përballur me një sfidë të madhe. Prandaj, është e pashmangshme që pas një distancë të caktuar kohore të shikojmë prapa dhe të shohim se si ia dolëm.

Pas më shumë se një viti pas fillimit të krizës globale, të dhënat tregojnë se në kuadër të kompetencave tona, në mënyrë të duhur i jemi përgjigjur sfidës së deritanishme. Nga njëra anë, duke i realizuar me sukses synimet dhe objektivat tona ligjore, që janë kontribut kyç për arritjen e qëndrueshmërisë së përgjithshëm makro-ekonomike. Në anën tjetër, me miratimin e masave dhe vendimeve të duhura e dhamë maksimumin tonë për të mbështetur ekonominë e Maqedonisë në ballafaqimin e tronditjes nga pandemia.

Por kriza e koronës edhe një pohoi se nuk është gjithmonë e rëndësishme vlerësimi i mirë i efekteve nga masat dhe vendimet e bartësve të politikave, por edhe koha e tyre. Ashtu si edhe bankat e tjera qendrore, ne iu përgjigjëm shpejt kësaj krize duke lehtësuar politikën monetare dhe duke vendosur fleksibilitet rregullator, që ndër të tjerat stimuluam anulimin e përkohshëm për pagesën e kredive nga qytetarët dhe kompanitë e prekura nga pandemia. Ky reagim kontribuoi në ruajtjen e kushteve të favorshme financiare, në ruajtjen e ciklit kreditor të sistemit bankar, në lehtësimin e barrës financiare të sektorëve të prekur, që ishte e jashtëzakonshme për tejkalimin e valës së parë të krizës.

Lehtësimi i politikave u mundësua nga hapësira e ndërtuar më parë, e dukshme përmes inflacionit mesatar dhe nivelit komod të rezervave valutore. Megjithatë, kriza solli me vete një pasiguri të madhe, e cila imponoi nevojën për të ndërmarrë hapa që për një ekonomi të vogël dhe të hapur, me kurs fiks valutë, do të siguronin garanci për qasje të shpejtë dhe të lehtë në likuiditetin valutë në rast të ndonjë shtrëngimi të të shpejtë të kushteve financiare globale. Prandaj, si bankë qendrore, nisëm një iniciativë rajonale e cila u mbështet nga të gjitha bankat qendrore në rajonin e Ballkanit Perëndimor për huazimin e likuiditetit në euro nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). BQE-ja iu përgjigj pozitivisht kërkesës sonë, që është sinjal i njohjes së kapacitetit të Bankës Popullore për udhëheqjen e politikave të duhura dhe për bazat e mira të ekonomisë. Deri më tani, këto mjete nuk janë shfrytëzuar, por gjithsesi ofrojnë hapësirë shtesë për veprime të duhura nëse e kërkon kriza ndërsa repo-linja është e vlefshme deri në mars të vitit të ardhshëm.

Në përgjithësi, nga distanca kohore prej më shumë se një viti, realizimet tregojnë se si bankë qendrore në mënyrë përkatëse jemi përgjigjur ndaj valës akute të pandemisë dhe kemi kontribuar për uljen e dëmeve ekonomike, që në fakt është vërejtur edhe në vlerësimet e raporteve të të gjitha institucioneve relevante ndërkombëtare financiare. Kuptohet, edhe për këto vlerësime si dhe për mjedisin e përgjithshëm ekonomike, është kyçe që i realizuam edhe synimet e tona elementare ligjore. Qëndrueshmëria e çmimeve është mbajtur, me normë mesatare dhe të ulët të inflacionit, që vitin e kaluar ishte 1,2% mesatarisht. Edhe krahas presioneve afatshkurtra të tregut valutë,

para se gjithash për shkak të ofertës më të vogël të valutave, kursi valutor i denarit në raport me euron mbeti i qëndrueshëm ndërsa rezervat valutore edhe më tej shënon rritje duke mbetur në zonën komode. Gjithashtu, edhe krahas krizës, por edhe sfidave të tjera me të cilat u ballafaquam vitin e kaluar si bankë qendrore, sistemi bankar ka ruajtur dhe përmirësuar treguesit për punën e tij. Sipas të dhënave për sistemin bankar, përfshirë fundin e vitit të kaluar, norma e përshtatshmërisë së kapitalit është rritur, likuiditeti tradicionalisht qëndron në nivel solid ndërsa cilësia e portolios kreditorë është përmirësuar. Këto janë vetëm një pjesë e të dhënave- treguesve kyç ku bazohet vlerësimi për qëndrueshmërinë e sistemit bankar, që e vërteton rezistencën ndaj goditjeve.

Duke e shikuar vitin që lamë pas, nuk mundem e të mos them se, sikur edhe në episodet e mëhershme të krizës, jemi ballafaquar edhe me spekulime dhe informacione të pasakta, që në periudhë kur shprehet ndjeshmëria në sektorin real, mund të kenë pasoja afatgjate për ekonominë, në raport me valutën vendore dhe sistemin bankar. Por, me raportin transparent me publikun, me reagimet në kohë dhe marrjen e masave të duhura, është arritur informim objektiv për opinionin dhe qëndrueshmëri të pritjeve të tregut.

Krahas gjithë këtyre aktiviteteve për përballimin e pasojave ekonomike të pandemisë, me sakrificën dhe angazhimin e ekipit të institucionit, në vitin 2020 vazhduam të punojmë në projektet tona zhvillimore. Duke pasur parasysh sfidat e digjitalizimit, të cilat janë bërë më të theksuara me krizën aktuale, veçanërisht gëzon fakti që gjatë vitit ka pasur interes për Portën e inovacioneve– platformë për komunikim me sektorin- fintek, të cilën e kemi krijuar në fund të vitit 2019. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të mbështesim dhe inkurajojmë zhvillimin e inovacioneve në fushën e shërbimeve dhe produkteve financiare. Prandaj, më vjen mirë që përmes tij mund të komunikojmë me të gjitha kompanitë që zhvillojnë apo zbatojnë inovacione në sferën financiare dhe njëkohësisht përdorin teknologji të reja për të gjitha çështjet dhe dilemat që lidhen me rregulltivën që prek sektorin- fintek si dhe për të gjitha propozimet në këtë sferë.

Më mbështetjen nga Fondi Evropian për Evropën Juglindore (FEEJ), vitin e kaluar zbatuam Anketën për zhvillimin e sektorit- fintek në vend. Rezultatet e Anketës do të shërbejnë si bazë për diskutime më të hollësishme me institucionet financiare, rregullatorët dhe palët tjera të interesuara për shkak të ndërmarrjes së aktiviteteve të mëtutjeshme për mbështetjen e zhvillimit të shërbimeve inovative financiare. Një nga aktivitetet kyç për këtë qëllim do të jetë përpunimi i Strategjisë nacionale për mbështetjen e zhvillimit të sektorit- fintek, që planifikohet për këtë vit. **Njëkohësisht, për shkak të ndjekjes së risive në fushën e digjitalizimit, përfaqësuesit e Bankës Popullore u përfshinë në punën e rrjetit të inovacionit (ang. Innovation Hub) të Bankës për Nivelizim Ndërkombëtar (BNN),** ku shqyrtohen çështjet për të ardhmen e botës financiare, siç është lëshimi i valutave digjitale nga bankat qendrore) (ang. CDBC – central bank digital currencies), tokenizimi gjatë financimit të gjelbër, ndjekja e zhvillimit të “monedhave të qëndrueshme globale”. (ang. stablecoins).

Gjithashtu, bëmë përpjekje edhe në projekte tjera të rëndësishme për përparimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve tona institucionale. Jemi në mesin e bartësve të hulumtimeve statistikore të cilët jo vetëm që nuk u ndërprejnë në periudhën e deritanishme të krizës, por edhe u bënë përmirësime metodologjike dhe u vendosën të dhëna të reja dhe të hollësishme. Përndryshe, kah fundi i vitit, për herë të parë publikuam të dhëna për statistikën e llogarive financiare, si një nga statistikatat më komplekse. Në këtë mënyrë, vazhdojmë me përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe obligimeve që i morën para dy viteve kur u bëmë vendi i 18-të në botë, që e plotëson standardin më të lartë statistikor të FMN- SDDS plus. Kah fundi i vitit organizuam edhe punëtori për vendet e Evropës Juglindore, lidhur me sfidat e statistikës

që i imponoi pandemia me Covid 19. Realizimet në këtë segment janë jashtëzakonisht të rëndësishme, pasi çdo ditë rritet nevoja për më shumë të dhëna granulare dhe ato, në periudhën e më tutjeshme, do të mund t'i sigurojnë vetëm bartësit e hulumtimeve statistikore që janë të gatshëm t'i ndjekin standardet dhe praktikat e reja.

Gjithashtu, vitin e kaluar, kemi punuar edhe mbi Strategjinë e parë për edukim dhe inkluzion financiar ndërsa theksim e vendosëm edhe në promovimin e konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorëve, nëpërmjet memorandumit të lidhur për bashkëpunim me Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës, i drejtuar në përparimin e këmbimi të të dhënave dhe informacioneve lidhur me konkurrencën në sektorin bankar. Në të njëjtën kohë, u përforcuan aktivitetet e Bankës Popullore për bashkëpunim me sektorin civil në fushën e edukimit financiar, inkluzionit financiar dhe mbrojtjes së konsumatorëve të shërbimeve financiare dhe produkteve. Zhvillimi i një bashkëpunimi të tillë për shkak të njohurive më të larta financiare dhe përfshirjes më të madhe financiare të popullsisë, si dhe informacionit më të madh të saj nga këndvështrimi i konsumit, është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Andaj, në këtë mënyrë arrihen rezultate edhe më të dukshme me qasje më të madhe të njohurive tek shumica e popullsisë, të cilat janë të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të stabilitetit financiar dhe zhvillimin e ekonomisë në tërësi.

Sidomos është e rëndësishme që, gjatë vitit 2020, vazhduan edhe përpjekjet tona për afrim më të shpejtë drejt familjes evropiane të bankave qendrore. Në këtë mënyrë, e lidhëm Marrëveshjen për bashkëpunim me BQE në sferën e mbrojtjes së bankënotave në euro nga falsifikimi. Me këtë u realizua edhe një hap në plotësimin e rekomandimeve nga raporti i Komisionit Evropian dhe u vërtetua përcaktimi jonë strategjik për hapërimin drejt rrugës së sistemit evropian të bankave qendrore. Në kontekstin e këtij përcaktimi strategjik, veçanërisht ishte e rëndësishme që gjatë vitin të kaluar vazhdoi edhe Twinning projekti "Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore në rrugën e anëtarësisë të saj në sistemin evropian të bankave qendrore", i financuar nga BE-ja, që me sukses përfundoi këtë vit me disa rezultate të realizuara, në fushën e sistemeve pagesore, supervizionit, statistikës dhe aktivitetit hulumtues.

Këto janë vetëm një pjesë e projekteve të realizuara. Një pjesë e projekteve, mes të cilave edhe ato për përforcimin e më tutjeshëm të qëndrueshmërisë financiare si dhe Ligji i ri për shërbime dhe sisteme pagesore ku punuam bashkë me Ministrinë e Financave, pritet të japin rezultate që do të ishin investim në ekonominë e Maqedonisë.

Të nderuar,

Vitin e kaluar, kriza na kujtoi rëndësinë e mësimave të nxjerra që duhet t'i mbajmë gjithmonë me vete. Është e rëndësishme që në kohëra të mira të bëjmë politika të shëndosha përmes të cilave do të përforcohet hapësira për reagim, kur është e nevojshme të sigurohet mbështetje për ekonominë. Asnjë sfidë nuk mund të përballohet në mënyrë përkatëse pa ekipe të ndërtuara, profesionale dhe të përkushtuara. Krizat janë shpesh katalizatorë për procese të caktuara. Kjo krizë ka vënë në një "shirit të shpejtë" procesin e digjitalizimit të ekonomive dhe shoqërisë në tërësi, ndaj të cilës sigurisht duhet të përshtatemi në mënyrën e duhur.

Na gëzon fakti që rezultatet e arritura vërtetojnë se Banka Popullore me politikat e saj para krizës mundësoi hapësirë për reagim të duhur edhe në kohë të tilla të vështira, duke vërtetuar profesionalizmin, përkushtimin dhe gatishmërinë e ekipit të saj. Ndërsa ky ekip është i gatshëm të kontribuojë në proceset që do të duhet të zhvillohen për të arritur më shpejt perspektivat për ekonominë tonë.

Por nuk duhet të ndalemi vetëm në atë që është arritur deri tani. E kundërta. Ne jemi të gatshëm dhe të vendosur të punojmë shumë më tepër duke ndjekur standardet më të fundit dhe më të larta dhe praktikatat më të mira në bankingun qendror dhe në këtë periudhë të pasigurisë globale. Ne i ndjekim me shumë kujdes zhvillimet dhe rreziqet potenciale nga rrethi dhe efektet e tyre në ekonominë vendase dhe gjithmonë do të jemi të përkushtuar në kuadër të kompetencave tona që të japim maksimumin për ekonominë e Maqedonisë në ballafaqimin e krizës aktuale.

28 prill 2021
Shkup

Guvenator
dhe kryesues i Këshillit të
Bankës Popullore
dr. Anita Angellovska - Bezhoska

Pasqyrë e shkurtër e zhvillimeve makroekonomike në vitin 2020

Në nivel global, viti 2020 do të mbahet mend për një nga recesionet më të mëdha në botë, të shkaktuar nga faktorë të jashtëzakonshëm joekonomikë – pandemia e koronavirusit. Kriza shëndetësore, si një përvojë specifike në historinë më të re ekonomike, ka vendosur nevojën e rritjes së mbrojtjes së shëndetit publik dhe futjen e masave për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të virusit, të cilat kanë pasur një ndikim të fortë në ekonominë globale dhe ekonomitë kombëtare individuale, sipas shkallën në të cilën janë prekur nga virusi dhe masat mbrojtëse që i kanë aplikuar. Rënia më e madhe u shënua në tremujorin e dytë, e cila u shoqërua me masat më të rrepta të mbrojtjes, me ndikim të fortë në ekonomi. Lehtësimi gradual i masave gjatë gjithë vitit, së bashku me masat stimuluese të politikave makroekonomike, patën një ndikim të duhur pozitiv në ecurinë ekonomike. Megjithatë, gjatë vitin 2020 **ekonomia globale përjetoj një rënie prej 3.5%, e cila vlerësohet si recesioni më i madh global që nga Depresioni i Madh të vitit 1930.** Bartësit e politikës makroekonomike në mbarë botën në vitin 2020 u përballën me një situatë të jashtëzakonshme që kërkonte një përgjigje urgjente për të mbështetur ekonomitë për ballafaqimin me pasojave të krizës së koronës. Paraqitja e një vale të re të virusit në fund të vitit dhe mutacionet e virusit paraqesin rreziqe në rënie për perspektivat e rimëkëmbjes ekonomike në vitin 2021, ndërkohë që vaksinat e zbuluara dhe procesi i nisur i vaksinimit në shumë vende duket inkurajuese në këtë pikëpamje.

Ekonomia e Maqedonisë nuk ka devijuar nga trendet botërore, duke pasur parasysh paraqitjen e infeksionit në muajt e parë të vitit dhe masat parandaluese të ndërmarra. Pavarësisht rënies së PBB-së në tremujorin e dytë (14.9%), në gjysmën e dytë të vitit rënia ka qenë më e vogël dhe gjatë gjithë vitit është shpërndarë ndërmjet aktiviteteve të ndryshme ekonomike, duke treguar fuqinë dhe shpërndarjen e tronditjes. Funkionimi i çrregulluar i zinxhirëve globalë të prodhimit edhe më shumë është shfaqur në realizimet ekonomike dhe eksportit. Megjithatë, si rezultat i përshtatjes së shpejtë të kompanive me kushtet e reja të imponuara të punës, ndryshimeve në zakonet e popullsisë, lehtësimit gradual të masave mbrojtëse, si dhe masat stimuluese të politikave, **në vitin 2020 pati një rënie të PBB-së prej 4.5. %**, që ishte në përputhje me pritjet e Bankës Popullore. Nga aspekti i komponentëve strukturorë, rënia u kushtëzua nga zvogëlimi i konsumit me kontribut pozitiv vetëm në konsumin publik, kundrejt kontributit pozitiv të neto-eksportit.

Në sektorin e jashtëm, deficiti i llogarisë rrjedhëse mbeti në një nivel mesatar prej 3.5% të PBB-së, ngjashëm me vitin e kaluar, me një deficit më të ulët në këmbimin e mallrave. Në fakt, pandemia dhe masat restriktive për parandalimin e infeksionit kanë ndikuar negativisht në të dyja anët e tregtisë së jashtme, ku rënia e importit ka qenë më e madhe në raport me rënien e eksportit. Në të njëjtën kohë, ka pasur një deficit më të ulët në të ardhurat primare dhe një suficit më të lartë të shërbimit. Këto efekte u neutralizuan plotësisht nga flukset hyrëse neto më të ulëta në bazë të të ardhurave dytësore, **me ulje të ndjeshme të hyrjeve neto nga mjetet e huaja valutore të blera në tregun këmbimor.** Ndryshe nga situatat e tjera të krizës, në këtë segment të tregut këtë herë nuk ka pasur presione më të larta nga kërkesa për valutë, në kushtet e rënies së ofertës për valutë, gjë që reflekton kryesisht faktin se shumica e të ardhura vijnë në para të gatshme nga mërgimtarët. Në fakt, kushtet që i kushtëzoi pandemia me mbylljen e kufijve, lëvizjen e kufizuar, uljen e aktivitetit ekonomik dhe punësimeve të shumë vende kanë ndikuar negativisht në të ardhurat e disponueshme dhe mundësinë për të dërguar pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të mërgimtarëve prapa në ekonominë amë. Vlen të

përmendet rritja e remitançave përmes kanaleve zyrtare, edhe pse ato ende përbëjnë një pjesë më të vogël të transfereve totale private.

Banka Popullore e kapërceu krizën nga pandemia me një nivel të përshtatshëm të rezervave valutore, të cilat në vitet paraprake shënonte rritje të vazhdueshme, gjatë blerjes së lartë relative të tregut valutë. Gjithashtu, gjatë vitit 2020 janë realizuar flukse hyrëse nga huamarrja e shtetit nga vendet e jashtme për sanimin e pasojave të krizës. Rezervat valutore shënuan rritje vjetore, pavarësisht shitjes neto të valutës në tregun valutë, e cila u ngadalësua ndjeshëm gjatë gjysmës së dytë të vitit, në përputhje me zhvillimet më të favorshme në ekonomi, veçanërisht në segmentin e eksporteve. Është e rëndësishme të theksohet se në vitin 2020 ka pasur hyrje neto nga investimet e huaja direkte, por në një shkallë më modeste.

Niveli i përshtatshëm i rezervave valutore, së bashku me inflacionin mesatar të ulët, i cili në vitin 2020 arriti në 1.2% vjetore, mundësoi reagim të shpejtë dhe në kohë ndaj politikës monetare, si përgjigje të pasojave të pandemisë, për ruajtjen dhe stimulimin e flukseve kreditore dhe rrjedhimisht përkrahje të ekonomisë. Që në muajt e parë të pandemisë, Banka Popullore gradualisht uli normën e interesit, ndërsa u ndërmorën masa për rritjen e likuiditetit të sistemit bankar përmes zvogëlimit gradualisht të ofertave të boneve të thesarit dhe zgjerimi i listës së letrave me vlerë të pranueshme si instrument për sigurimin e likuiditetit në denarë për bankat. Me riaktivizimin e masës për uljen e bazës së rezervës së detyrueshme, këtë herë për kreditë për sektorët më të prekur nga pandemia, si dhe ndryshimet rregullatore me të cilat u mundësua fleksibilitet më të madh të bankave në procesin e kreditimit, u sigurua përkrahje për aktivitetet kredituese të bankave. Rrjedhimisht, duhet përmendur që në një vit jashtëzakonisht kompleks, depozitat dhe kreditë e bankave të sektori privat vazhdojnë akoma të rriten. Totali i depozitave u rrit për 5.7%, ku kontribut më të madh kanë depozitat e transaksioneve, duke reflektuar pjesërisht efektin e kufizimeve të konsumit të imponuara nga pandemia, ndërsa totali i kredive u rrit për 4.7% në vit.

Në përgjithësi, viti 2020 ishte një vit i pandemisë, ku në një mjedis të vështirë, Banka Popullore me reagim në kohë, ndërmarrja e masave të duhura dhe përforcimi i komunikimit me opinionin kontribuoi në realizimin e suksesshme të qëllimeve të saja dhe stabilizimin e pritjes së tregut. Reagimi i shpejtë dhe në kohë i politikës monetare dhe bashkërendimi me politikën fiskale si përgjigje të krizës globale ka zbutur ndikimin në sektorin real. Madje, edhe një herë u konfirmua se hapësira që ndërtohet në kohë të mira duke ndjekur politika të shëndetshme dhe të qëndrueshme, lë mundësinë për veprime të duhura kur nevojitet. Edhe përkundër rigjallërimit të pritshëm në vitin 2021, gjatë vitit 2022 pritet rikuperim i plotë dhe kompensim i humbjeve ekonomike, gjë që tregon nevojën për monitorim të kujdesshëm të zhvillimeve makroekonomike dhe rregullime të duhura të politikave në periudhën e ardhshme.

Treguesit bazë ekonomike për ekonominë e Maqedonisë.

ndryshimet vjetore, në %	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Sektori real													
Prodhim i brendshëm *	5,5	-0,4	3,4	2,3	-0,5	2,9	3,6	3,9	2,8	1,1	2,9	3,2	-4,5
Inflacioni	8,3	-0,8	1,6	3,9	3,3	2,8	-0,3	-0,3	-0,2	1,4	1,5	0,8	1,2
Norma e papunësisë	33,8	32,2	32,1	31,4	31,0	29,0	28,0	26,1	23,7	22,4	20,7	17,3	16,4
Sektori i jashtëm													
Bilanci në llogarinë rrjedhëse (% të PBB)	-12,7	-6,8	-2,0	-2,5	-3,2	-1,6	-0,5	-2,0	-2,9	-1,0	-0,1	-3,3	-3,5
Bilanci tregtar (% të PBB)	-28,6	-25,8	-21,6	-25,2	-26,5	-22,9	-21,7	-20,1	-18,8	-17,8	-16,2	-17,6	-16,8
Investimet direkte të huaja (% të PBB)	6,0	2,0	2,2	4,6	1,7	2,8	2,3	2,2	3,3	1,8	5,6	3,2	1,9
Borxhi i jashtëm bruto (% të PBB)	48,8	55,9	57,8	64,2	68,2	64,0	70,0	69,3	74,7	73,4	73,0	72,7	80,2
Bruto rezervat valutore (në milionë EUR)	1.494,9	1.597,5	1.714,5	2.068,9	2.193,3	1.993,0	2.436,5	2.261,8	2.613,4	2.336,3	2.867,1	3.262,6	3.359,9
Sektori monetar													
Pesha e parave (M4)	11,8	5,7	12,1	9,5	4,4	5,2	10,6	6,9	6,2	5,1	11,8	9,3	6,9
Gjithsej kredite	34,4	5,2	7,0	8,4	5,6	6,6	10,0	9,6	6,5**	5,4	7,3	7,6**	4,7
Gjithsej depozita (me depozita në para)	8,9	17,8	12,8	9,1	4,4	5,4	10,5	6,4	6,1	5,0	12,1	9,0	5,7
Sektori fiskal													
Saldoja buxhetore (% të PBB)	-0,9	-2,6	-2,4	-2,5	-3,8	-3,8	-4,2	-3,5	-2,7	-2,7	-1,8	-2,0	-8,1
Borxhi publik (% të PBB)	23,0	26,2	27,2	32,0	38,3	40,3	45,8	46,6	48,8	47,7	48,4	49,4	60,2
Sektori bankar													
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (%)	16,2	16,4	16,1	16,8	17,1	16,8	15,7	15,5	15,2	15,7	16,5	16,3	16,7
Kreditet jofunksionale në sektorin jofinanciar/bruto kreditet (%)	6,8	9,1	9,3	9,9	10,5	11,5	11,3	10,8	6,6	6,3	5,2	4,8	3,4
Aktiva likuide / aktiva totale (%)	22,9	25,6	30,9	31,2	32,4	31,2	29,8	28,2	28,9	27,1	26,7	26,9	23,3

Burimi: BPRMV, ESHS, Ministria e Financave .

* Të dhënat paraprake për vitin 2019, të dhënat e vlerësuara për vitin 2020.

** E korrigjuar për shlyerjet.


I. Politika monetare në vitin 2020

1.1. Qëllimet e politikës monetare


Ruajtja e stabilitetit të çmimeve paraqet objektivin themelor ligjor të politikës monetare të Bankës Popullore. Një objektivi tjetër, në varësi të qëllimit kryesor, është të kontribuojë në mbajtjen e një sistemi të qëndrueshëm, konkurrues dhe financiar të orientuar drejt tregut. Banka Popullore e mbështet politikën e përgjithshme ekonomike pa rrezikuar arritjen e qëllimit bazë dhe në përputhje me parimin e një ekonomie të tregut të hapur me konkurrencë të lirë. Në aspekt strategjik, nga tetori i vitit 1995 e deri më vitin 2001 e aplikon strategjinë e ruajtjes së stabilitetit të kursit të këmbimit nominal të denarit në raport me markën gjermane dhe më pas në raport me euron.

Nisur nga këto dispozita ligjore dhe rrethanat specifike për shkak të krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19, Banka Popullore gjatë vitit 2020 ka përshtatur politikën monetare për të siguruar vazhdimësi në arritjen e synimeve të definuara ligjore. Objektivat e politikës monetare u arritën me sukses, gjë që vërehet përmes ruajtjes së mëtejshme të stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit të kursit të këmbimit. Rezervat valutore shënuan rritje vjetore dhe mbetën në nivelin e duhur në zonën e sigurt. Për sa i përket stabilitetit të çmimeve, në vitin 2020 u arrit një rritje vjetore e mesatare e çmimeve vendore, në kushtet e lëvizjes së mëtejshme rënëse të çmimeve të energjisë dhe rritjes mesatare të komponentit të ushqimeve dhe inflacionit bazë. Në vitin 2020, stabiliteti financiar u ruajt me sukses, si mbështetje shtesë në arritjen e qëllimit themelor. Me një nivel komform të rezervave valutore dhe mungesë të presioneve inflacioniste, Banka Popullore vazhdoi të lirojë politikën monetare gjatë vitit 2020, për të zbutur efektet e goditjes së fortë negative në ekonominë e vendit, të shoqëruar me përhapjen e shpejtë të infeksionit të virusit Covid. -19.

Grafikoni 1
Hendeku i prodhimit dhe inflacioni *




Grafikoni 2
Rezervat valutore bruto




* Hendeku i prodhimit paraqet indikatorin për gjendjen ciklike të ekonomisë dhe përlogaritët si raport në mes të shmangies së PBB së realizuar nga PBB potenciale dhe nivelit të PBB potencial, $(\text{hendeku i prodhimit} = (\text{PPB i realizuar} - \text{PBB potencial}) / \text{PBB potencial})$. Inflacioni i përgjithshëm bazë paraqet ndryshimin mesatar vjetor (në %).

Grafikoni 3
Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore



Grafikoni 4
Treguesit e zgjedhur për stabilitetin financiar



* Sipas rregullës së Grinspan dhe Gvidoti (Greenspan-Guidotti rule) është e nevojshme që vendi të ruaj mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimi rezidual) me rezervat valutore .

** Aktivi likuid përbëhet nga aktivi me likuiditet më të lartë dhe depozitave afatshkurtra të afatizuara te bankat e huaja. Aktivi gjithsej nuk i inkorporon mjetet te bankat vendore.

*** Treguesi u referohet kredive të sektorit financiar dhe jofinanciare, me çka të dhënat për vitin 2016 i përfshinë ndryshimet nga rregullatorëve.
Burimi: BPRMV dhe ESHS

1.2. Pozicionimi i politikës monetare

Banka Popullore e liroi politikën e saj monetare gjatë vitit 2020, për shkak të zbutjes së pasojave negative të pandemisë Covid-19. Gjatë vitit 2020, Banka Popullore uli në tre raste normën bazë të interesit, duke e ulur atë në nivelin më të ulët historik prej 1,5%¹, në të njëjtën kohë e zvogëloi shumën e ofruar të boneve të thesarit për 15.000 milionë denarë. Gjithashtu, përsëri u zbatuan masa jostandarde e rezervës së detyrueshme, e cila mundësoi zvogëlimin e bazës për rezervën e detyrueshme në denarë të bankave komerciale për shumën e kredive të reja të miratuara dhe të ristrukturuara të dhëna për ndërmarrjet në aktivitete që janë më të prekura nga përhapja covid-19. Në të njëjtën kohë, në gusht 2020, Banka Popullore riaktivizoi ankandet e depozitave në valutë, gjë që në kushtet e pasigurisë në tregjet ndërkombëtare, u jep mundësi bankave në vend të vendosin një pjesë të mjeteve të tyre valutore në instrumente të sigurta dhe afatshkurte të bankës qendrore. Vendosja e tillë e politikës monetare ka kontribuar në mbështetjen e flukseve të kredisë në ekonomi dhe në rritjen e likuiditetit në sistemin bankar, me një nivel solid të rezervave valutore dhe mungesë të presioneve inflacioniste. Totali i depozitave dhe kredive vazhdojnë të rriten me bazë vjetore, pavarësisht pasigurisë pandemie në rritje. Banka Popullore me kujdes i monitoron treguesit dhe rreziqet potenciale nga mjedisi i jashtëm dhe i brendshëm, në mënyrë që të përshtatë në mënyrë adekuate vendosjen e politikës monetare.


Mjedisi për zbatimin e politikës monetare në vitin 2020 imponoi një natyrë adaptive të politikave, për shkak të zbutjes së efekteve negative të pandemisë Covid-19 dhe nga masat për parandalimin e përhapjes së virusit mbi ekonominë. Në tregun valutor, Banka Popullore ndërhyr për shkak të plotësimit të ofertës së valutës në kushtet e zvogëlimit të flukseve devizore në ekonomi për shkak të pandemisë, në të njëjtën kohë zvogëlimi i kërkesave. Kursimet e amvisërive, pavarësisht krizës shëndetësore, vazhdojnë të rriten, gjë që ka kontribuar në kufizimin më të madh të shpenzimeve në kushtet të pasigurisë për zhvillimin e pandemisë. Gjithashtu, mbështetja financiare e paguar në kuadër të masave fiskale, të cilat janë ndërmarrë për ballafaqimin me krizën e shkaktuar nga Covid-19 dhe për zbutje të efekteve mbi tregun e punës, ka ndikuar në dinamikën e depozitave gjatë vitit, si dhe në të ardhurat e disponueshme.

¹ Banka Popullore gjatë tremujorshit të parë të vitit 2021 në mënyrë shtesë e uli normën e interesit, e cila tash ajo është 1,25%.

Çmimet e konsumit vendor në vitin 2020 shënojnë rritje të vogël. Në fakt, niveli i përgjithshëm i çmimeve në vitin 2020 shënoi rritje mesatare vjetore prej 1.2%, që më së shumti rezulton nga rritja e çmimeve të ushqimeve, me një kontribut pozitiv më të ulët nga inflacioni bazë, ndërsa komponenti energjetik ka pasur kontribut negativ. Realizimi i tillë është në përputhje me normën e parashikuar të inflacionit për vitin 2020 nga projeksionet e tetorit, gjatë të cilit është bërë një rishikim në rritjen e normës së pritshme me vlerësimet e prillit. Përkatësisht, përkundër presioneve kryesisht në çmimet e importit dhe uljes së kërkesave vendore, përshpejtimi i lehtë i inflacionit të brendshëm në vitin 2020 reflekton pjesërisht zhvillimet në lidhje me Covid-19, përkatësisht konsumin më të theksuar të produkteve dhe shërbimeve të caktuara, si dhe rritjet e çmimeve nga natyra administrative dhe rregulatore, dhe një efekt të caktuar kanë edhe kufizimet nga ana e ofertës të shkaktuara nga kriza globale shëndetësore dhe ekonomike.

Nga aspekti i aktivitetit ekonomik, i ndikuar nga tronditja e pandemisë, gjatë vitit janë vërejtur tendenca negative, të shprehura përmes përkeqësimit të aktivitetit të biznesit, që ka ndikuar në besimin dhe pritshmëritë e kompanive dhe konsumatorëve. Ekonomia e vendit në vitin 2020 shënoi një rënie reale prej 4.5%, që është brenda pritshmërive.

Grafikoni 5
Revizioni i projeksioneve markoekonomike




Burimi: BPRMV dhe ESHS: Projeksionet për të gjitha treguesit kanë të bëjnë me projektimet e makroekonomisë të BPRMV.

Rezervat valutore shënojnë rritje të pandërprerë në vitet e fundit dhe kjo tendencë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2020, ashtu që rezervat vazhdimisht qëndrojnë në nivel përkatës dhe komform. Në kushtet e krizës të shkaktuar nga pandemia, rritja e rezervave valutore në vitin 2020 mbështetet kryesisht nga huamarrja e shtetit në tregjet financiare ndërkombëtare, në kushtet e një qëndrimi fiskal kundërciklik. Nga ana tjetër, Banka Popullore ndërhyr me shitjen neto të valutës për të ruajtur ekuilibrin ndërmjet ofertës dhe kërkesës për valutë. Shumica e intervenimeve në tregun valutor nga Banka Popullore janë koncentruar në periudhën mars-korrik, gjegjësisht në fazën akute të përballjes me pandeminë, por që nga ajo kohë nevojat për intervenim janë ulur ndjeshëm. Faktori kryesor i ndërhyrjeve është ulja e ndjeshme e ofertës në valutë nga tregu valutor, rënia e lartë vjetore e së cilës ishte faktor kyç për thellimin e vogël të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Megjithatë, flukset solide pozitive financiare brenda llogarisë financiare të bilancit të pagesave mundësuan financimin e plotë të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe rritje shtesë të rezervave valutore.

Grafikoni 6

Intervenimet e BPRMV në tregun valutor (në milionë euro)




Burimi: BPRMV.

Kursimi i sektori privat rritej edhe gjatë vitit, ku pasiguria për shkak të pandemisë kishte ndikim të caktuar ndaj prirjeve afatizuese dhe valutore të subjekteve ekonomike. Rritja vjetore e depozitave totale në vitin 2020 në sasi më të madhe ka ardhur nga rritja e depozitave në para dhe të depozitave në valutë të huaja, ndërkohë që depozitat e valutës vendore shënojnë rënie, gjë që është dukuri e zakonshme në situata krize. Në kushtet e rritjes së perceptimit të rrezikut nga ana e subjekteve ekonomike, gjatë vitit është shënuar rritje të depozitave afatshkurtra në kurriz të depozitave afatgjata, si dhe rritje mesatare të shkallës së euroizimit². Nga pikëpamja sektoriale, rritja vjetore e totalit të depozitave rrjedh pothuajse në mënyrë të barabartë nga të dy sektorët (amvisëritë dhe ndërmarrjet). Për sa i përket flukseve të kredisë, ato vijnë të rriten gjatë vitit 2020, por më ecuri mesatare në raport me vitin e kaluar. Për shkak të zbutjes së pasojave të krizës, Banka Popullore miratoi një sërë masash që synojnë uljen e çmimit të financimit përmes kredive nga bankat, si dhe sigurimin e likuiditetit shtesë në sistemin bankar, me qëllim stimulimin e aktivitetit kreditues. Kreditë e amvisërive edhe më tej mbeten sektori me kontributin më të madh në rritjen e kredisë, me një kontribut pozitiv edhe të kreditëve të ndërmarrjeve, por më i dobët në raport me vitin e kaluar.


² Pjesëmarrja e depozitëve valutor në totalin e depozitëve në sistemin financiar.

Duke pasur parasysh aplikimin e kursit fiks nominal të denarit kundrejt euros, ndryshimet e normave të interesit në eurozonë, si ekonomi –spirancë, luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin e vendosje së politikës monetare në vend. Gjatë vitit 2020, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka vazhduar me zbatimin politikës monetare të lirë, përmes një sërë masash lehtësuese kuantitative, ndërsa normat e interesit bazë i mbajtën në të njëjtin nivel. Si rezultat i uljes së normës bazë të interesit të Bankës Popullore, u vërejtë ngushtim i diferencës në mes normave të interesit të Bankës Popullore dhe BQE prej 2,25 p.p. në 1,5 p.p. Sa i përket normave të interesit të bankave në ekonominë vendore, diferenca ndërmjet normës së interesit në denarë dhe normës së interesit për depozitat në valutë në vitin 2020 ka shënuar rënie minimale (nga 1,0 p.p. në 0,8 p.p.), si rezultat kryesisht në lëvizjen rënëse të normës së interesit për depozitat në denarë, gjatë uljes minimale të normës së interesit për depozitat në valutë.

Grafikoni 7
Diferenca e normave bazë të interesit të BPRMV dhe BQE në p.p.



Grafikoni 8
Diferenca e normave të interesit në bankat e ekonomisë vendore në p.p.



Normat bazë e interesit e BPRMV: norma e interesit të boneve të thesarit të BPRMV.

Norma bazë e interesit e BQE: norma e interesit të operacioneve bazë për rifinancim të BQE.

II. Ambienti ndërkombëtar³

Në vitin 2020, aktiviteti ekonomik global u ndikua nga paraqitja dhe përhapja e infeksionit të ri të virusit Covid-19, fillimisht në Kinë dhe më pas në mbarë botën, pas të cilës vijuan edhe futje e masave të forta restriktive gjatë tremujorit të dytë të lëvizjes së popullsisë, në dhe jashtë shtetit, me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë dhe mbrojtjes së shëndetit publik. Andaj, pati një ulje të kërkesave, por edhe çrregullim në procesin e globalizimit dhe zinxhirëve të furnizimit dhe një rënie të fuqishme të tregtisë globale, me çka ekonomitë u prekën më tepër. Autoritetet fiskale dhe monetare vepruan shpejt për të zbutur efektet negative të krizës. Edhe pse në tremujorin e tretë pati një përmirësim të vogël të aktivitetit dhe lehtësim të masave, megjithatë në tremujorin e fundit të vitit, me paraqitjen e valës së dytë të pandemisë, në disa vende, kryesisht evropiane, përsëri u futën masat restriktive, por në një masë më të vogël në raport me tremujorshin e dytë dhe të drejtuara kryesisht drejt sektorët me ndërveprim më të madh social.

Rrjedhimisht, në vitin 2020, aktiviteti ekonomik global ndjeshëm u zvogëlua dhe rënia e vlerësuar ishte 3.5% (pas rritjes prej 2.8% në vitin 2019), që vlerësohet të jetë recesioni më i madh global që nga Depresioni i Madh i viteve 1930. Rënia e aktivitetit ekonomik është e sinkronizuar dhe e shpërndarë gjerësisht dhe vërehet si në vendet e zhvilluara, edhe te vendet në zhvillim të përshpejtuar dhe në vendet në zhvillim, me përjashtim të Kinës, e cila shënoi rritje të aktivitetit, por e ngadalësuar (rritje prej 2.3%, kundrejt rritjes prej 6% në vitin 2019), e nxitur nga neto-eksportet dhe investimet, në kushtet e stimulimit të politikës fiskale⁴. Në kuadër të vendeve të zhvilluara, në vitin 2020 normë relativisht të larta të rënies u arritën nga ekonomitë e Mbretërisë së Bashkuar (rënie prej 10%, kundrejt rritjes prej 1.4% në vitin 2019), eurozonës (rënie prej 7.2%, kundrejt rritjes prej 1,3 % në vitin 2019) dhe Japonia (rënie prej 5.1%, kundrejt rritjes së vogël prej 0.3% në vitin 2019), ndërsa një rënie mesatare realizoi ekonomia e SHBA-së (rënie prej 3.4%, kundrejt rritjes prej 2,2% në vitin 2019). Pothuajse në të gjitha këto ekonomi, ecuria e pafavorshme vjen si pasojë e rënies së pothuajse të gjithë komponentëve të kërkesave, më së shumti si pasojë e zvogëlimit të konsumit të banorëve dhe eksportit, në krahasim me konsumin e shtetit, e cila shënon rritje për shkak të rritjes së shpenzimeve lidhur me pandeminë. Vetëm në Mbretërinë e Bashkuar është vërejtur një rënie në të gjithë komponentët, përfshirë edhe konsumin publik. Megjithatë, ka fundi i vitit 2020, më shumë vaksina nga prodhues të ndryshëm u miratuan për përdorim, ndërsa në dhjetor në disa vende filloi procesi i imunizimit, e cila kontribuoi në rritjen e optimizmit për një përfundim më të shpejtë të pandemisë.

Pritjet për rritjen e ekonomisë globale në periudhën e ardhshme karakterizohen me pasiguri ekstreme lidhur me zhvillimin e pandemisë dhe perspektivat për ballafaqimin me të. Madje, paraqitja e valës së dytë të pandemisë ka fundi i vitit 2020 dhe rifutja e masave restriktive paraqesin faktorë kufizues për rritje afatshkurte. Nga ana tjetër, marrëveshja mes BE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar nga dhjetori i vitit 2020, lidhur me largimin e Mbretërisë së Bashkuar nga BE-ja, paraqet eliminimin e një rreziku të konsiderueshëm negativ. Rreziqet rritëse për rritjen globale në periudhën e ardhshme janë zhvillimet më të favorshme nga aspekti i prodhimit dhe shpërndarjes së vaksinave, përmirësimi dhe efektiviteti më i madh i terapive për ballafaqimin me virusin, si dhe ndoshta një stimul fiskal më i madh se sa pritej. Nga ana tjetër, rreziqet negative përfshijnë përhapjen e shpejtë të virusit për shkak të


³ Analiza bazohet në "Pasqyra ekonomike botërore" të FMN, e përditësuar në tetor 2020 dhe janar 2021; "Prespektivat globale ekonomike" të Bankës Botërore, janar 2021, raportet tremujorshje të Bankës Popullore.

⁴ Kina shënoi rritje reale ekonomike prej 3,2%, 4,9% dhe 6,5% në tremujorshin e dytë, tretë dhe katër të vitit 2020, në krahasim me rënie prej 6,8% në tremujorshin e parë të vitit.


mutacioneve të virusit, futjen e mundshme të masave dukshëm më të rrepta për ballafaqim me virusin sesa pritej, si dhe përparimi më i ngadalshëm në trajtimin mjekësor të virusit, duke përfshirë edhe procesin e ngadalësuar të vaksinimit. Gjithashtu, ndërprerja e hershme e politikave të mbështetjes ekonomike mund të çojë në efekte negative mbi tregun e punës dhe mbi aftësinë paguese të firmave, dhe shtrëngimi i kushteve të financimit mund të vështirësojë qasjet deri në tregjet financiare për disa vende. E gjithë kjo mund të kontribuojë në një rritje më të dobët afatgjate globale.

Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2020 u ngadalësua, e cila ra në 3.2% (3.5% në vitin 2019) dhe në pjesë më të madhe i reflektohet uljes së kërkesave globale, si dhe çmimet e ulëta të energjisë që mbizotëruan gjatë gjithë vitit, kryesisht për shkak të përhapjes së pandemisë në kornizë globale. Shikuar sipas grupeve të vendeve, norma e inflacionit në vitin 2020 në ekonomitë e zhvilluara u ngadalësua në 0.7% (krahasuar me 1.4% në vitin 2019), ndërsa në ekonomitë me rritje të shpejtë u shënuar një ngadalësim minimal dhe arriti në 5% (5.1% në vitin 2019).


Grafikoni 9
Rritja ekonomike globale (në %)



Grafikoni 10
Rritja e PBB në vendet e zhvilluara në (%)



Grafikoni 11
Rritja vjetore tregtisë globale (në %)




Burimi: Pasqyra ekonomike botërore, tetor 2020 dhe azhurimi në janar 2021, FMN.

Sa i përket treguesve sasiorë që pasqyrojnë mjedisin e jashtëm të ekonomisë së Maqedonisë, kërkesa e huaj efektive e vlerësuar shënon rënie vjetore relativisht të lartë në vitin 2020 dhe inflacioni i huaj efektiv është ngadalësuar në krahasim me vitin paraprakë. Përkatësisht, në vitin 2020, vlerësohet një rënie e kërkesave të huaja efektive prej 5.6% (krahasuar me rritjen prej 1.4% në vitin 2019), në kushtet e ecurisë së pafavorshme ekonomike në të gjitha vendet partnere tregtare, me kontributin më të madh negativ të Gjermanisë, Italisë dhe Greqisë. Lëvizje të tilla janë rezultat i përhapjes së pandemisë dhe futjes së masave restriktive në vende për shkak të parandalimit të mëtejshëm të përhapjes së

infeksionit, para gjithash në tremujorshin e dytë. Sa i përket çmimeve të huaja efektive për vitin 2020, mesatarisht ato kanë arritur një rritje të vogël prej 0.3% (ngadalësim krahasuar me rritjen prej 1.5% në vitin 2019), dhe ngadalësimi vjen si pasojë e presioneve më të ulëta të çmimeve në të gjitha vendet, me kontribut më të madh nga Gjermania, Sllovenia dhe Kroacia⁵.


Grafikoni 12

Kërkesat e huaja efektive



Графикон 13

Inflacioni i huaj efektiv



Burimi: Entet Kombëtare për Statistik dhe Përlllogaritje të BPRM⁶.

Në tregjet e produkteve primare, në vitin 2020, çmimet e energjisë ranë ndjeshëm, çmimet e ushqimeve mesatarisht mbetën relativisht të qëndrueshme, ndërsa çmimet e metaleve shënuan rritje të vogël. Ashtu që, në vitin 2020 çmimi mesatar i naftës ishte 37 euro për fuçi dhe ishte më i ulët për 35.2% krahasuar me vitin 2019 (57.2 euro për fuçi), kryesisht për shkak të kërkesave të dobëta globale për shkak të përhapjes së pandemisë, edhe përkundër të marrëveshjes për kufizim të prodhimit të naftës nga ana e vendeve OPEC + gjatë gjithë vitit. Nga analiza sipas muajve rezulton se në prill 2020 u arrit çmimi më i ulët nga viti 2002 e këndej⁷, pas çka vijoi rikuperim i caktuar i çmimeve dhe stabilizimi i tij në kushtet e lehtësimit gradual të masave restriktive. Në dy muajt e fundit të vitit, çmimi i naftës shënoi sërish normë relativisht të larta rritjeje mujore, kryesisht si rezultat i pritjeve për rritje të kërkesës, mes optimizimit të rritur të tregut pas shpalljes së efikasitetit të lartë të disa vaksinave dhe fillimit të procesit të vaksinimit ka fundi i vitit 2020 në disa nga vendet e zhvilluara, si dhe pritshmëritë për prodhim të mëtejshëm të kufizuar nga vendet anëtare të OPEC +. Indeksi i çmimeve të metaleve bazë në vitin 2020 shënoi rritje të vogël prej 1.2%. Rritja e çmimeve të metaleve, e cila filloi në gjysmën e dytë të vitit, është rezultat kryesisht si pasojë e rritjes së kërkesës nga Kina, rimëkëmbja ekonomike e së cilës filloi në tremujorshin e dytë të vitit dhe vazhdoi fuqishëm gjatë gjithë vitit.


⁵ Inflacioni i Kroacisë është korigjuar për ndryshimet në kursin valutore.

⁶ Kërkesa e huaj efektive llogaritet si shumë e indekseve të ponderuar të prodhimit të brendshëm bruto të partnerëve më të rëndësishëm tregtarë të vendit tonë. Në llogaritjen e indeksit janë të përfshira: Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria. Panderët janë llogaritur në bazë të pjesëmarrjes së eksportit ndaj këtyre vendeve në eksportin e përgjithshëm. Inflacioni i huaj paraqet një shumë të ponderuar të indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve, partnerëve më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë në sferën e importit të mallrave për konsumin e gjerë. Struktura e ponderuar bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili vend në importet e përgjithshme nominale në periudhën 2013 – tremujori i tret i vitit 2016. Në llogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë: Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.

⁷ Në prill të vitit 2020, çmimi i naftës së llojit "brent" ra në 21,5 euro për fuçi, e cila është çmimi më i ulët nga dhjetori i vitit 2001 e këndej (20,8 euro për fuçi).

Grafikoni 14


Lëvizja mujore e çmimeve të produkteve primare energjetike dhe joenergjetike (euro, indeksi: 2010=100)



Burimi: Baza e të dhënave të FMN për çmimet e produkteve primare.

Grafikoni 15

Lëvizja mujore e çmimeve të naftës së papërpunuar, metaleve⁸ dhe ushqimeve (euro, indeksi: 2010=100)



Gjatë vitit 2020, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara zbatuan politika monetare stimuluese për të zbutur efektet negative të pandemisë. Kështu, FED në dy raste uli normën e interesit në muajin mars, për një total prej 150 pikë bazë, duke e ulur atë në një interval nga 0% në 0.25%. Gjithashtu, FED ndërmoi masa për rritjen e shumës së ofruar në zbatimin e repo-operacioneve, ndryshimet në kalendarit e blerjes së letrave me vlerë të thesarit në varësi të strukturës afatizuese, si dhe rritjen e shumës së letrave me vlerë të blera në kornizë të programit për lehtësim kuantativ⁹, futi masa shtesë për mbështetjen e kreditimit të popullatës dhe firmave¹⁰ dhe realizoi aksion të koordinuar me më shumë banka qendrore për përmirësimin e mëtejshëm në sigurimin e likuiditetit në dollarin amerikanë, si dhe masa për ruajtjen e kapitalizimit të sistemit bankar në nivele të larta¹¹. Gjithashtu në gusht, FED i shpalli ndryshime në strategjinë e zbatimit të politikës monetare, e cila lë hapësirë për periudha të caktuara arritjeje dhe një normë inflacioni më të lartë se objektivi i inflacionit të përcaktuar më parë prej 2%¹², në përputhje me përcaktimin e normës mesatare të inflacionit prej 2% për një periudhë më të gjatë kohore.

Pas një periudhe të gjatë të politikës monetare të pandryshuar (nga gushti i vitit 2018), në mars 2020 Banka e Anglisë në dy raste e uli normën e interesit, në përgjithësi nga 0.75% në 0.1%. Gjithashtu, për të mbështetur ekonominë, ajo futi një paketë masash për mbështetjen e kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, së bashku me Ministrinë e Financave themeluar fond për mbështetjen e kompanive përmes blerjes së letrave afatizuese deri një vjet (me zbatim deri në mars 2021), dhe gjatë vitit në tre raste solli vendim për rritjen

⁸ Indeksi i metaleve është indeks kompozitë që përfshinë çmimet e bakrit, aluminit, xeheve të hekurit, fletëzave metalike, nikelit, zingut, plumbit dhe uranimit.

⁹ Në mars 2020, FED solli vendim të rrisë shumë e blerjes së letrave me vlerë të qeverisë me të paktën 500 miliardë dollarë dhe me të paktën 200 miliardë dollarë blerjen e letrave me vlerë hipotekare të lëshuara nga ana e agjencive shtetërore në muajt e ardhshëm. Gjithashtu në dhjetor 2020, FED paralajmëroi se do të vazhdojë me blerjen e letrave në vlerë qeveritare në vlerë të paktën 80 miliardë dollarë në muaj, si dhe letra me vlerë hipotekare të lëshuara nga ana e agjencive shtetërore prej së paku 40 miliardë dollarë në muaj.

¹⁰ Një nga masat është futja e Programit për mbrojtjen e pagave të bizneseve të vogla, e ashtuquajtur PPP (The Small Business Administration's Paycheck Protection Program – PPP)

¹¹ I referohet masës me të cilën bankave të mëdha (ato me mjetet totale mbi 100 miliardë dollarë) u ndalohet të bëjnë blerjen e aksioneve, dhe gjithashtu pagesa e dividendëve do të jetë e kufizuar dhe do të varet nga fitimi aktual, i cili do të kontribuonte në ruajtjen e pozicione të forta kapitale të bankave.

¹² Më 27 gusht 2020, FED shpalli azhurim të objektivave dhe strategjisë afatgjate për zbatimin e politikës monetare dhe ndryshime të rëndësishme që kanë të bëjnë me: 1) punësimin maksimal, gjatë së cilës vendimet do të bazohen në vlerësimet e devijimeve në rënie nga niveli maksimal i punësimit, në vend të praktikës të deritanishme të devijimeve nga niveli maksimal në të dy drejtimet; 2) stabiliteti i çmimeve, ku FED ka përshtatur strategjinë e saj për arritjen e qëllimit afatgjatë - inflacionit prej 2%, në këtë mënyrë do të bëhet përpjekje të arrihet inflacioni që në përqindje është 2% në periudhë të caktuar kohore, përkatësisht pas periudhave në të cilat inflacioni vazhdimisht ka qenë nën 2%, në politika monetare përkatëse do të synojë arritjen e inflacionit mesatarisht mbi 2% për një periudhë kohore të caktuar.

e vëllimit të blerjes së obligacioneve shtetërore (me një shumë totale prej 875 miliardë funta). Banka e Japonisë nuk e ndryshoi normën e interesit në vitin 2020 (-0,1%), ndërkohë që lehtësimi monetar e zbatoi nëpërmjet ofertës së mëtejshme të konsiderueshme të fondeve nëpërmjet operacioneve të ndryshme, mes të cilave blerje të letrave në vlerë shtetërore, sigurimin e likuiditetit të valutës vendase për stabilizimin w tregut financiar dhe masave të ndryshme për lehtësimin e financimit të firmave, siç është programi i lehtësimit monetar nëpërmjet rritjes së blerjes së letrave me vlerë të korporatave dhe hapja e fondit të posaçëm për lehtësimin e financimit të sektorit privat për shkak të virusit të ri. Madje në dhjetor u vendos që të dy programet të zbatohen edhe për 6 muaj shtesë, me çka do të zgjasin deri në shtator 2021.

Banka Qendrore Evropiane (BQE) e mbajti të njëjtën normë të interesit (0%), por ndërmori një sërë masash lehtësuese sasiore gjatë gjithë vitit. Kështu, në mars futi një shumë shtesë të përkohshme të lehtësimit sasiore prej 120 miliardë eurosh, e cila u aplikua deri në fund të vitit 2020, si plotësim të shumës së përcaktuar për blerje të letrave në vlerë në shumë prej 20 miliardë euro në muaj (APP), dhe filloi me zbatimin e programit të përkohshëm për blerjen e letrave me vlerë për mbështetje të menjëhershme të ekonomisë për shkak të pandemisë (PEPP), vëllimi i të cilit deri në fund të vitit arriti në 1,850 miliardë euro¹³. Përkundër kësaj, kushtet në kuadër të pakos së tretë të repo-operacioneve afatgjata të synuara (TLTRO III) u lehtësuan në tre raste, u miratua një set masash për lehtësim në lidhje me sigurimin, ndërsa u zbatua edhe një seri e re prej 7 repo-operacioneve afatgjata të ndërlidhura me pandeminë (PELTRO), të cilat do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2021. Njëherit, BQE këshilloi sërish bankat që të jenë jashtëzakonisht të kujdesshme në pagesën e dividendëve dhe blerjen e aksioneve¹⁴, për të ruajtur stabilitetin e sistemit financiar në kushte pandemie. Përkundër kësaj, në qershor BQE vendosi të fut svop dhe repo -linje (EUREP) për bankat qendrore jashtë SEBQ, duke përfshirë repo-linje për BPRMV¹⁵, vlefshmëria e së cilës në dhjetor u zgjat deri në mars 2022 (më parë deri në qershor 2021).

¹³ Në mars 2020, u paralajmërua shuma e programit prej 750 miliardë euro, por më pas gjatë vitit u rrit për dy herë, përkatësisht për 600 dhe 500 miliardë euro, në qershor dhe dhjetor, duke zhvendosur njëkohësisht periudhën e kohëzgjatjes së tij, nga data e planifikuar fillimisht - fundi i vitit 2020, në qershor u zgjat të paktën deri në qershor 2021 dhe në dhjetor - të paktën deri në fund të marsit 2022.

BQE u bëri thirrje bankave të përmbahen nga pagesa e dividendëve ose të kufizojnë pagesat deri më 30 shtator 2021 (më parë deri më 27 mars 2021) dhe rekomandoi që nëse bankat vendosin të paguajnë dividendë ose të blejnë aksione, shumë të jenë nën 15% të fitimit të përgjithshëm kumulativ të bankave në periudhën 2019-2020 dhe të mos jenë më të larta se 20 b.p nga niveli i kapitalit bazë.


¹⁵ Në gusht 2020, Banka Qendrore Evropiane (BQE) njoftoi se kishte miratuar një repo -linjë në vlerë prej 400 milionë euro për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të siguruar likuiditet në valutë të huaj në euro për institucionet financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes Bankës Qendrore, për shkak të përmbushjes së nevojave të mundshme për likuiditet në euro në kushtet e çrregullimeve të tregut për shkak të goditjes nga Covid-19, ku repo-linja do të vlejë deri në mars 2022 (fillimisht deri në qershor 2021). Megjithatë, deri në periudhën e tanishme (përfundimisht mars 2021), Banka Popullore nuk i ka shfrytëzuar mjetet nga repo- linja e miratuar, duke pasur parasysh ruajtjen e vazhdueshme të likuiditetit në denarë dhe valutë të sistemit bankar në nivel të duhur.

III. Zhvillimet makroekonomike në vitin 2020


3.1. PBB dhe inflacioni

Sipas të dhënave të vlerësuara të ESHS-së, në vitin 2020 është shënuar një rënie reale të PBB prej 4,5%¹⁶ (rritje prej 3,2% në vitin 2019). Kjo rënie vjen si pasojë e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19, e cila çoi në ulje të kërkesave të jashtme, çrregullim të përkohshme të zinxhirëve të prodhimit, si dhe përmbajtje më të madhe të subjekteve ekonomike, mes pasigurisë së theksuar dhe masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit. Në rrethana të tilla, në vitin 2020, rënia u vërejt edhe në kërkesat vendore dhe ato eksporte. Shikuar nga komponentë e caktuar, rritja është e dukshme vetëm në konsumin publik, duke pasur parasysh nevojën për mbrojtje dhe ruajtje të shëndetit publik në kushte pandemie. Gjatë vitit 2020, politikëbërësit morën masa të koordinuara për të zbutur pasojat e krizës shëndetësore mbi ekonominë.

Grafikoni 16
PBB dhe kërkesa efektive e jashtme (shkalla vjetore e ndryshimit real, në %)



Grafikoni 17
PBB (rritje reale, në %) dhe komponentët shpenzues të PBB (kontribut në rritje, në p.p.)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Eurostat, përllogaritje të BPRMV. Të dhënat për BPP për vitin 2019 janë paraprake, ndërsa për vitin 2020 janë të vlerësuara.

Shikuar nga ana e prodhimit, rënia e ekonomisë gjatë vitit 2020 është e shpërndarë gjerësisht, dhe është më e theksuar në pjesën e industrisë dhe aktiviteteve të grupit "tregti, transport dhe hoteleri", sektorë që kanë qenë kyç të rritjes në vitet e mëparshme. E analizuar në mënyrë të granule, nëpërmjet indeksit të prodhimit industrial, rënia e **industrisë** vjen kryesisht si rezultat i ecurive jo të favorshme në industrinë përpunuese, kryesisht në aktivitetet në të cilat janë aktive kapacitete e eksportit me kapital të huaj të ndërlidhura me industrinë e automobilave, siç është prodhimi i makinerive dhe pajisjeve dhe prodhimi i automjeteve motorike, ndërsa kontribut negativ vërehet edhe në prodhimin e pajisjeve elektrike. Në veprimtaritë tradicionale, një kontribut i konsiderueshëm negativ vihet re në prodhimin e veshjeve dhe tekstileve, prodhimin e produkteve ushqimore dhe prodhimin e pijeve. Rënia te **tregtia** pothuajse tërësisht është si pasojë e zhvillimeve në lidhje me pandeminë, ndërsa duke shikuar veçmas, sipas llojeve të qarkullimit, vërehet rënie e qarkullimit si në tregtinë me shumicë ashtu edhe me pakicë. Në përputhje me kufizimet e lëvizjes së popullsisë, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar lidhur me pandeminë, te **transportit** ka rënie të aktivitetit në të gjitha llojet e trafikut, përveç trafikut rrugor të mallrave. **Hoteleria** është sektori më i


¹⁶ PBB-ja reale gjatë vitit 2020 ka ndjekur dinamikën e mëposhtme: tremujori i parë 0,9%, tremujori i dytë -14,9%, tremujori i tretë -3,3% dhe tremujori i katërt -0,7%.

prekur nga pandemia ku numri i turistëve, butjet, si dhe qarkullimi i përgjithshëm pothuajse u përgjysmua. Më tej, **sektori i ndërtimitarisë** në vitin 2020 shënoi një rënie më mesatare nga se sektorët e tjerë, me aktivitet më të dobët në fushën e ndërtimit të larta, në kushtet e zhvillimeve të favorshme në ndërtimet më të vogla të ndërlidhura me investimet publike në infrastrukturën rrugore. Nga ana tjetër, në bujqësi, informacion dhe komunikim dhe aktivitete që lidhen me pasuritë e patundshme, është shënuar rritje reale të aktivitetit në vitin 2020.

Grafikoni 18
Kontributi ndaj ndryshimit real vjetor të PBB
(në pikë përqindje)



Grafikoni 19
PBB, industria dhe shfrytëzimi i kapaciteteve



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe përllogaritje të BPRMV. Të dhënat për BPP për vitin 2019 janë paraprake, ndërsa për vitin 2020 janë të vlerësuara.

Shikuar nga aspekti i kërkesës agregate, në vitin 2020 kërkesa e brendshme ka një kontribut negativ, me një kontribut pozitiv të neto-eksporteve. Në kuadër të kërkesës së brendshme, kontributin më të madh negativ e ka **konsumi familjar**, në kushtet e rënies së të ardhurave të disponueshme dhe lëvizjeve të pafavorshme të tregut të punës, por edhe frenimit më të madh nga konsumi lidhur me pasigurinë e vendeve të punës dhe të ardhurat në të ardhmen. Rënia e konsumit familjar është zbutur pjesërisht me masat për mbështetjen financiare të qytetarëve. Kontribut negativ të theksuar kanë pasur edhe **investimet**, në të cilat ndikuan fuqishëm kërkesa e dobët dhe niveli i lartë i pasigurisë. Rënia e investimeve në vitin 2020 është në përputhje me rënien e vërejtur të vlerës së shtuar në ndërtimtarë dhe me uljen e importit të produkteve për investime, ndërsa rënia është zbutur përmes rritjes së investimeve publike në infrastrukturë (duke parë nga rritja e punëve ndërtimore të kryera në fushën e ndërtimeve të ulëta). Nga ana tjetër, **shpenzimet publike** shënuan rritje të lartë dhe vepruan në mënyrë kundërciklike, si rezultat i rritjes së mbështetjes së sektorit shëndetësor dhe autoriteteve lokale për ballafaqimin me Covid-19¹⁷. Në kushtet e rënies së kërkesës së huaj dhe çrregullimit të përkohshme të zinxhirëve globalë të prodhimit dhe logjistikës, **eksporti** shënon rënie në vitin 2020. Reduktimi i aktivitetit eksportues, si dhe rënia e kërkesës së brendshme, shkaktuan një rregullim në rënie të **importit** të mallrave dhe shërbimeve, ku kontribut pozitiv në rritje ka pasur edhe neto-eksporti.


Në vitin 2020, norma mesatare e inflacionit mbeti në nivel të ulët dhe stabil dhe arriti në 1.2%, kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të komponentëve ushqimorë dhe në një masë më të vogël të kontributit pozitiv të inflacionit bazë, ndërsa çmimet e energjisë patën një kontribut të vogël negativ. Ecuria në vitin 2020 tregon një përshpejtim të lehtë të inflacionit krahasuar me ecurinë e vitit 2019, kur inflacioni ishte 0.8%. Në kushtet e presioneve kryesisht

¹⁷ Gjatë gjithë vitit, pjesa më e madhe e rritjes së shpenzimeve publike shpjegohet me transfertat më të larta në fondin e shëndetësisë, transfertat në pushtetin lokal, si dhe shpenzimet më të larta për paga.

në rënie nga çmimet e importit (rënie të thellë të çmimeve të naftës, inflacion më i moderuar efektiv i huaj dhe rritje të vogël të çmimeve të ushqimeve) dhe ulje të kërkesës së brendshme, përshpejtimi i lehtë i inflacionit të brendshëm në vitin 2020 reflekton pjesërisht zhvillimet në lidhje me covid -19 konsumi më i theksuar i produkteve dhe shërbimeve të caktuara, si dhe rritja e çmimeve të natyrës administrative dhe rregullatore, ndërsa një efekt të caktuar sigurisht kanë edhe kufizimet nga ana e ofertës të shkaktuara nga kriza globale shëndetësore dhe ekonomike. E analizuar në mënyrë dinamike, rritja e çmimeve të konsumit u përshpejtua gjatë vitit, ashtu që nga 0.6% në tremujorin e parë, arriti në 2.2% në tremujorin e katërt të vitit.

Grafikoni 20


Inflacioni vendor dhe inflacioni i huaj efektiv, shkalla vjetore e rritjes (në %)



Burimi: ESHS, Eurostat dhe përlogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 21

Komponenti i ndryshueshëm (ushqimi dhe energjia) dhe afatgjatë i inflacionit (kontributet vjetore, në pikë përqindje)



Në raport me komponentët kryesor të indeksit të çmimeve të konsumimit, kontribut më të madh pozitiv drejt normës së inflacionit kanë komponentët ushqimor (rritje prej 2,6% dhe kontribut prej 0,9 p.p. në inflacionin total), duke reflektuar çmimet më të larta në shumicën e nëngrupeve brenda indeksit, pra çmime mesatarisht më të larta të bukës dhe drithërave, mishit, produkteve të qumështit, vajit dhe yndyrës, si dhe çmimet e frutave. Një kontribut pozitiv shtesë në rritjen e çmimeve të konsumit ka komponenti bazë (rritje 0.9% dhe kontribut prej 0.5 p.p. në inflacionin total), i cili në masë të madhe i detyrohet ndryshimeve të natyrës administrative, të ndërlidhura me rritjen e akcizës për duhanin¹⁸, në të njëjtën kohë presionet rënëse më të theksuara nga çmimet e shërbimeve të transportit në trafikun ajror. Nga ana tjetër, komponenti i energjisë ka një kontribut të vogël negativ në rritjen vjetore të çmimeve të brendshme (rënie prej 1.4% dhe kontribut prej -0.2 p.p. në inflacionin total), i ndikuar nga rënia e lartë e çmimit të naftës në bursat botërore, me çka ky efekt në një pjesë u neutralizua me vendimin për rritjen e akcizës për disa derivate¹⁹ nga prilli 2020 dhe vendimi për rritjen e çmimit vendor të energjisë elektrike²⁰ gusht 2020.

¹⁸ Rritja vjetore e çmimit të duhanit është reflektim i rritjes së çmimit të cigareve në muajt mars dhe korrik 2020, në përputhje me rritjen e parashikuar vjetore të akcizës së cigareve për 0,20 denarë/copë, nga 1 korriku 2023. Në rritje kanë kontribuar edhe ndryshimet në Ligjin për duhanin, produktet e duhanit dhe produktet e ngjashme, i cili detyron të gjitha paketat e cigareve të kenë 20 cigare deri në nëntor të vitit 2020 (më parë ka pasur kuti me 19 cigare), e cila së bashku me rritjen e shumës së akcizës e cila paguhet për cigaret, kontribuoi në rritjen e shpenzimeve të prodhuesve

¹⁹ Ky vendim i miratua për të zbutur pasojat ekonomike nga shpenzimet e rritura për ballafaqim me virusin korona dhe sigurimi i mjeteve për pagimin e rregullt të nevojave buxhetore. Mekanizmat e propozuara mundësojnë edhe kthimi gradual i shumës ekzistuese të akcizës në kushte të normalizimit të çmimeve të tregut.


²⁰ Me vendim të KRE, duke filluar nga 1.8.2020, çmimi i energjisë elektrike është më e lartë për 7,4%.

3.2. Tregu i punës

Ndryshimet e pafavorshme në ekonomi, të shkaktuara nga pandemia Covid-19, patën një efekt të transmetuar në tregun e punës²¹. Megjithatë, ndikimi i pandemisë në këtë segment të tregut ishte relativisht i moderuar dhe efektet negative u përqendruan në tremujorin e dytë të vitit 2020. Në fakt, kjo ishte periudha e fazës akute të përballjes me pandeminë, kur u morën masat më të rrepta për parandalimin e përhapjes së infeksionit viral. Gjatë vitit 2020 janë miratuar më shumë masa kundër krizës²² me qëllim që të zbutet ndikimi i krizës mbi tregun e punës, ndërsa vazhdoi edhe zbatimi i masave ekzistuese aktive për punësim²³ si përkrahje për rritjen e punësimit. Numri i të punësuarve në vitin 2020 u zvogëlua për 0.3%, ndërkohë u zvogëlua edhe norma e punësimit për 0.2 pikë përqindje deri në nivelin 47.1%. E analizuar sipas sektorëve, në vitin 2020, zvogëlimi i punësimeve ka të bëjë më së shumti me sektorin e bujqësisë, ndërsa në një masë më të vogël edhe me industrinë, kryesisht për shkak të zvogëlimit të numrit të të punësuarve në sektorin e energjisë dhe ndërtimitarisë. Gjithashtu, një zvogëlimi i punësimit vërehet në disa veprimtari shërbyese të cilat u prekën drejtpërdrejt nga pandemia, kryesisht në veprimtarit që lidhen me pasuritë e patundshme, transportit dhe magazinimit, veprimtari administrative dhe shërbime ndihmëse, si dhe te veprimtaritë të ndërlidhura me objektet e strehimit dhe veprimtarit shërbyese me ushqim. Nga ana tjetër, në vitin 2020 rritje e punësimit vërehet në shëndetësi, tregti me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve motorike dhe motoçikletave, informacioni dhe komunikimi, si dhe në arsim.

Grafikoni 22


Treguesit e selektuar të tregut të punës (në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe përlogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 23

Shkalla e papunësisë sipas grup moshave (në %)



Lëvizje negative më të theksuara gjatë vitit vërehet në anën e ofertës të fuqisë punëtore. Në fakt, totali i popullsisë aktive u zvogëlua me 1.4%, që në të njëjtën kohë rritje të popullsinë joaktive me 1.9%, duke çuar në një lëvizje në rënie të normës së aktivitetit (me 0.8 pikë përqindje), e cila ishte 56.4 Edhe përkundër zhvillimet e pafavorshme edhe në anën e kërkesave edhe në anën e ofertës së fuqisë punëtore, numri i personave të papunësuar u zvogëlua për 6.3%, dhe shkalla e papunësisë në vitin 2020 u ul në nivelin më të ulët historik prej 16.4% (ulje vjetore me 0.9 p.p.). Për sa i përket grupmoshave, ulja e shkallës së përgjithshme të papunësisë shpjegohet me uljen e

²¹ Analiza e tregut të punës është bërë përmes përdorimit të anketave tremujore të fuqisë punëtore, pra treguesit vjetorë për vitin 2020 janë nxjerrë si mesatare e të dhënave të publikuara tremujore.

²²Për më shumë informata për masat e miratuara, qasuni në linkun në vijim: <https://vlada.mk/ekonomski-merki-covid19>

²³ Edhe gjatë vitit 2020, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Agjencia e Punësimit kanë vazhduar zbatimin e masave dhe programeve aktive të dedikuara për rritjen e punësimeve.

papunësisë së personave të moshës 25 deri në 49 vjeç, ndërsa papunësia në kategorinë e të rinjve të moshës 15 deri në 24 vjeç ka shënuar rritje minimale.

Rritja e pagave të paguara mesatare vazhdoi edhe në vitin 2020, në pjesë më të mirë për shkak të efektit të transferuar nga rritja e pagave ka fundi i vitit 2019 dhe rritja shtesë që u bënë në fillim të vitit 2020, para fillimit të pandemisë. Në fakt, niveli më i lartë i pagave në vitin 2020 në një pjesë i reflektohet rritjes së nivelit të neto-pagës minimale (në fund të vitit 2019²⁴ dhe në qershor 2020²⁵), rritjes së pagave në sektorin publik²⁶, si dhe efekti nga masa e subvencionit të kontributeve për shkak të rritjes së pagës²⁷. Kështu, pagat nominale neto dhe bruto²⁸ shënuan rritje vjetore përkatësisht prej 7.8% dhe 8.3%²⁹, (përkatësisht 3.9% dhe 5.1% në vitin 2019). Korigjim në rritjen e neto-pagës është vërejtur pothuajse në të gjithë sektorët e aktiviteteve, kurse rritje veçanërisht të lartë ka shënuar aktiviteti "informacion dhe komunikim" (11,3%), që mund të lidhet me trendin e rritjes së digjitalizimit, e theksuar në kushtet pandemie. Më tej, rritje është shënuar në aktivitetet "arsim" (11,2%), "mbrojtje shëndetësore dhe sociale" (9,6%), "tregti me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve motorike dhe motoçikletave" (8,8%), industria përpunuese (8,5%), ndërtimtaria (8,4%), bujqësia (8,4%) dhe "veprimtari të tjera shërbyese" (8,3%). Rënie e pagave në vitin 2020 është vërejtur vetëm në aktivitetin "hotele dhe restorante", aktivitet i cili ishte më i prekur nga pandemia. Madje në kushtet e rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit, pagat neto dhe bruto shënuan rritje reale përkatësisht prej 6.5% dhe 7%.

²⁴ Përkundër harmonizimit të rregullt në prill 2019, paga minimale është rritur në dhjetor 2019 (për rreth 2000 denarë, neto) dhe ka arritur në 14.500 denarë në shumën neto (Ligji për pagën minimale, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 239 /19).

²⁵ Në pajtim me njoftimin e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, të publikuar në "Gazetën Zyrtare të RMV" nr. 75/20 dhe me Dekretin me fuqi juridike për zbatimin e Ligjit për pagën minimale në Republikën e Maqedonisë "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.88/20, paga minimale neto nga korriku 2020 është rritur për 3%, përkatësisht për 434 denarë. Shuma e pagës minimale në shumën bruto, duke filluar nga korriku 2020 deri në mars 2021 është 21.776 denarë (më parë 21.107 denarë), gjegjësisht paga minimale në shumën neto është 14.934 denarë (më parë 14.500 denarë). Harmonizimi i rregullt për rritjen e pagës minimale (me rritjen për vitin paraprakë të pagës mesatare të paguar në RMV, indeksit i shpenzimeve të jetesës dhe rritjes reale të PBB-së - përkatësisht një e treta e rritjes së secilit tregues) u bë para krizës së shkaktuar nga pandemia e Covid-19, por me Dekret, Qeveria e vuri në pushim deri në përfundim të gjendjes së jashtëzakonshme (pra për periudhën prill-qershor 2020).


²⁶ Duke filluar nga paga e shtatorit 2019, ka pasur një rritje prej 5% të pagave të punëtorëve shëndetësorë dhe socialë dhe të punëtorëve në arsim, polici, mbrojtje dhe në të gjithë sektorin publik. Në janar 2020 ka pasur një rritje shtesë të pagave në arsim me 10%, dhe nga shkurti 2020 është rritur paga për punëtorët shëndetësor (rritje prej 25% për specialistët, 15% për mjekët e përgjithshëm, 10% për motrat medicinale dhe 5% për bashkëpunëtorët shëndetësor dhe personelit ndihmës-teknik).

²⁷ Në bazë të Ligjit për subvencionimin e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme sociale për shkak të rritjes së pagave, i cili ka filluar të zbatohet me pagesën e pagës të nëntorit 2019 ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 239/19), ashtu që subvencionimi i kontributeve miratohet nëse rritja e pagës neto është në shumë prej së paku 600 deri më së shumti 6000 denarë në muaj për person të siguruar ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 239/19, neni 2 dhe 3).

²⁸ Totali i pagave bruto të paguara përfshin: pagat neto të paguara për muajin raportues, tatimin personal të paguar dhe kontributet e paguara (për sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor, punësimin, sëmundjet profesionale dhe menaxhimin me ujë). Të dhënat i referohen pagave të paguara.


²⁹Rritja më e lartë e bruto -pagës se rritja e neto-pagës është rezultat i rritjes së normave me të cilat paguhen kontributet për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor dhe sigurimin e detyrueshëm shëndetësor. Normat me të cilat paguhen kontributet në vitin 2020 janë 18.8% për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor dhe 7.5% për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor (më parë shuma e këtyre normave ishte përkatësisht 18.4% dhe 7.4%).

Grafikoni 24
Bruto dhe neto pagat mesatare
(ndryshimet vjetore, në %)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe përlogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 25
Neto pagat mesatare sipas sektorëve
(ndryshimet vjetore, në %)




Për sa i përket treguesve të konkurrencës³⁰, në vitin 2020 vihet re një përkeqësim i mëtejshëm. Gjegjësisht, gjatë vitit produktiviteti i punës u zvogëlua për 3% (rënie prej 2% në vitin 2019), si rezultat i uljes së ndjeshme të vlerës së shtuar, në kushtet të zvogëlimit të vogël të numrit të personave të punësuar. Shikuar sipas sektorëve, kontribut më të madh negativ vjen nga sektori i shërbimeve dhe industrisë, ndërsa bujqësia ka një kontribut minimal pozitiv. Në përputhje me rritjen e pagave dhe rënien e produktivitetit, shpenzimet e punës për njësi produkti në 2020 janë më të larta për 11.7% (rritje prej 8.3% në vitin 2019), gjatë rritjes së madhe të shpenzimeve të punës te sektori i shërbimeve, ndërsa në një sasi më të vogël në industri, me rënie të shpenzimeve në punën e bujqësisë. Në mënyrë dinamike, treguesit e konkurrencës u përkeqësuan ndjeshëm në tremujorin e dytë të vitit, e cila ishte më së shumti e prekur nga masat për ballafaqim me pandeminë. Me rimëkëmbjen graduale ekonomike në gjysmën e dytë të vitit 2020, vërehen përmirësime të ndjeshme në të dy treguesit, kështu që në tremujorin e fundit të 2020 produktiviteti i punës arriti një rritje të vogël vjetore prej 1.4%, dhe rritja e shpenzimeve të punës për njësi produkti u reduktuan në 4.8%.

Grafikoni 26
Produktiviteti i punës
(kontributet drejt rritjes vjetore, në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe përlogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 27
Shpenzimet e punës sipas njësive të produktit
(kontributet drejt rritjes vjetore, në p.p.)




³⁰ Produktiviteti dhe shpenzimet e punës për njësi të produktit për të gjithë ekonominë janë llogaritur mbi bazë të të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave për: PBB, numri i personave të punësuar dhe bruto -paga mesatare. Produktiviteti total llogaritet si një shumë e ponderuar e produktivitetit të llogaritur në nivel të sektorit individual. Brenda secilit sektor, produktiviteti llogaritet si raport ndërmjet vlerës së shtuar në atë sektor dhe numri i personave të punësuar.

3.3. Financat publike

Financat publike në vitin 2020 u prekën më shumë nga pandemia Covid-19. Deficiti buxhetor në vitin 2020 u thellua ndjeshëm dhe arriti në 8.1% të PBB-së, krahasuar me deficitin e moderuar në katër vitet e fundit, mesatarisht 2.3% të PBB-së. Lëvizje të ngjashme u regjistruan në saldon primare buxhetore³¹, i cili arriti në 6.9% të PBB-së, krahasuar me deficitin mesatar buxhetor primar prej rreth 1% të PBB-së në katër vitet e fundit. Deficiti më i madh buxhetor është kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve buxhetore, si pasqyrë e masave fiskale të ndërmarra për zbutjen e pasojave ekonomike nga kriza shëndetësore. Një efekt shtesë, por dukshëm më i moderuar ishte rënia e të ardhurave buxhetore, në kushtet e rënies së aktivitetit ekonomik.

Duke pasur parasysh pandeminë, si një tronditje globale e papritur në fillim të vitit 2020, deficiti buxhetori i realizuar për vitin 2020 është realisht më i lartë nga plani i parë për atë vit. Madje në vitin 2020, në dy raste u realizua korigjim të deficiti të planifikuar fillestar 17.385 milionë denarë (2,6% të BPP-së) në 56.495 milionë denarë (8,5% të BPP-së), në përputhje me rregullimin në rënie të të ardhurave buxhetore, nga njëra anë, dhe rritjen e njëkohshme të shpenzimeve, nga ana tjetër. Megjithatë, deficiti i realizuar është pak më i ulët krahasuar me rebalancin e fundit³².

Grafikoni 28
Tregusit fiskal (% të PBB-së)




Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV.

³¹ Saldoja primare buxhetore është diferenca ndërmjet të hyrave totale buxhetore dhe shpenzimeve totale buxhetore, e zvogëluar nga shlyerja e detyrimeve rrjedhëse në bazë të huave (interesi). Ky tregues fiskal konsiderohet më i përshtatshëm në analizën e kursit aktual të politikës, për faktin se nuk integron shpenzimet fiskale që lidhen me sjelljen e politikës fiskale të kaluar në lidhje me borxhin publik.

³² Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 15 maj 2020, miratoi dekretin me fuqi ligjore për ndryshim dhe plotësim të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 126 të datës 15.5.2020). Më 4 nëntor 2020 është miratuar rebalanci i dytë i buxhetit për vitin 2020 ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 262 të datës 4.11.2020). Me rebalancin e dytë u planifikua deficit buxhetor prej 56.495 milionë denarë në vitin 2020, ndërsa deficiti buxhetor i realizuar ishte 53.866 milionë denarë.

Grafikoni 29

Të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore dhe komponentët e tyre kryesor (% të PBB-së)




Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e PBRMV.

Gjatë zvogëlimit të aktivitetit ekonomik, por edhe lehtësimin e taksave në kuadër të masave antikrizës për zbutjen e pasojave të krizës shëndetësore, të ardhurat totale buxhetore në vitin 2020 janë më të ulëta për 6,9% në bazë vjetore. Pjesa më e madhe e rënies së të hyrave totale rezultojnë nga zvogëlimi i të hyrave tatimore. Si rezultat i transferave të paguara në mbështetje të ndërmarrjeve dhe familjeve dhe rritjes së shpenzimeve për kujdesin shëndetësor, shpenzimet buxhetore shënuan rritje të ndjeshëm prej 12% në bazë vjetore. E shprehur përmes PBB-së, pjesëmarrja e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore në PBB në vitin 2020 ishte përkatësisht 28,6% dhe 36,7% (përkatësisht 29,6% dhe 31,5% në vitin 2019). Madje deficitin buxhetor të realizuar në vitin 2020 në pjesë më të madhe u financua kryesisht nga huamarrja e jashtme³³ e shtetit, ku një pjesë e hyrjeve mbaheshin si depozita të shtetit në Bankën Popullore. Njëherit, në këtë periudhë, shteti mori hua shtesë në tregun e brendshëm të letrave shtetërore me vlerë.

Grafikoni 30

Struktura e financimit të saldove buxhetore* (në miliona denarë)



* Ndryshim negativ të depozitave në strukturën e financimit të saldove buxhetore paraqet rritja e depozitëve të shtetit.


Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV.

³³ Në fillim të muajit prill, Fondi Monetar Ndërkombëtar miratoi mbështetjen financiare për vendin tonë, përmes Instrumentit të Financimit të Shpejtë, në vlerën prej rreth 176 milionë euro. Gjithashtu, në muajin qershor ka pasur flukse fondesh nga euroobligacioni i shtatë i lëshuar në shumë nominale prej 700 milionë euro, me normë vjetore të interesit 3,675% dhe afati pagesës 6 vjet. Në muajin tetor, në llogarinë shtetërore kishte hyrje prej 83 milionë euro, në formën e një hua në kuadër të ndihmës makrofinanciare nga Komisioni Evropian.

Rritja e nevojave për financim të buxhetit në vitin 2020 në një pjesë u financiar nga tregu primar vendor të letrave shtetërore në vlerë, me çka gjendja e letrave të lëshuara në vlerë u rrit për 21.511 milionë denarë³⁴ dhe në fund të vitit arriti në 127.865 milionë denarë. Emetimet e reja të letrave shtetërore me vlerë në pjesë më të madhe ishin me afatizues më të gjatë nga letrat me vlerë afatizuese të cilat mbrijnë, e cila kontribuoi për rritjen e përqindjes afatizuese të letrave shtetërore me vlerë të lëshuara, dhe, në këtë mënyrë në thellimin e këtij segmenti të tregut financiar, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së obligacioneve shtetërore në strukturën e letrave në vlerë. Zhvillime të favorshme janë vërejtur edhe në strukturën valutore, gjë e cila vihet re nga rritja e portofolit të letrave shtetërore me vlerë në monedhën vendase. Gjatë vitit 2020, letrat me vlerë të sapolëshuara ishin me normë më të ulët të interesit.


Grafikoni 31

Struktura valutore e letrave shtetërore me vlerë (në milionë denarë)



Grafikoni 32

Struktura afatizuese e letrave shtetërore me vlerë (në milionë denarë)



Burimi: Ministria e Financave dhe BPRMV.

Në kushte të deficitit më të lartë buxhetor dhe rritja e nevojave për financim të saj, në vitin 2020 borxhi i pushtetit qendror arriti 51,1% të BPP. Rritja vjetore e borxhit të pushtetit qendror është rezultat i rritjes së borxhit të jashtëm (prej 24,6% në 31,4% të BPP), dhe në të njëjtën kohë edhe rritje të borxhit të brendshëm (prej 15,9% në 19,7% të BPP). Totali i borxhit publik³⁵ në fund të vitit 2020 arriti 60,2% nga BPP. Rritja e borxhit publik rezulton nga rritja e borxhit publik të jashtëm (prej 33,1% në 40,2% të BPP), si dhe nga rritja e borxhit publik të brendshëm (prej 16,3% në 20,1% të BPP). Në kuadër të borxhit publik, totali i borxhit shtetëror (borxhi i pushtetit qendror, fondet publike dhe komunave) në vitin 2020 ka realizuar rritje prej 40,7% në 51,2% të BPP, ndërsa borxhi i ndërmarrjeve publike (garantuara ose të pagarantuara)³⁶ ishte në nivelin e 8,6% të BPP. Në fund të vitit 2020, pjesëmarrja e borxhit shtetëror në totalin e borxhit publik arriti 85,1% (82,2% në vitin 2019), ndërsa pjesëmarrja e borxhit të ndërmarrjeve publike (garantuara ose të pagarantuara) në totalin e borxhit publik arrin 14,3% (17% në vitin 2019).


³⁴ Borxhi publik definohet me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare" nr. 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019), sipas të cilit paraqet një mbledhje të borxhit shtetëror dhe të borxhit publik të ndërmarrjeve të themeluara nga shteti ose komuna, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqatat tregtare të cilat në tërësi ose në shumicë janë në pronësi të shtetit ose komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

³⁵ Borxhi publik definohet me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare" nr. 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019), sipas të cilit paraqet një mbledhje të borxhit shtetëror dhe të borxhit publik të ndërmarrjeve të themeluara nga shteti ose komuna, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqatat tregtare të cilat në tërësi ose në shumicë janë në pronësi të shtetit ose komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

³⁶ Në pajtim me ndryshimet në Ligjin për Borxhin Publik në maj 2019, borxhi i pagarantuar të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare të themeluara nga shteti ose komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit llogaritet në borxhin publik („Gazeta Zyrtare" nr. 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019).

Grafikoni 33

Borxhi i pushtetit qendror dhe borxhit i përgjithshëm publik (% të BPP)




Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV.

3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm


Gjatë vitit 2020, në kushte të rënies së tregtisë botërore dhe ndërprerjes së përkohshme të zinxhirëve globalë të prodhimit, uljes së ndjeshme të udhëtimeve, pasigurisë së lartë dhe një mjedisi të jashtëm kryesisht të pafavorshëm të shkaktuar nga paraqitja dhe përhapja e pandemisë Covid-19, deficiti i llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave mbeti në nivel të moderuar. Kështu, bilanci negativ në transaksionet rrjedhëse shënoi një zgjerim minimal vjetor prej 0,1 p. p. dhe arriti në 3,5% të PBB-së. Nga aspekti i komponentëve, thellimi i saldosit në llogarinë rrjedhëse në tërësi rezulton nga zvogëlimi i suficitit të hyrat dytësore si rezultat i flukseve -neto të ulëta ndjeshme nga puna e këmbimit. Masat restriktive për parandalimin e përhapjes së virusit dukshëm e zvogëluan lëvizjen e ndërkombëtare të pasagjerëve, gjë që shkaktoi një korigjim më të madh në rënie të flukseve hyrëse valutore nëpërmjet remitancave informale dhe një rregullim përkatës në rënie të parave neto të blera në tregun këmbimor. Nga ana tjetër, vihet re një rritje e flukseve hyrëse valutore nëpërmjet kanaleve formale (transfera personale). Këto lëvizje të pafavorshme u zbutën në masë të madhe nga përmirësimi i suficitit të shërbimeve, si pasojë e rregullimit më të theksuar në rënie në kahun e importit, uljes së deficitit në të ardhurat primare, por edhe uljes së deficitit tregtar, i arritur në kushtet e rënies më të madhe të importeve në raport me rënien e eksporteve të mallrave, e cila në masë të madhe vjen si pasojë e përshtatjes relativisht të shpejtë të kapaciteteve eksportuese drejt situatës së re të krijuar dhe rimëkëmbjes solide të zinxhirëve të prodhimit. Ecuria më e mirë në kategorinë "shërbime" rezulton nga suficiti më i lartë në shërbimet e tjera afariste, pothuajse nga saldosi neutral të ndërtimtarisë (në krahasim me deficitin e lartë në vitin e kaluar) dhe nga suficiti i rritur të shërbimeve telekomunikuese, kompjuterike dhe informuese.

Grafikoni 34
Llogaria rrjedhëse dhe financiare
(në milionë euro)




Burimi: BPRMV.

Grafikoni 35
Komponentët bazë të llogarisë rrjedhëse
(% të BPP)




Deficiti në këmbimin e mallrave jashtë vendit në vitin 2020 ka shënuar ngushtim të bazës vjetore prej 9,8% (ose 1,3 p.p të PBV-së), përkundër zgjerimit në vitin paraprak. Madje, lëvizjet në të dy komponentët e këmbimit të jashtëm tregtar ishin nën ndikim të ndjeshëm të pandemisë të shkaktuar nga virusi Covid-19 dhe sfidat ekonomike si rezultat i krizës shëndetësore. Eksportet e mallrave shënuan rënie prej 10% në bazë vjetore, kryesisht si pasojë e uljes së eksporteve të pajisjeve dhe makinerive, si dhe rënies së eksporteve të produkteve kimike dhe veshjeve dhe tekstileve. Arritje të tilla shkaktohen kryesisht nga ndërprerja e përkohshme e funksionimit të kapaciteteve të orientuara drejt eksportit nga industria automobilistike, si pasojë e çrregullimit të zinxhirëve të furnizimit global dhe futjes së masave rigorozë restriktive në ekonominë vendase dhe brenda vendeve të BE-së, veçanërisht e shprehur në tremujorin e dytë të vitit. Ashtu që në gjysmën e dytë të vitit, aktiviteti total i eksporteve shënoi rikëmbjeje relativisht të shpejtë, duke shënuar një rritje të vogël të bazës vjetore. Ulja e eksporteve, ulja e kërkesave të brendshme, si dhe rënia e çmimeve të energjisë për shkak të pandemisë çuan në uljen e komponentit të importit të këmbimit të jashtëm tregtar. Kështu, importi i mallrave shënoi një rënie vjetore prej 10%, në kushtet e rënies së ndjeshme të importeve të energjisë, më konkretisht të derivateve të naftës, si dhe uljes së importeve të lëndëve të para të kapaciteteve të orientuara nga eksporti në ekonomi, e cila vihet re përmes uljes së importeve të metaleve me ngjyra dhe makinerive dhe pajisjeve të transportit. Kontributi i konsiderueshëm i komponentit energjetik në rënieën e importeve i detyrohet njëkohësisht uljes së çmimeve të importit, si rezultat e rënies së lartë të çmimeve të bursës, por edhe rënies së theksuar sasiore të importit të derivateve të naftës, për shkak të uljes së konsumit të shkaktuar nga kufizimet në udhëtimet ndërkombëtare dhe të brendshme si masë për parandalimin e përhapjes së virusit.

Grafikoni 36
Kontributi në ndryshimet vjetore të eksportit (në p.p.)




Burimi: ESHS.

Grafikoni 37
Kontributi në ndryshimet vjetore të importit (në p.p.)




Përsa i përket treguesve të konkurrueshmërisë së çmimeve të ekonomisë së vendit³⁷, në vitin 2020 kursi real efektiv i këmbimit i deflatuar nga shpenzimet e jetesës është vlerësuar me 1.3% në bazë vjetore, ndërkohë që rritja e indeksit të llogaritur me çmimet e prodhuesve të produkteve industriale është më e theksuar dhe arrin 3,6%. Kursi nominal efektiv i këmbimit valutor u vlerësua me 1,5% në bazë vjetore, e cila rezulton pas uljes së vlerës së mëtejshëm, por më të theksuar të lirës turke ndaj denarit. Shpenzimet relative e jetesës edhe këtë vit gjithashtu shënojnë rënie në bazë vjetore, por dukshëm më e moderuar (me vetëm 0,2%). Nga ana tjetër, pas rënies në tre vitet e mëparshme, çmimet relative të prodhuesve të produkteve industriale në vitin 2020 shënuan rritje (me 2%), në kushtet e një dinamike të mëtejshme të lehtë të rritjes së çmimeve vendase, ndërsa uljes së çmimeve të huaja.

Grafikoni 38
KKEN dhe KREK, pa produktet primare të përlllogaritura sipas indeksit të shpenzimeve për jetesë dhe çmimet e prodhuesve (2015=100)



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 39
Çmimet relative
(2015=100)




³⁷ Analiza e treguesve për konkurrueshmërisë së çmimeve bazohet në indekset e RKEK, të kalkuluar me ponder të bazuar në këmbimin tregtar të jashtëm pa produkte primare. Produktet primare që mbeten të papërfshira në përlllogaritje janë: nafta dhe derivatet e naftës, çeliku dhe hekuri, mineralet dhe lëndët e para të importuara për kapacitetet e reja industriale në zonat e lira ekonomike

Indekset e KREK-it të llogaritura sipas shpenzimeve të njësisë së fuqisë punëtore³⁸ tregojnë gjithashtu mbiçmim në vitin 2020. Më konkretisht, indeksi i KREK i llogarit me ponderet e bazuara në totalin e këmbimit tregtarë të jashtë shënoi mbiçmim prej 8,2%, gjatë mbiçmim të moderuar të KKEN me 2% dhe rritje vjetore më të theksuar të shpenzimeve relative të fuqisë punëtore prej 6,1%. Mbiçmimi në bazë vjetore shënoi edhe indeksi i KREK e llogarit me ponderët të bazuar mbi këmbimin tregtar të jashtëm pa produktet primare edhe atë prej 8,9%, si rezultat i rritjes së shpenzimeve relative të fuqisë punëtore me 7,2%, si dhe mbiçmimit të KKEN në bazë vjetore me 1,5%.


Grafikoni 40

KREK (të përlogaritur sipas shpenzime të indeksit për fuqinë punëtore, 2015=100)



Grafikoni 41

KREK, pa produktet primare (të përlogaritur sipas shpenzimeve të indeksit për fuqinë punëtore, 2015=100)




Në vitin 2020, në llogarinë financiare të bilancit të pagesave janë realizuar neto-hyrje prej 447.9 milionë euro, ose 4,2% e PBB-së, të cilat mundësuan financimin e plotë të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe njëkohësisht rritjen e rezervave valutore. Flukset e favorshme janë rezultat i neto-hyrjeve të realizuara pothuajse në të gjithë komponentët e llogarisë financiare, me përjashtim të kategorisë së valutave dhe depozitave ku vazhdon trendi i neto-daljeve të realizuara. Flukset financiare pozitive vijnë kryesisht nga huamarrja e shtetit jashtë vendit, nëpërmjet lëshimit të euroobligacioneve të reja në tregu ndërkombëtarë të kapitalit³⁹ dhe në formën e kredive afatgjata nga institucionet financiare ndërkombëtare⁴⁰. Flukse neto-hyrëse shtesë janë realizuar edhe mbi bazë të huamarrjeve afatgjate të sektorit privat dhe mbi bazë të kredive tregtare. Burim i rëndësishëm i hyrjeve në llogarinë financiare ishin investimet e drejtpërdrejta, të cilat në vitin 2020 arritën vlerën 205,7 milionë euro, ose 1,9% e PBB-së, por më e ulët në raport me realizimet e vitit paraprak (3.2% e PBB-së). Në lidhje me strukturën e investimeve e drejtpërdrejta, ato rrjedhin pothuajse tërësisht nga flukset neto-hyrëse të bazuara në borxhin ndërkombanive dhe kapitalit aksioner. Lëvizjet tek valutat dhe depozitat kushtëzohen tërësisht nga sjellja e sektorëve të tjerë të ekonomisë (kryesisht e popullsisë), me një rënie të vogël të mjeteve valutore të bankave në llogaritë jashtë vendit.

³⁸ Indekset e KREK të bazuara mbi shpenzimet e fuqisë punëtore për njësi janë përlogaritje të brendshme të BPRMV dhe nuk paraqesin një hulumtim statistikor formal. Në përlogaritjen përdoren të dhënat të gatshme për indeksin e shpenzimeve të fuqisë punëtore për njësi në nivel të ekonomisë, të cilat janë të shpallura nga ana e BQE, Byroja e Statistikave të Punës e SHBA dhe OECD. Përjashtim bëjnë të dhënat e bazuara në përlogaritjet e brendshme, më konkretisht për Rusinë dhe Serbinë, ku indekset e përlogaritura për Serbinë i referohen vetëm nivelit të sektorit industrial.

³⁹ Në maj 2020, Ministria e Financave e lëshoi euroobligacionin e shtatë në vlerën 700 milionë euro dhe me normë të interesit prej 3,675%.


⁴⁰ Në prill 2020, Ministria e Financave mori hua nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), ahstu që në bazë të Instrumentit për financim të shpejtë tërhoqi mjete në shumë prej 176,8 milionë denarë, ndërsa në tremujorin e fundit u tërhoqën mjete nga Komisioni Evropian në shumë prej rreth 80 milionë euro dhe nga Banka Botërore në shumë prej rreth 32 milionë euro.

Grafikoni 42
Llogaria financiare
(% të BPP)




Burimi: BPRMV.

Grafikoni 43
Investimet të drejtpërdrejta
(% të BPP)




Në fund të vitit 2020, pozita neto investuese ndërkombëtare (PIN) në ekonominë e Maqedonisë arrin 7.019,2 m, ose 65,2% të PBB. Në bazë vjetore, ajo është më e lartë për 7,6 pikë përqindje nga PBB, me rritje të lartë të detyrimeve ndërkombëtare në raport me rritje të mjeteve ndërkombëtare (përkatësisht për 10,0 p.p. dhe 2,4 p.p. të BPP). Analiza sektoriale e PIN tregon se rritja e saj në pjesë më të madhe detyrohet rritjes neto-detyrimeve të shtetit, përkatësisht neto-detyrime më të larta në bazë të investimeve dhe huave portfolie. Gjithashtu, rritja e neto-detyrimeve shënojnë edhe sektorët e tjetër të ekonomisë (kryesisht për shkak të neto-detyrime më të larta drejt investorëve të drejtpërdrejt) si dhe institucionet depozitare (të cilat neto-detyrimet e larta dalin pothuajse nga neto-detyrimet e larta në bazë të kredive afatgjate). Nga ana tjetër, zhvendosje të favorshme shënojnë edhe neto-pozicionet e bankës qendrore, si rezultat i rritjes së rezervave valutore.

Grafikoni 44
Pozitata ndërkombëtare investituese
(% të PBB)



Burimi: BPRMV.


Grafikoni 45
Pozitata ndërkombëtare investituese, sipas sektorëve (% të PBB)



Gjendja e borxhit të jashtëm bruto, në fund të vitit 2020, arriti në 8.630,3 milionë euro, ose 80,2% e PBB-së, që në bazë vjetore paraqet një rritje prej 7.4 p.p. të PBB-së. Kjo zhvendosje vjen kryesisht nga rritja e borxhit të sektorit publik për 5,7 p.p. e PBB-së, në kushtet e rritjes së borxhit privat për 1,7 p.p. të PBB-së. Rritja e borxhit të sektorit publik është kryesisht për shkak të borxhit më të lartë të pushtetit qendror (për shkak të lëshimit të euroobligacionit, si dhe huat nga institucionet financiare ndërkombëtare), ndërsa në pjesë e vogël edhe nga borxhi i lartë i bankave publike. Në të njëjtën kohë, rritja vjetore e borxhit privat kryesisht rezulton nga borxhi më i lartë i bazuar në huat afatgjata ndaj sektorit privat jobankar dhe bankave komerciale, me rritje të vogël edhe të borxhi ndërkompanive.

Grafikoni 46

Borxhi i jashtëm bruto, sipas huazuesve dhe sektorëve institucional (% e PBB)



Burimi: BPRMV.

Treguesit e borxhit të jashtëm të ekonomisë së brendshme edhe më tej mbeten në zonën e sigurt. Treguesi i pjesëmarrjes së borxhit bruto të jashtëm në PBB-së edhe më tej e klasifikon ekonominë në grupe të vende me borxhe të larta, ndërsa të gjitha treguesit e tjerë qojnë në borxh më të ulët. Analiza dinamike qon në përmirësim të treguesve të likuiditetit, me zhvendosje të vogla në rritje në pothuajse të gjithë treguesit e aftësisë paguese.

Më 31.12.2020, borxhi i jashtëm neto arriti në 3.391,5 milionë euro, ose 31,5% të PBB-së, që është një rritje vjetore prej 6,5 p.p. të PBB-së. Borxhi i jashtëm neto më i lartë vjen si pasojë e rritjes së borxhit neto publik dhe privat (përkatesisht me 4,1 p.p. dhe 2,4 pp të PBB-së).

Tabela 1

Treguesit e borxhit të jashtëm

	<i>Solventiteti</i>			<i>Likuiditeti</i>			
	Pagesa e interesit/eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto borxhi/eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto borxhi/PBB	Pagesa e borxhit/Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Rezervat valutore/Borxhi afatshkurtër	Rezervat valutore/Borxhi afatshkurtër me maturim të mbetur*	Borxhi afatshkurtër/Borxhi i përgjithshëm
	vo %			сооднос			
31.12.2004	2,41	129,3	47,3	12,4	1,14	0,89	30,27
31.12.2005	2,66	147,0	54,2	11,1	1,67	1,04	26,67
31.12.2006	3,44	131,3	49,8	21,7	1,95	1,34	28,98
31.12.2007	2,78	119,3	51,3	19,4	1,35	1,08	39,82
31.12.2008	2,66	116,9	54,1	10,2	1,29	0,95	35,19
31.12.2009	2,43	131,0	57,8	11,8	1,29	0,94	32,86
31.12.2010	3,22	140,4	59,7	13,9	1,49	0,99	27,93
31.12.2011	3,12	148,4	64,6	16,8	1,78	1,18	25,22
31.12.2012	2,92	142,1	67,6	13,1	1,64	1,03	26,66
31.12.2013	2,51	137,3	67,3	15,8	1,64	1,08	23,31
31.12.2014	3,01	149,1	74,0	17,2	1,82	1,13	22,32
31.12.2015	2,68	143,8	73,2	20,0	1,69	1,13	21,32
31.12.2016	2,38	149,9	79,3	14,9	1,65	1,16	21,93
31.12.2017	2,69	140,1	77,2	12,7	1,31	0,89	24,03
31.12.2018	2,22	131,4	77,4	15,8	1,42	1,04	25,75
31.12.2019	1,96	117,2	72,7	8,6	1,56	1,02	25,58
31.12.2020	2,11	137,9	80,2	15,1	1,85	1,08	21,03
<i>Kriteret për borxhin të moderuar</i>	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1,00		

*Kriteri i ngarkesës së moderuar me borxh është matur sipas metodologjisë së Bankës Botërore për përpunimin e treguesve të huazimit, e cila nënkupton shfrytëzimin e proceseve tre vjeçare lëvizëse të PBB dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe prurjeve tjera si emëruet të përbashkët të përllogaritjeve të këtyre treguesve. E përpiluar në pajtim me „External debt statistics: Guide for compilers and users”, e lëshuar nga FMN.


Sipas parimeve të Grinspan dhe Gvidoti, e nevojshme është që vendi të ruaj mbulim të plotë të borxhit afatshkurtë (maturimi i pjesës së ngelur) me rezerva valutore. Cropepa
Burimi: BPRMV.

3.5. Agregatet monetare dhe kreditorë⁴¹

3.5.1. Agregatet monetar


Gjatë vitit 2020, ekonomia e vendit u ballafaqua me një të papritur të shkaktuar nga përhapja e infeksionit të virusit covid-19. Në rrethana të tilla, oferta monetare dhe depozitat totale në sektorin financiar⁴² edhe më tej rriten, por më të moderuar në krahasim me vitin paraprak. Madje, masat për mbështetjen financiare të kompanive të prekura nga kriza dhe të ardhurat e disponueshme të familjeve, si dhe masa për vonesën e shlyerjes së kredive ndikuan pjesërisht në dinamikën e ofertës monetare dhe të depozitave gjatë vitit, në kushte më të mëdha të frenimit nga konsumi dhe investimet.

Grafikoni 47
Masa monetare M4 dhe totali i depozitave



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 48
Masa monetare M4, pjesëmarrja në PBB



Masa më e madhe monetare M4, në vitin 2020 shënoi rritje prej 6,9%, e cila paraqet një intensitet më të ulët në krahasim me vitin paraprak (9,3%). Shikuar në mënyrë strukturore, në kushtet e rritjes së pasigurisë për shkak të pandemisë dhe tendencës për mbajtjen e aktiveve në formë likuide, shënohet rritje e përbërësve më likuidë të M4 - para të gatshme në qarkullim dhe parave të depozituara. Konkretisht, gjatë vitit vërehet një përshpejtim i ndjeshëm i rritjes vjetore të parasë së gatshme në qarkullim (nga 12% në vitin 2019 në 21% në vitin 2020), madje edhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në masën më të gjerë monetare M4 (nga 7,9% në vitin 2019 në 9% në vitin 2020). Nga aspekti afatizues, vërehet një rënie e depozitave afatgjata, duke përshpejtuar rritjen e depozitave afatshkurte. Sipas rritjes më të ngadaltë monetare, treguesi i pjesëmarrjes në ndryshimin vjetor të masës monetare në raport me PBB në fund të vitit ishte 4,7% dhe është më i ulët në krahasim me vitin e kaluar (5,6%). Nga ana tjetër, për shkak të efektit të theksuar negativ në aktivitetin ekonomik, pjesëmarrja e masës monetare në PBB edhe më tej vazhdon të rritet dhe në fund të vitit ishte 73,3%, në krahasim me 66,1% të vitit paraprak.

⁴¹ Të dhënat e depozitave totale dhe kredive nga gushti 2020 e këndej nuk i përfshinë të dhënat e një banke e cila në gusht 2020 i është ndërprerë leja e themelimit dhe funksionimit dhe është hapur procedura e falimentimit. Me qëllim që në mënyrë më reale të shikohen rrjedhat e arritura në sistemin banka, pa efektin e ndryshimit të tillë në pasqyrën e të dhënave të statistikës monetare, e cila realizimet e depozitave të përgjithshme dhe rrjedhave të kreditive në vitin 2020 janë bërë rregullimet e flukseve të të dhënave për bankat përkatëse. Gjegjësisht, korrigjimi i totalit të depozitave është bërë duke përfshirë shumën e depozitave të cilat nuk i nënshtrohen kompensimit përmes FOD në gjendjen rrjedhëse të gjithsej depozitave, ndërsa korrigjimi i totalit të kredive është bërë duke përfshirë të dhënat e korrikut për gjendjen e bankave në gjendjen aktuale të totalit të kredive.

⁴² Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshitetëror në banka dhe kursimore, mjeteve të institucioneve të tjera financiare në llogaritë në Bankës Popullore dhe mjeteve të njëjësive të vetëqeverisjes lokale në llogaritë e Bankës Popullore. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në linkun e mëposhtëm:

http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.


Tabela 2
Komponentë të masës monetare – gjendjet dhe ndryshimet

	Gjendja			Ndryshimet vjetore		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020
	në milionë denarë			në %		
Paratë e gatshme në qarkullim	32.233	36.108	43.696	7,6	12,0	21,0
Paratë në depozitë	117.616	139.580	160.765	22,1	18,7	15,2
M1	149.849	175.688	204.461	18,7	17,2	16,4
Depozita afatshkurtër në denarë deri 1 vjet	49.487	49.042	44.042	3,5	-0,9	-10,2
Depozita afatshkurtër valutore deri në 1 vjet	114.501	120.160	134.950	7,4	4,9	12,3
M2	313.837	344.889	383.453	11,8	9,9	11,2
Depozita afatgjate në denarë mbi 1 deri 2 vjet	38.132	36.845	30.665	1,9	-3,4	-16,8
Depozita afatgjate valutore mbi 1 deri 2 vjet	21.466	22.294	22.108	13,4	3,9	-0,8
M3	373.436	404.028	436.226	10,8	8,2	8,0
Depozita afatgjate në denarë mbi 2 vjet	29.369	35.767	34.667	29,7	21,8	-3,1
Depozita afatgjate në valutë mbi 2 vjet	14.010	15.616	16.092	5,4	11,5	3,0
Gjithsej depozita*	266.965	279.723	282.523	8,2	4,8	1,0
Gjithsej depozita	384.581	419.303	443.288	12,1	9,0	5,7
M4	416.814	455.411	486.984	11,8	9,3	6,9

*pa para depozitare

Burimi: BPRMV.


Grafikoni 49
Masa monetare, ndryshimet vjetore dhe struktura



Në vitin 2020, totali i depozitave në sektorin financiar realizoi rritje prej 5,7%⁴³, e cila ishte më e dobët në krahasim me vitin paraprak (9,0%). Analizuar nga aspekti sektorial, edhe këtë vit bartës i rritjes janë depozitat e familjeve, të shtuara nga kontributi i depozitave të ndërmarrjeve. Analizuar nga aspekti valutor dhe afatizues, është shënuar ndryshim në krahasim me vitin paraprak, më saktë rritja e kontributeve të depozitave valutor dhe depozitave afatshkurte. Megjithatë, depozitat në monedhën vendase vazhdojnë të rriten (në tërësi si rezultat i parave depozitare), por dukshëm më të ulëta se në periudhën e mëparshme.

Grafikoni 50

Totali i depozitave (me para depozitare), ndryshimi vjetor dhe kontributi në ndryshimin e aspektit sektorial



Burimi: BPRMV.


Depozitat e familjeve⁴⁴ shënuan rritje vjetore prej 4,6% në vitin 2020 (7,9% në vitin 2019). E analizuar nga aspekti strukturës valutore dhe afatizuese, rritja edhe këtë vit rezulton si pjesë më të madhe nga rritja e parasë depozituese. Njëherit, vazhdon edhe rritja e kursimeve në afat të shkurtë, gjatë zvogëlimit të depozitave afatshkurte. Gjatë vitit, amvisëritë treguan prirje më të madhe për të kursyer në valutë të huaj, për dallim nga viti paraprak kur mbizotëruan depozitat në denarë (përfshirë paratë e depozitave).

⁴³ Me përfshirjen e të dhënave nga banka në falimentim, rritja e depozitave në vitin 2020 është 6,3%.

⁴⁴ Të dhënat e depozitave përfshijnë paratë depozituese.

Grafikoni 51


Totali i depozitave të familjeve, ndryshimi vjetor dhe kontributi në ndryshim sipas strukturës afatizuese dhe valutore



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 52

Totali i depozitave të ndërmarrjeve, ndryshimi vjetor dhe kontributi në strukturën afatizuese dhe valutore



Në vitin 2020, depozitat e ndërmarrjeve shënojnë rritje prej 10,1% (14,6% në vitin 2019). Kontributin më të madh në rritje kanë para e depozitave, me rritjen e depozitave afatshkurtra dhe afatgjata. Nga aspekti valutore, depozitat në valutë kontribuojnë në pjesën më të madhe të rritjes së gjithsej depozitave të ndërmarrjeve, me kontribut pozitiv dukshëm më të ulët të depozitave në denarë (përfshirë paratë e depozituara) në krahasim me vitin paraprak.


Duke pasur parasysh arritjet e tilla, shkalla e euroizimit, e matur përmes pjesëmarrjes së depozitave në valutë në totalin e depozitave të sistemit bankar, në vitin 2020 është rritur mesatarisht në nivel prej 39.8% (38.5% në vitin paraprak). Te depozitat e familjeve, pjesëmarrja e depozitave me komponentë valutore arrin 47,1% (46,4% në vitin paraprak). Megjithatë, rritja e prirjes së familjeve për të kursyer në valutë të huaj është më e moderuar nëse e krahasojmë me krizën e vitit 2009, kur pjesëmarrja e depozitave në valutë në totalin e depozitave të familjeve u rrit për 6,5 p.p. krahasuar me vitin 2008 dhe arriti në 65,3%.

3.5.2. Aktiviteti kreditues

Mbështetje kreditore solide të sistemit bankar në ekonominë e vendit vazhdoi edhe gjatë vitit 2020, por më e moderuar në raport me vitin paraprak. Totali i kredive në vitin 2020 shënoi rritje vjetore prej 4,7%⁴⁵ dhe ishte më i moderuar në raport me vitin e kaluar (6,0%). Duke pasur parasysh efektet negative të pandemisë, Banka Popullore në fillim të krizës e zvogëloi bazën e normës së interesit dhe solli varg masa lehtësuese të kushteve kreditore dhe për sigurimin e likuiditetit plotësues të sistemit bankar, për shkak të nxitjes së aktivitetit kreditor. Treguesi i pjesëmarrjes në rritjen vjetore të totalit të kredive në PBB në fund të vitit 2020 ishte 2,4 p.p. në krahasim me 2,8 p.p. në vitin 2019, ndërsa për shkak të rënies së aktivitetit ekonomik, pjesëmarrja e kredive në PBB u rrit në 53,8% (49,5% në vitin paraprak).


⁴⁵ Me përfshirje të gjendjes së kredive të miratuara nga bankat e falimentuara, rritja kreditore në vitin 2020 arrin 6,4%.

Grafikoni 53
Totali i kredive dhe norma aktive e interesit



Burimi: BPRMV.


Grafikon 54
Totali i kredive, pjesëmarrja në PBB



Zhvendosje të tilla në kreditimin korrespondojnë pjesërisht me perceptimet e bankave për rritjen e rreziqeve, në kushtet e një mjedisi të pasigurt makroekonomik si rezultat i krizës shëndetësore. Sipas anketave për aktivitetin kreditues të Bankës Popullore, në vitin 2020 shënohet neto-rënie të kërkesave për kredi nga ana e familjeve dhe ndërmarrjeve, me lehtësim të mëtejshëm neto kushteve të kreditimit në të dy sektorët. Nga aspekti i rrezikut, në raport me ndërmarrjet vërehet rritje e perceptimit të rrezikut, analizuar nëpërmjet pritjeve të bankave për totalin e aktivitetit ekonomik⁴⁶.


Kredia e miratuara për sektorin "familje" edhe më tej vazhdojnë të jenë bartës kryesor të rritjes vjetore të totalit të kredive, ndërsa një kontribut më të vogël pozitiv ka kreditimi për sektorin e korporatave. Sa i përket kreditimit për familjet, analiza sipas llojeve të veçanta të kredive tregon se nxitës i rritjes është kreditë banesore, ndërkohë ngadalësimi i rritjes së kredisë konsumatore. Nga aspekti valutor dhe afatizues, rritja vjetore e gjithsej kredive në masë të madhe është rezultat i kredive në denarë, si dhe i kredive afatgjate.

Grafikoni 55
Totali i kredive, ndryshimi vjetor dhe struktura sektoriale



Burimi: BPRMV.


Grafikoni 56
Totali i kredive për familjet, ndryshimi vjetor dhe struktura sipas dedikimit



*Në totalin e kredive të popullatës nuk janë përfshirë kreditë të veprimtarive të aktiviteve të pavarura - me vetëpunësim.

⁴⁶ Rreth një e treta e bankave të anketuara vlerësuan se pritshmëritë e faktorëve për totalin e aktivitetit ekonomik kontribuojnë në neto-shtrëngim të kushteve të kreditimit të ndërmarrjeve.


Grafikoni 57
Oferta dhe kërkesa
(neto-përqindje)*



* Te kushtet e kreditimit, neto-përqindja negative nënkupton lehtësim të kushteve të kreditimit. Të kërkesa, neto-përqindja negative nënkupton ulje të kërkesës.

Të dhëna më të hollësishme mbi aktivitetin kreditues mundet të gjenden në faqen zyrtare të BPRMV.
Burimi: Anketa mbi aktivitetin kreditues, BPRMV.

Grafikoni 58
Analiza të riskut nga ana e bankave
(neto- përqindje)*



* Te familjet është paraqitur mesatarja e neto-përqindjeve të faktorëve të riskut të cilat ndikojnë mbi kushtet e kreditimit gjatë miratimit të kredive banesore dhe atyre të konsumit.

IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2021 dhe 2023⁴⁷

Me projeksionet makro-ekonomike të Bankës Popullore nga tetori 2020 u vë në dukje se pandemia e shkaktuar nga virusi korona dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e shëndetit publik gjatë vitit 2020, kishin ndikim të madh negativ si ndaj ekonomisë globale ashtu edhe ndaj asaj vendore. Reagimi i shpejtë, në kohë dhe i koordinuar i politikës monetare dhe fiskale si përgjigje e krizës në suaza globale, ka zbutur tronditjen fillestare ndaj sektorit real. Në kushte të vazhdimit të pandemisë, paraqitja e valës së dytë dhe mutacioneve të virusit, politikat u përshtatën deri në fund të vitit ndërsa pritet se pozicionimi i këtyre të mbahet për periudhë më të gjatë, përkatësisht deri në rimëkëmbjen e qëndrueshme të sektorit real nga gjendja e krizës.

Banka Popullore, duke zhvilluar politikë të përshtatur monetare gjatë vitit 2020, këmbëngulte që të kontribuojë në zbutjen e efekteve negative nga pandemia e Kovid-19 ndaj ekonomisë vendore ndërsa në kushte të nivelit solid të rezervave valutore dhe mungesës së presioneve të inflacionit. Zbutja e politikës monetare ka kontribuar për mbështetjen e rrjedhave kreditore në ekonomi dhe rritjen e likuiditetit në sistemin bankar. Gjithashtu, me ndryshimet e rregullativës bankare është siguruar fleksibilitet më i madh i bankave dhe mirëmbajtje të ciklit kreditor.

Politika monetare e Bankës Popullore edhe më tej do të jetë drejt mbajtjes së qëndrueshmërisë së çmimeve, si qëllim elementar monetar, i përkufizuar sipas dispozitave ligjore. Banka Popullore edhe në periudhën e ardhshme do të kontribuojë për mbajtjen e një sektori të qëndrueshëm dhe konkurrues bankar dhe do ta mbështes politikën e përgjithshme ekonomike, pa e rrezikuar realizimin e qëllimit elementar. Për realizimin e qëllimit të përkufizuar ligjor, Banka Popullore do të vazhdojë me zbatimin e strategjisë për mbajtjen e qëndrueshmërisë nominale të kursit devizor të denarit në raport me euron. Domethënia e kursit devizor për mbajtjen e qëndrueshmërisë së çmimeve dhe pritjet e qëndrueshme të inflacionit për subjektet ekonomike dalin nga karakteristikat e ekonomisë vendore si ekonomi e vogël dhe e hapur, me varësi të lartë importuese. Korniza operative e politikës monetare, si edhe deri më tani, do të vendoset në një bazë fleksibile, që do të mundësojë likuiditet të qëndrueshëm dhe baraspeshë në tregun devizor. Kështu, politika monetare do të kontribuojë për mbajtjen e qëndrueshmërisë së përgjithshme makro- ekonomike, si faktor kyç në krijimin e një mjedisi të volitshëm për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Sipas projeksioneve makro- ekonomike të Bankës Popullore në tetor 2020, zbatimi i politikës monetare në periudhën 2021-2023 do të zhvillohet në mjedis të theksuar të pasigurt. Pasojat e krizës do të ndjehen edhe në vitin 2021 ndërsa rimëkëmbja e plotë dhe kompensimi i humbjeve në ekonomi pritet gjatë vitit 2022. Suksesi më i madh në fushën e vaksinave dhe terapitë kundër virusit korona si dhe nxitja shtesë nga bartësit e politikave, mund t'i përmirësojnë pikëpamjet për rimëkëmbje ekonomike. Përndryshe, nëse vaksinat janë efikase edhe kundër mutacioneve të reja të virusit korona, bota mund të dalë nga kriza me pasoja që do të ishin më të vogla se vlerësimet aktuale. Nga ana tjetër, me zbatimin e ngadalshëm të programeve të imunizimit, efikasiteti më i vogël i vaksinave në raport me mutacionet e virusit, tërheqja eventuale e parakohshme e mbështetjes nga bartësit e politikave si dhe shtrëngimi eventual i kushteve financiare, seriozisht mund ta ngadalësojë rrugën e rimëkëmbjes ekonomike.

⁴⁷ Në këtë pjesë është dhënë pasqyrë e projeksioneve makroekonomike të Bankës Popullore deri më tetor 2020.

Lidhur me aktivitetin e ekonomisë së Maqedonisë, për vitin 2021 dhe 2022 priten norma të rritjes ekonomike që do të arrijnë 3,9% dhe 3,6%, në mënyrë përkatëse. Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik në vitin 2021-2022 do të mbështetet nga kërkesa vendore, në kushte të qëndrueshmërisë së tregut të punës, vazhdimësisë së rrjedhave kreditore, rritjes së besimit dhe rimëkëmbjes së konsumit personal, sidomos të investimeve. Gjithashtu, një impuls ndaj rritjes pritet edhe nga segmenti eksportues, që në mënyrë relative rimëkëmbet shpejtë, i mbështetur nga normalizimi i zinxhirëve global të prodhimitarisë ndërsa në periudhën e ardhshme edhe nga rimëkëmbja e kërkesës së jashtme. Për vitin 2023, pritet normë e rritjes reale të ekonomisë vendore prej 4%.

Lidhur me rrugën e ardhshme të lëvizjes së çmimeve në ekonominë vendore, pritet mbajtja e mjedisit të çmimeve të qëndrueshme dhe mungesës së presioneve më të dukshme të inflacionit. Sipas projeksioneve të tetorit, për vitin 2021, pritet që norma e inflacionit mesatarisht të përshpetohet dhe të arrijë 1,5%, ku duhet të merret parasysh se lëvizjet aktuale tregojnë për rritjen e rreziqeve. Me projeksionet e tetorit, pritet që inflacioni të afrohet deri në nivelin e rreth 2% në 2022-2023, edhe atë në kushte të rimëkëmbjes graduale të kërkesës dhe rritjes mesatare të çmimeve importuese. Pasiguria e lartë lidhur me dinamikën e ardhshme të çmimeve të bursës të produkteve elementare edhe më tej është faktor rreziku i projeksionit. Përndryshe, vlerësimet për çmimet e produkteve elementare janë jashtëzakonisht të ndryshueshme dhe aktualisht janë nën ndikimin e theksuar nga ngjarjet që lidhen me pandeminë, që krijon pasiguri më të madhe rreth dinamikës së tyre të ardhshme, edhe në afat të shkurt, edhe në afat të mesëm.

Pavarësisht tronditjes së shkaktuar nga pandemia, pozicioni i jashtëm i ekonomisë është ende i qëndrueshëm. Për periudhën e ardhshme pritet të ulet deficitin në këmbimin e mallrave dhe shërbimeve, gjatë rimëkëmbjes së eksportit, por edhe presione më të larta importuese në kushtet e aktivitetit ekonomik më dinamik. Nga ana tjetër, normalizimi i situatës pandemike do të sillte rritje graduale të remitancave të gatshme. Në rrethana të tilla, deficitin i llogarisë aktuale do të mbetet mesatar gjegjësisht në nivelin 2.6% të PBV-së në vitin 2021 dhe do të zbriste mesatarisht në 1.6% të PBV-së në periudhën e ardhshme. Për sa i përket financimit, supozohet qasje e papenguar në tregjet financiare ndërkombëtare dhe pritet huamarrje shtesë e jashtme si e sektorit publik ashtu edhe atij privat si dhe një fluks i investimeve të huaja. Në periudhën e projeksioneve, rezervat devizore janë rritur kurse treguesit e përshtatshmëris janë në zonën e sigurt.

Aktiviteti kreditues i sistemit bankar do të vazhdojë të jetë një nga faktorët e rëndësishëm për mbështetjen e rritjes ekonomike. Në këtë drejtim kontribuojnë edhe masat e Bankës Popullore që nga fillimi i krizës, që synojnë lehtësimin e politikës monetare dhe mundësojnë fleksibilitet rregullator. Me normalizimin gradual të situatës dhe stabilizimin e pritjeve, parashikohet përshpejtim gradual i rritjes së aktivitetit kreditor në periudhën e ardhshme. Rrjedhimisht, rritja kreditore për periudhën 2021-2022 do të ishte mesatarisht 6.3% dhe do të arrinte në 7.6% në vitin 2023. Vlerësimet për dinamikën e rritjes kreditore dhe depozitave bazohen në pritjet për stabilizimin e situatës në ekonominë vendore deri në fund të vitit 2021. Në vitet 2021-2022, me vlerësimet për përshpejtim gradual të rritjes ekonomike dhe ruajtjen e mëtejshme të prirjes së lartë për kursim në banka, rritja vjetore e depozitave pritet mesatarisht 6.9%. Rritja e depozitave prej 8.2% pritet për vitin 2023.

Në sferën fiskale, në afat të mesëm, pritet konsolidim gradual buxhetor. Deficiti buxhetor do të financohej në mënyrë të kombinuar nga burime vendore dhe të jashtme. Politika e vendosur fiskale ndiqet me rreziqe që, njëjtë sikur tek politika monetare, dalin nga mundësitë e ballafaqimit të pandemisë, si në suaza vendore ekonomie ashtu edhe në ato globale.

Banka Popullore edhe më tej do t'i ndjek lëvizjes aktuale dhe rreziqet prezent nga mjedisi vendor dhe i jashtëm dhe në mënyrë përkatëse, do ta vlerësojë dhe përshtat pozicionimin e politikës monetare.

V. Instrumentet monetare

Mjedisi i ndryshuar i shkaktuar nga pandemia Covid-19 në vitin 2020 imponoi nevojën për një reagim të shpejtë dhe relativisht të fortë të Bankës Popullore përmes instrumenteve monetare, me qëllim të sigurimit të rritjes së aksesit në mjetet likuide dhe zbutjen e pasojave negative ekonomike nga pandemia e Covid-19. Në fakt, për shkak të rritjes së mbështetjes së likuiditetit të sistemit bankar, zgjerim i mundësive investuese të bankave dhe mbështetjes së flukseve reale në ekonomi, Banka Popullore në dy raste liroi një pjesë të mjeteve të tepërta likuide të bankave duke ulur shumën e instrumentit bazë për gjithsej 15 miliardë denarë, në të njëjtën kohë duke e ul edhe normën batë të interesit edhe atë në nivel më të ulët historik prej 1,5%. Mbështetja e ekonomisë reale u mundësua nga riaktivizimi i masës jostandarde të rezervës së detyrueshme, e cila ofron mbështetje kreditore të synuar për sektorët më të prekur. Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të pozitës solide të likuiditetit të sistemit bankar, Banka Popullore zgjeroi hapësirën e instrumenteve që bankat mund t'i përdorin për sigurimin e likuiditetit në denarë nga Banka Popullore.

Në fillim të vitit, Banka Popullore ka lehtësuar politikën e saj monetare përmes uljes së normës bazë të interesit për 0.25 pikë përqindje në 2.0%. Ky vendim u miratua në mungesë të presioneve nga sektori i jashtëm, zhvillimeve të mëtejshme të favorshme në tregun valutor dhe vazhdimi i tendencës rritëse të rezervave valutore. Menjëherë më pas, në fillim të muajit mars, përhapja e papritur e fortë e Covid-19 dhe vendosja e masave restriktive për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë në nivel global shkaktuan pasiguri të subjektet ekonomike të vendit. Sinjalet e para për specifikën e krizës dhe pritjet e pafavorshme ishin të dukshme përmes rritjes jashtëzakonisht të lartë të parasë së gatshme në qarkullim⁴⁸ në kushtet e rritjes së prirjes së popullatës për blerje të mallrave për konsum personal dhe mbajtjes e një shume më të madhe në para të gatshme në denarë. Specifikimi i krizës dhe efektet e saj u konfirmuan edhe përmes lëvizjeve në tregun valutor, ku u forcuan shitjet neto të valutës nga bankat për klientët e tyre (shtojcë për tregu valutor). Ndryshimet në këtë segment të tregut ishin kryesisht për shkak të sektorit "popullsi", i cili për shkak të pasigurisë së shprehur dhe masave globale për kufizimin e lëvizjes, kishte reduktim flukset hyrëse dhe për rrjedhojë uljen e ofertës së mjeteve valutore në tregun valutor. Zhvillime të tilla të pazakonta në tregun valutor, të cilat ishin veçanërisht ishin të theksuara në fillim të krizës, dhe imponuan nevojën që Banka Popullore të përforcon komunikimin me opinionin, por edhe të intervenon me shitjen e likuideve valutore në bankat vendore. Intervenimet e Bankës Popullore në tregun valutor ishin më të forta në gjysmën e parë të vitit (313,9 milionë euro, në krahasim me shumën e dyfishtë më të vogël në gjysmën e dytë të vitit) dhe kontribuan në ruajtjen e mëtejshme të stabilitetit të këmbimit valutor të denarit.


Duke pasur parasysh se presioni në tregun valutor rezultoi nga oferta e valutave, Banka Popullore në sapo fillimin e krizës reagoi shpejt dhe me lehtësim relativisht të fortë monetar përmes një sërë instrumentesh monetare. Ashtu që, me pasojat e pritshme jashtëzakonisht të pafavorshme të pandemisë dhe për shkak të lehtësimit të kushteve të financimit të sektorit real, në dy raste (në mars dhe maj) norma bazë e interesit u zvogëluar për 0.50 pikë përqindje shtesë, në një nivel më të ulët historik prej 1, 5%⁴⁹. Në muajin prill

⁴⁸ Në mars dhe prill gjendja e parave të gatshme në qarkullim u rrit për 5,6 miliardë denarë, duke shpjeguar 84% zë rritjes vjetore të denarëve të gatshme për tërë vitin 2020 (6,7 miliardë denarë) e cila njëherit ishte edhe historikisht më e lartë.

⁴⁹Për rrjedhojë, norma më të ulëta të interesit u zbatuan edhe në repo-ankandet për krijim të likuiditetit edhe të kredive njëditore të disponueshme, norma e interesit e të cilave është e barabartë, pra më e lartë për 0.5 pikë përqindje në raport me normën e interesit të boneve të thesarit.


dhe maj, Banka Popullore e zvogëloi shumën e bonove të thesarit⁵⁰ për gjithsej 15 miliardë denarë, në nivel prej 10 miliardë denarë. Me zvogëlimin e ofertës së bonove të thesarit, Banka Popullore çliroi 60% të fondeve likuide të sistemit bankar të tërhequra përmes këtij instrumenti dhe krijoi hapësirë për rritjen e mbështetjes kreditore për ekonominë vendase. Pakoja e masave antikrizë të Bankës Popullore, qëllimi i të cilëve është të sigurohet akses më të madh deri te likuiditetet e bankave për mbështetjen financiare të sektorit real, përfshinë edhe: 1) riaktivizimi i masës së rezervës së detyrueshme jostandarde, e cila ofron mbështetje të synuar për lehtësimin e kushteve të kredive, këtë herë të sektorëve të cilat ishin më të prekur nga pandemia; 2) zgjerimi i portofolit të letrave me vlerë të pranueshme për sigurimin e likuiditetit të bankave vendase nga Banka Popullore, me përfshirje të obligacione shtetërore vendore me afatizues më të gjatë edhe të euroobligacionit të lëshuar nga ana e shtetit në tregjet financiare ndërkombëtare. Gjithashtu, BQE vendosi repo-linje për Bankën Popullore për sigurimin e likuiditetit valutor në shumë totale prej 400 milionë euro. Kjo linjë është e disponueshme deri në mars 2022 dhe krijon hapësirë shtesë për veprim të shpejtë dhe efikas të Bankës Popullore nëse ka nevojë për sigurimin e likuiditetit valutor në euro për bankat në vend.

Grafikoni 59
Korridori i normave të interesit




* 7DD – depozitat shtatë ditore të disponueshme; DNJD – depozita njëditore; KNJD – kredi njëditore

Grafikoni 60
Bonat e thesarit dhe likuiditeti i tepricës së mjeteve në bankë⁵¹




Grafikoni 61
Rrjedha e likuiditetit nga faktorët autonom



* FTA – Faktorë të tjerë autonom
Burimi: BPRMV.

Grafikoni 62
Gjendja e instrumenteve monetare



⁵⁰ Në ankandet e bonove të thesarit, që mbahen në ditën e parë të periudhave të rezervës së detyrueshme, realizohet tender me shumën (shumë e kufizuar e ofertës dhe normë fikse të përcaktuar të interesit)

⁵¹ Fondet e tepërta likuidive të bankave kanë të bëjnë me ditën e parë të periudhës së rezervave të detyrueshme kur mbahen ankandet e bonove të thesarit dhe paraqesin shumën totale të fondeve të rregullta të llogarive të bankave në Bankën Popullore, shumën e arritur e pagesës së bonove të thesarit dhe depozitat e disponueshme të BPRMV dhe kërkesa e tregut të parave, zvogëlimi i detyrimeve të tregut të parave dhe shumën e rezervave të detyrueshme në periudhën vijuese.

Në gjysmën e parë të vitit, bankat përdorën likuiditetin e çliruar përmes bonove të thesarit për tejkalimin e mospërputhjes kohore në mes potencialit të zvogëluar të likuiditetit në fillim të krizës nga njëra anë, dhe shfrytëzimi i pakos të masave antikrizë të politikës fiskale në maj dhe qershor, e cila nga ana tjetër kontriboi në rritjen e tepricës së fondeve në denarë në sistemin bankar. Depozitat e disponueshme në Bankën Popullore⁵² kanë mundësuar fleksibilitet të lartë në menaxhimin e ndryshimeve të likuiditetit. Ngjashëm me vitet e kaluara, edhe në vitin 2020 bankat në mënyrë aktive i kanë shfrytëzuar depozitat në dispozicion njëditore, gjendja mesatare e të cilave nga prilli e këndeje, menjëherë pas aktivizimit të masave të Bankës Popullore, kanë mbetur në nivel relativisht stabil (rreth 31 miliardë denarë). Pikërisht për shkak të shumës së madhe të fondeve të lira të drejtuara për këtë instrument, bankat nuk kanë pasur nevojë të sigurojnë fonde në para nga Banka Popullore përmes kredive njëditore dhe repo-ankandëve për krijimin e likuiditetit, të cilat u realizonin çdo të premtë. Gjithashtu, pozicioni solid i likuiditetit u mundësoi bankave të kenë vetëm nevojë të kohë pas kohshme dhe të ulët për huamarrje në tregun ndërbankar për depozitat e pasigurta (shtojca për lëvizjet në tregun ndërbankar për depozitat e pasigurta dhe tregun sekondar të letrave me vlerë).

Në fillim të gjysmës së dytë të vitit, lehtësimi gradual i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe normalizimi i proceseve të biznesit në mbarë botën ndikoi pozitivisht në mjedisin e brendshëm. Shenjat e para të përmirësimit të lëvizjeve u panë sërish në tregun valutë nëpërmjet rritjes së flukseve valutore nga transfertat private dhe uljes së pritjes së banorëve për valutë të huaj. Këto rrethana, në gjysmën e dytë të vitit, ju mundësuan personave fizik të shihnin një rritje të neto-ofertës me valutë në tregun valutë dhe të këmbimit (për rreth 73% më mirë krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit). Ajo solli në zvogëlim graduale të presioneve në tregun valutë. Për shkak të këtyre zhvillimeve, Banka Popullore nga korriku deri në fund të vitit vetëm kohë pas kohe edhe atë me shumë dyfish të më të vogël (158,6 milionë euro) mori pjesë në tregun valutë përmes kompensimit të nevojave të kohë pas kohshme të bankave për likuiditet valutë. Në rast të përmirësimit të lëvizjeve në tregun valutë dhe stabilizimit të mëtejshëm të likuiditetit valutë të bankave, Banka Popullore në gusht aktivizoi edhe ankandet e depozitave në valutë. Në kushtet e lëvizjeve të ndryshueshme dhe të pasigurta në tregjet financiare ndërkombëtare, ky instrument u ofron bankave mundësinë për vendosje pa rrezik në euro në Bankën Popullore me afatizues prej 1 deri 3 muaj⁵³. Njëherit, me ndihmën e mbajtjes së vazhdueshme të likuiditetit si në valutë ashtu edhe në denarë të sistemit bankar në nivel të duhur, Banka Popullore nuk kishte nevojë për përdorim të mjeteve nga repo-linja e BQE.

Në gjysmë vjetorin e vitit, dukshëm ishte edhe stabilizimi i kërkesës për para të gatshme. Njëherit, u vazhdua edhe me zbatimin e masave buxhetore për revitalizim të ekonomisë reale, të cilat sollën deri në rritje të fondeve likuiditive të bankave në valutë vendore. Edhe për kundër rritjes ekzistuese të fondeve të lira të bankave në denarë, në pjesën e mbetur të vitit Banka Popullore e mbajti shumën e boneve të thesarit në nivel prej 10 miliardë denarë. Në këtë mënyrë u krijua hapësirë për shfrytëzimin e fondeve të tepërta në denarë për mbështetje të mëtejshme të aktiviteteve kreditore. Pas kompensimit të nevojave në sektorin real, bankat edhe më tej e drejtuan fondet e tepërta drejt depozitave të disponueshme njëditore te Banka Popullore. Prej këtu gjendja mesatare e këtij instrumentit gradualisht rritej dhe në fund të vitit arriti rreth 34,4 miliardë denarë, duke tejkaluar nivelin parakrizës, prej rreth 31,3 miliardë denarë.⁵⁴

⁵² Normat e interesit për depozitat njëditore të disponueshme me afat afatizues prej shtatë ditë në vitin 2020 përkatësisht qëndruan në nivelin prej 0.15% dhe 0.30%.

⁵³ Gjatë vitit, bankat patën një interes të moderuar për vendosjen e fondeve në këtë instrument të Bankës Popullore.


⁵⁴ Plasmani i depozitave të disponueshme shtatëditore te Banka Popullore gjatë vitit ishin realtivisht të ulëta dhe stabile, mesatarisht rreth 820 milionë denarë.

Shtojca 1. Zhvillimet në tregun valutor⁵⁵ dhe ndërhyrjet e Bankës Popullore

Tregu valutor i bankave me klientët e tyre⁵⁶ ishte një nga pikat e para ku ishte e dukshme goditja nga kriza shëndetësore ndaj ekonomisë vendore. Ky treg, që zakonisht ka ndjeshmëri të lartë në periudha krize, në vitin 2020 kishte tendencë të pazakontë që e vërtetuan karakterin e posaçëm, jo-ekonomik të krizës. Veçoria e krizës fillimisht vërehej nëpërmjet ofertës dukshëm të zvogëluar të devizave nga ana e personave fizikë, në tregun e devizave dhe këmbimoreve. Sjellja e këmbimorëve dhe kundërt me periudha paraprake me kriza, kur shenjat e para për pasigurinë dhe ndryshimin e disponimit të popullatës u shprehën nëpërmjet kërkesës së rritur dhe të rëndomtë afatshkurtër për deviza. **Zvogëlimi i ofertës nga të hollat e huaja efektive nga personat fizikë u shpreh në tregun e këmbimit, edhe atë në transaksionet me këmbimoret, që më tej ndikoi edhe në derdhjen e devizave në sistemin bankar.** Lëvizja teposhtë e efektivit të blerë neto në tregun e këmbimit kryesisht lidhet me masat shtrënguese për parandalimin e përhapjes së virusit, që e zvogëluan lëvizjen ndërkombëtare të udhëtarëve dhe në mënyrë përkatese kontribuuan për korrigjim më të madh për teposhtë të derdhjeve të devizave nëpërmjet remitancave joformale. Këto ndryshime, gjatë ngeçjes së presioneve nga kërkesa, kanë kontribuar për zvogëlimin e dukshëm (gjithsej për 444,1 milionë euro, në bazë vjetore) të tepricës së mjeteve të huaja pagesore që ua ofrojnë këmbimoret bankave vendore. Karakteri i posaçëm i krizës vërehet edhe nëpërmjet mbetjes së ofertës më të ulët të devizave nga këmbimoret për bankat. Përndryshe, nga fillimi i krizës deri në fund të gjysmës së parë të vitit, si pasojë e masave globale për kufizimet e lëvizjes së njerëzve, oferta e devizave nga këmbimoret (që del nga transaksionet me efektiv të huaj të personave fizikë) ishte e ulët për rreth 50% të bazës vjetore. Në gjysmën e dytë të vitit, me hapjen graduale të kufijve vërehet një trend i rritjes graduale të ofertës, që në mënyrë përkatese ka kontribuar për përmirësimin edhe të potencialit valutor të bankave.


Grafikoni 63

Neto –shitja e valutave në bankë për klientët e tyre



Grafikoni 64


Ndryshimet vjetore të ofertës dhe kërkesave për valutë, në klientë



⁵⁵ Tregu valutor në kuadër të kësaj analize i përfshinë transaksionet në mes bankave dhe klientëve të tyre dhe tregtimet ndërbankare.


⁵⁶ Klientët e bankave klasifikohen në këto katër grupe: kompani, këmbimore, persona fizikë, jorezident.

Grafikoni 65
Blerja e valutave e bankave nga këmbimoret, sipas tremujorëve



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 66
Neto – oferta/kërkesat e valutave nga personat fizikë në tregun valutator, sipas tremujorëve




Në vitin 2020, persona fizikë kishin sjellje jotipike edhe në tregun valutator, edhe pse efektet ishin dukshëm më të dobëta në krahasim me tregun e këmbimit. Përndryshe, për shkak të pasigurisë së ekspozuar lidhur me krizën, në vitin 2020 bankat për herë të parë realizuan shitje neto të devizave (89 milionë euro) të personave fizikë. Kjo pozitë e pavolitshme e bankave me personat fizikë paraqitej nga rritje më e fuqishme e kërkesës për likuiditet valutator, edhe pse vetëm ngadalësim mesatar kishte edhe në anën e ofertës së devizave. Në mënyrë dinamike, shitjet neto për personat fizikë janë shprehur në dy muajt e parë nga kriza, kur u realizuan rreth 60% të shitjes vjetore neto të devizave me këto klientë ndërsa deri në fund të vitit, nevojat neto të personave fizikë për likuiditet valutator kanë shënuar rënie, duke sinjalizuar normalizim gradual të rrjedhave.

Kriza shëndetësore ka ndikuar edhe ndaj rrjedhave të ofertës dhe kërkesës për deviza edhe nga sektori korporativ. Përndryshe, edhe pse shitja neto e devizave për nevojat e sektorit korporativ (1,428 milionë euro) ishte mesatarisht më e lartë në nivelin vjetor (për 92 milionë euro), nga vetë fillimi i krizës, si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik, e dukshme ishte rënia edhe e kërkesës edhe e ofertës së devizave nga kompanitë. Nevoja e zvogëluar për likuiditet valutator nga sektori korporativ paraqitej nga kompanitë e prodhimit dhe tregtisë me karburant, duke pasur parasysh efektin e volitshëm të çmimit më të ulët të sasive të importuara të këtij energjensi gjatë tërë periudhës që nga fillimi i krizës. Gjithashtu, karakteri shëndetësor i krizës ka ndikuar edhe me rritjen e kërkesës për deviza nga kompanitë e industrisë farmaceutike dhe kimike si dhe nga kompanitë për tregti me pajisje informatike, por efekti i tyre ishte dukshëm më i dobët në raport me kërkesën e zvogëluar për deviza nga kompanitë e naftës. Mbyllja e ekonomisë globale dhe vendore ka shkaktuar shtrëngimin e zinxhirëve tregtarë dhe prodhues, duke u shprehur me derdhje të zvogëluar valutore në ekonomi nga kompanitë me orientim eksportues pothuajse në të gjitha veprimtarisë. Si rrjedhojë, këto ndryshime kanë kontribuar për ofertë më të dobët të likuiditetit valutator të të gjitha kompanive, me përjashtim të kompanive për shërbime nga sektori i informatikës dhe industrisë metalurgjike. Në mesin e klientët të bankave, vetëm jorezidentët kishin ofertë mesatare më të lartë vjetore neto të likuiditetit valutator (për 52 milionë euro në raport me vitin paraprak), në nivelin e 74 milionë eurove. Pozicioni më i mirë i bankave me këto klientë, krahas efekteve të njehershme në vitin paraprak, kryesisht lidhet edhe me pagesat më të ulëta të dividendëve nga sektori vendor financiar ndaj aksionarëve të huaj.

Si pasojë e të gjitha ndryshimeve të përmendura, në vitin 2020, bankat realizuan neto shitje të valutave për nevojat e klientëve të tyre në shumë prej 776 milionë euro, që është niveli më i lartë në dyzet vitet e fundit⁵⁷.


Duke pasur parasysh se presioni nga goditja jo-ekonomike ndaj tregut valutor më shumë u shpreh deri në qershor, një pjesë e mjeteve të nevojshme valutore likuide i siguronin nga burimet personale, por edhe në tregun ndër- bankar valutor (qarkullim prej 858 milionë euro), ku mbisundonte kërkesë më e lartë për mjete valutore. Kërkesa më e madhe, që pjesërisht paraqitej edhe nga qasje aktive e menaxhimit të bankave me likuiditetin e tyre valutor në tregjet ndërkombëtare financiare, u kompensua nga Banka Popullore. Përndryshe, Banka Popullore në gjashtë muajt e parë të vitit intereson me shitjen e 313,9 milionë eurove. Krahas intervenimeve të sport-segmentit, Banka Popullore shpesh vepronte edhe nëpërmjet komunikimit të përforcuar për shkak të normalizimit të pritjeve të subjekteve vendore dhe mbrojtjes së kursit valutor të denarit në raport me euron. Sinjalet për qëndrueshmëri graduale të lëvizjeve dhe kthimi i besimit të subjekteve ekonomike, prezent në gjysmën e dytë të vitit ishin të qarta edhe në tregun ndër- bankar valutor, nëpërmjet nevojës së zvogëluar të bankave për kompensimin e mos- harmonizimit afatshkurtër të derdhjeve dhe daljeve të likuiditetit valutor nga klientët. Në këto rrethana, Banka Popullore në pjesën e dytë të vitit kishte prezent të zvogëluar dhe periodike, me shitjen e thujse vlerës dyfish më të ulët të devizave (158,6 milionë euro) të bankave. Në fund të dhjetorit, gjatë trendeve të përmirësuar të tregut dhe përmirësimit të likuiditetit valutor të bankave, Banka Popullore për herë të parë në vit realizoi edhe blerje të vogël. Hapësira komode e Bankës Popullore për prezencë të përhershme në tregun valutor me shitje neto të gjithsej 470,5 milionë eurove në vitin 2020 u mbështet nga niveli solid i rezervave valutore, që në katër vitet e fundit vazhdimisht plotësoheshin nëpërmjet tërheqjes së tepërisë së likuiditetit valutor nga sistemi bankar.

Grafikoni 67
Qarkullimi në tregun ndërbankar të këmbimit valuator, sipas segmenteve



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 68
Ndërhyrjet e BPRMV-së në tregun valutor




Gjatë menaxhimit me likuiditetin e bankave, edhe në vitin 2020 u përdorën rezervat e detyrueshme. Madje, përveç funksionit bazë të këtij instrumenti, Banka Popullore riaktivizon edhe masën jo-standarde me qëllim që të veprojë në mënyrë stimulante për mbështetjen e papenguar të kredive të kompanive të veprimtarive më të prekura. Me këtë masë mundësohet zvogëlimi i bazës së detyrimeve të bankave për rezervat e detyrueshme në denarë, për shumën e kredive të sapomiratuara ose të ristrukturuara të ndërmarrjeve në veprimtari të cilat janë më të prekura nga kriza shëndetësore. Që nga fillimi i zbatimit, përfundimisht deri në fund të vitit 2020, me këtë masë janë të përfshira gjithsej 1.504 kompani, të cilët kanë shfrytëzuar kredi në shumë totale prej 6.953 milion denarë. Pjesa më e madhe e këtyre kredive (rreth 46%) ju është miratuar kompanive nga veprimtaria e "transportit rrugor dhe të

⁵⁷ Për krahasim, në dy vitet e kaluara, klientët kishim nevojë mesatare neto për deviza (mesatarisht rreth 85 milionë euro), që është kompensuar nga bankat.


mallrave ", pas këtyre pasojnë veprimtaritë "hotelerie" dhe "restorantet" të cilat janë përfaqësim të barabartë (me 19%). Aktiviteti i tillë kreditor ndaj sektorëve të synuar mundësoi zvogëlimin e detyrimit të bankave për ndarjen e rezervës së detyruar në Bankën Popullore për 532 milionë denarë. Efekti jolikuiditeti nga zbatimi i masës jostandarde⁵⁸, së bashku me ndryshimet në detyrimet në denarë dhe valutë të bankave⁵⁹, kontribuan në rritjen vjetore relativisht të lartë të rezervës së detyruar të bankave për detyrimet, në total prej 3.220 milionë denarë. Pjesa më e madhe e këtij ndryshimi shpjegohet me rritjen e qëndrueshme vjetore të rezervës së detyrueshme në denarë (prej 2.019 milionë denarë, në nivelin prej 26.272 milionë denarë).

Grafikoni 69
Ndryshimet e rezervave të detyrueshme të bankave



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 70
Gjendja e kredive totale të veprimtarive të prekura nga Covid -19



Njëherit, rezerva e detyrueshme që bankat e plotësojnë në euro shënoi rritje të konsiderueshme vjetore (në vlerë ekuivalente prej 1.201 milionë denarë), duke arritur në 18.294 milionë denarë në fund të vitit. Ndryshimet e tilla në rezervën e detyrueshme nga aspekti valutor janë të lidhura me rritjen relativisht më të fortë të valutës në raport me rritjen solide të detyrimeve në denarë të bankave (më hollësisht për ndryshimet në bazën e depozitave të bankave në pjesën e Agregatët monetarë).

2. Zhvillimet në tregut ndërbankar të depozitëve të pasiguar dhe tregu dytësor i letrave në vlerë⁶⁰

Në vitin 2020, për shkak të shumës së lartë të mjeteve të lira në denarë, bankat patën nevojë shumë të vogël dhe të rastësishme për të marrë hua në tregjet e brendshme financiare, edhe përkundër ndryshimeve të mëdha të likuiditetit. Rrjedhimisht, në vitin 2016, tregu ndërbankar i depozitave të pasigurta, për të dytin vit radhazi, ka pasur një aktivitet


⁵⁸ Në fund të dhjetorit 2019 ka pushuar vlefshmëria e masës jostandarde për stimulimin e aktivitetit kreditor të sektorëve me rëndësi sistematike (neto-eksportuesit dhe prodhuesit vendor të energjisë elektrike). Si rezultat i tillë, në janar 2020, detyrimi i bankave për shpërndarjen e fondeve në bazë të rezervës së detyruar në denarë u rrit për 1.079 milionë denarë.

⁵⁹ Në vitin 2020, Banka Popullore nuk ka bërë ndryshime në normat dhe bazën e rezervës së detyruar. Detyrimet në denarë të bankave edhe më tej i nënshtrohen normës së rezervës së detyrueshme prej 8%, për detyrimet në valutë norma e rezervës së detyruar është 15%, ndërsa për shumën e detyrimeve të bankave në denarë me klauzolë valutore bankat janë të obliguara të ndajnë fonde në Bankën Popullore në nivel prej 50%.


⁶⁰ Analiza e tregut të parave në Maqedoninë e Veriut ka të bëjë me segmentet në vijim: tregu i depozitave të pasigurta, tregu sekondar i letrave në vlerë afatshkurte dhe letrave shtetërore në vlerë afatgjate (me përjashtim të obligacioneve strukturore), tregu i depozitave të sigurta (repo-tregu).

tregtar relativisht të ulët prej 6,65 miliardë denarë, që është 84% më pak se nevoja mesatare e bankave për kompensimin nevojave afatshkurte të likuiditet në denarë në periudhën 2008-2018.

Grafikoni 71
Qarkulli I tregun ndërbankar në depozitat e pasigurta



Grafikoni 72
Likuiditeti i tepërt në sistemin bankar dhe borxhi i bankave



Burimi: BPRMV.


Kërkesa e dobët për mjete likuide të bankave u reflektua edhe në borxhin mesatar ditor të tyre (rreth 65 milionë denarë), i cili në vitin 2020 ishte pothuajse dy herë më i ulët në bazë vjetore. Struktura afatizuese e tregtisë ka pasur një kontribut shtesë në uljen e nevojës për huamarrje. Gjegjesisht, për të tretin vit radhazi, bankat kanë siguruar pjesën më të madhe të mjeteve të nevojshme (78%) me afatizues deri në një javë, gjë që zvogëlon nevojën për tregtim më të shpeshtë në afatizuesit më të shkurtë. Në rrethana të tilla, kreditë njëditore afatizuese kishin një përfaqësim relativisht të ulët.

Normat e realizuara të interesit në tregun ndërbankar për depozitat e pasigurta në vitin 2020 kanë mbetur në nivel stabil. Norma mesatare e interesit ndërbankar për të gjitha transaksionet (MINB) në fund të vitit ishte 1,1% dhe ishte më e ulët për vetëm 0,03 p.p. në raport me atë të dhjetorit të vitit 2019. Huat e pasigurta ndërbankare më të përfaqësuara me afatizues prej 1 javë kishin një normë interesi relativisht stabile (mesatarisht 1,13%) dhe në nivel të pandryshuar (rreth 1%) ishte norma e interesit për depozitat e pasigurta njëditore, me të cilat tregtoheshe kohë pas kohe. Norma e interesit ndërbankar për transaksionet njëditore është ruajtur në këtë nivel (MKDONIA).

Vëllimi i letrave me vlerë të tregtuara në tregun sekondar në vitin 2020 arriti në 4.190 milionë denarë dhe ishte më i lartë për 40% në krahasim me vitin paraparak. Nga aspekti i llojeve të transaksioneve, rritja e aktivitetit tregtar vjen tërësisht si pasojë e transaksioneve definitive me letrat me vlerë, duke qenë se për të dytin vit radhazi, në kushtet e një pozicioni solid likuiditeti të bankave, aktiviteti i segmentit repo-tregut ndërbankar mungon. Në vitin 2020, bankat kanë realizuar vetëm një transaksion për blerje dhe shitje të bonove të thesarit në shumë prej 100 milionë denarë, ndërsa në qarkullimin e realizuar mbizotëronte tregtimi me letrat shtetërore në vlerë në shumë prej 4.090 milionë denarë (ose 97,6% të qarkullimit total të realizuar. Tregtimi me letra shtetëror në vlerë kryesisht është realizuar me letra shtetërore në vlerë me afatizues deri në një vjet (në shumë prej 3.381 milionë denarë). Në të gjitha transaksionet e bonove të thesarit në vitin 2020, të paktën një pjesëmarrës ishte një subjekt jobankar, gjë që tregon se pjesëmarrësit e tregut i përdorin herë pas here këto transaksione për të menaxhuar nevojat për likuiditet që rezultojnë nga puna e rregullt. Megjithatë, pavarësisht rritjes vjetore të vëllimit të letrave shtetërore në vlerë të tregtuara në tregun sekondar, pjesëmarrja e tij në totalin e letrave shtetërore në vlerë të lëshuara


nga vendi është shumë e ulët (0,01%) dhe tregon për likuiditet të dobët të mëtejshëm të këtyre instrumenteve në tregjet e brendshme financiare.

Grafikoni 73
Qarkullimi i tregut sekondar të letrave në vlerë



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 74
Struktura e transaksioneve definitive me letrat shtetërore në vlerë⁶¹



⁶¹ Koeficienti i likuiditetit të letrave shtetërore në vlerë është raporti ndërmjet qarkullimit të realizuar të transaksioneve të LSHV në tregun sekondar gjatë vitit dhe gjendja mesatare të LSHV të lëshuara në të njëjtën periudhë.


VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

Në vitin 2020, rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: rezervat devizore) shënuan rritje vjetore, e cila kryesisht rezultoi nga hyrjet në vend, për dallim nga ndërhyrjet e Bankës Popullore për shitjen e valutës në tregun valutor. Banka Popullore e ka gjetur krizën e shkaktuar nga pandemia me nivel të përshtatshëm të rezervave valutore e cila siguroi likuiditet në pagesat e huaja dhe mbrojtje të kursit të denarit , , duke lënë në të njëjtën kohë hapësirë për reagim shtesë monetar. Menaxhimi i rezervave valutore në vitin 2020 u karakterizua me maturi dhe përshtatje të vendimeve investuese drejt zhvillimeve ndryshuese në tregjet ndërkombëtare, gjë që mundësoi realizimin e mëtejshëm të parimeve bazë: sigurinë dhe likuiditetin e rezervave valutore, si dhe u arrit një rentabilitet i caktuar.

6.1. Gjendja dhe ndryshimi i rezervave valutore


Në vitin 2020, rezervat valutore u rritën për 97,3 milionë euro dhe në fund të vitit arritën në 3.360 milionë euro. Gjatë ndërhyrjeve të Bankës Popullore në tregun valutor me shitjen e 470,5 milionë euro bankave vendase, rritja e rezervave valutore pothuajse në tërësi ka ardhur si pasojë e neto-hyrjeve të shtetit nga jashtë vendit në vlerë prej 503,1 milionë euro. Këto neto-hyrje rezultuan nga lëshimi i euroobligacionit dhe huamarrjet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Komisioni Evropian dhe tejkaloan plotësisht daljet për shlyerjen e rregullt të borxhit të jashtëm publik. Në rritjen e rezervave valutore ka kontribuar edhe mbiçmimi i tregut të arit për shkak të rritjes së theksuar vjetore të çmimit të arit (prej 24,2%), ndërkohë që ulja e vlerës së dollarit amerikan ndaj euros për 8,9% në bazë vjetore ka pasur një ndikim më të moderuar në drejtimin e kundërt. Për rritjen e rezervave valutore, por në një masë relativisht më të dobët, kanë kontribuar edhe: rritja e rezervës së detyruar në euro të bankave (15,7 milionë euro), rritja e mjeteve të bankave vendase në llogaritë MIPS-EUR (18,8 milionë euro), depozitat në valutë të bankave vendase të vendosura në Bankën Popullore (7 milionë euro) dhe të hyrat nga investimet në rezervat valutore (3,8 milionë euro).

Grafikoni 75
Faktorët e ndryshimit të rezervave valutore, në milionë euro



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 76
Portfolio e rezervave valutore në nivel mesatar, në milionë euro



Edhe në vitin 2020, rezervat valutore ishin të shpërndara në tre portfolie (portfolio operative, likuiduese dhe investuese), vëllim i të cilëve u përshtat në pajtim me nevojat aftshkurte për likuidim të mjeteve valutore në tregun e brendshëm valutor dhe pagesat e ardhshme të borxhit të jashtëm publik. Në strukturën e rezervave valutore, përmes portfolios

së veçantë edhe më tej u menaxhohej edhe me arin, siguria dhe likuidimi i të cilit është veçanërisht e shprehur në kushtet të ndryshimit të lëvizjeve në tregun financiar.

6.2. Kushtet e tregjeve ndërkombëtare financiare dhe qasje aktive në investimet e rezervave valutore


Lëvizjet në tregjet financiare ndërkombëtare në fillim të vitit u ndikuan nga tronditja joekonomike e shkaktuar nga përhapja e virusit Covid-19 dhe u karakterizuan me rritjen e luhatshmërisë në sjelljen e instrumenteve financiare. Në fakt, përhapja e shpejtë e virusit dhe pasiguria për zhvillimet e të ardhmes të ndërlidhura me pandeminë kanë kontribuar në rritjen e kërkesës të detyrimeve për letrat me vlerë të lëshuara nga ekonomitë më të zhvilluara (të cilat kanë karakteristikat e instrumenteve më të besueshme dhe likuide) dhe rrjedhimisht për zvogëlimin e dukshëm të sjelljes së tyre, thellësisht në territorin negativ. Në të njëjtën periudhë, sjellja e instrumenteve që përmbajnë prime të rrezikut kreditor janë rritur, duke reflektuar kërkesën më të ulët për këtë lloj instrumenti. Megjithatë, këto prirje ishin të pranishme për një periudhë relativisht të shkurtër, duke pasur parasysh masat e shpejta dhe të gjera të politikës monetare dhe fiskale të vendeve të zhvilluara. Reagimi i shpejtë i bankave qendrore, së bashku me: lehtësimin gradual të masave për parandalimin e përhapjes së virusit, lajmet inkurajuese për zbulimin e vaksinave, marrëveshja e arritur për Bregzit në mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian dhe përmirësimi i moderuar të treguesve ekonomikë, deri në fund të vitit, krijuan optimizëm te investitorët e tregut financiar ndërkombëtar, e dukshme përmes nga kahëzimi i interesit të tyre nga letrat shtetërore me vlerë drejt instrumente më të rrezikshme financiare.

Zhvillimet e ndryshme në tregjet ndërkombëtare kanë imponuar nevojën e maturisë dhe përshtatje të vendimeve investuese aktive gjatë menaxhimit me rezervat valutore, duke mundësuar arritjen e mëtejshme të papenguar të parimeve bazë të investimit: siguri, likuiditet dhe rentabilitet. Duke u udhëhequr nga parimi i sigurisë në investimet të rezervave, e cila ka prioritet më të lartë dhe fiton edhe rëndësi më të madhe duke pasur parasysh zhvillimet në tregjet ndërkombëtare, Banka Popullore i bëri vendimet investuese në vijim gjatë vitit: 1) investimet e reja në rezervat valutore i drejtoi drejt instrumenteve financiare më të sigurta; 2) përkohësisht i kufizojë plasmanet në bankat afariste duke pasur parasysh rrethimin e pasigurt makroekonomik në të cilët vepronin bankat afariste në mbarë botën dhe rreziku nga zvogëlimi i dukshëm i tyre të rentabilitetit dhe cilësisë e aktivitetit duke i shikuar në fillim të krizës shëndetësore; 3) depozitat e pasigurta të arit të cilat arrijnë për pagesë gjatë vitit ishin të afatizuara ose mbaheshin të paafatizuara pranë bankave qendrore, duke pasur parasysh pamundësinë për të vlerësuar me saktësi të madhe pasojat në pozicionin kreditor të bankave afariste; 4) përkohësisht u ndërprerë zbatimit i repo transaksioneve klasike dhe të anasjelltas, me qëllim që letrat shtetërore me vlerë të cilat jepen si sigurim në këto transaksionet të jenë të disponueshme për shitje në rast të nevojës për mjete likuide; 5) në gjysmën e dytë të vitit përsëri u bë qasja drejt lidhjes së repo-transaksione me letra me vlerë të donimuara në euro, ndërsa u fillua me zbatimin e repo-transaksioneve me valuta të kryqëzuara; dhe 6) u bë qasja drejt lidhjes dhe sigurimit të transaksioneve në ari (spov-transaksione) me dollarë amerikan dhe jen japoneze. Përmirësimi i disponimit të tregut në fillim të gjysmës së dytë të vitit kontribuoi në rritjen e mundshme në të ardhmen e të hyrave të obligacioneve shtetërore në eurozonë, gjë që e shtyu Bankën Popullore të rishqyrtojë dhe të ndryshojë ekspozimin ndaj normave të interesit të portofolit të rezervave valutore. Në fakt, Banka Popullore uli kohëzgjatjen e përshtatjes taktike të portofolit të likuiditetit dhe investimeve në euro në gjashtë muaj, përkatësisht në 1,0 dhe 1,5 vjet.

6.3. Struktura e rezervave valutore

Në vitin 2020, në strukturën e rezervave valutore edhe më tej më të përfaqësuara ishin fondet të investuara në instrumente financiare të dominuara në euro, me pjesëmarrje mesatare prej 93% , e cila është në pajtim me nevojën për disponim me fonde për mbështetje të strategjisë monetare si kurs valutore stabil të denarit kundrejt euros. Pjesa e mbetur nga rezervat valutore në tërësi ka të bëjë me instrumentin e dollarit amerikanë (7%)⁶².

Grafikoni 77
Struktura valutore e rezervave valutore
Mesatarja vjetore



Burimi: BPRMV.

Qasja e kujdesshme dhe aktive ndaj menaxhimit të rezervave valutore, e cila përfshinte kryesisht drejtimin e investimeve të reja drejt instrumenteve më të sigurta financiare, kontribuoi në rritjen e pjesëmarrjes mesatare të instrumenteve të lëshuara nga lëshuesit/vendet me **pikët më të larta të rejtingut kreditor** (prej "AAA" deri "AA -") (rreth 69%), të cilat për rrjedhojë kanë ekspozimin më të ulët të rrezikut të kredisë dhe konsiderohen si investimet më të sigurta. Duke marrë parasysh kthimet negative të letrave me vlerë të borxhit, dhe për shkak të ruajtjes së vlerës së rezervave valutore, një pjesë e konsiderueshme e investimeve (ose mesatarisht rreth 20%) janë investuar edhe në instrumente me vlerësim rejtingut kreditor prej "A +" deri në "A-". Këto investime karakterizohen gjithashtu nga një nivel i lartë sigurie dhe likuiditeti, por sigurojnë kthim mesatarisht më të lartë të fondeve. Shumica e këtyre instrumenteve kanë një afatizues më të shkurtër dhe janë të lëshuara nga banka afariste me reputacion (15% e rezervave valutore). Në vitin 2020, Banka Popullore drejtoi një pjesë të vogël të investimeve brenda portofolit në euro dhe në instrumente që kanë një vlerësim mesatarisht më të ulët të rejtingut investitues kreditor, por që janë të lëshuara ose janë të garantuara pa kushte nga shtetet anëtare të eurozonës dhe i përdorin përfitimet e politikës relaksuese të BQE-së. Kjo shpërndarje u reflektua në mënyrë adekuate në strukturën gjeografike të plasmanit të rezervave valutore. Kështu, në vitin 2020, pjesa më e madhe e investimeve u drejtuan në instrumente të lëshuara nga ekonomitë udhëheqëse të eurozonës (mesatarisht 57.6%)⁶³, por kthimet jashtëzakonisht të ulëta të këtyre produkteve financiare kushtëzuan ekspozim edhe ndaj vendeve të tjera të eurozonës të Bashkimit Evropian (19.9%)⁶⁴.

Nga aspekti i **llojeve të instrumenteve në të cilat janë investuar rezervat valutore**, edhe më tej pjesa më e madhe e fondeve janë vendosur në letra me vlerë, pjesëmarrja e të cilave në vitin 2020 u rrit për dyfish të në 78.6%. Në mes llojeve të letrave me vlerë, mbizotëruan letrat shtetërore me vlerë dhe letrat me vlerë të lëshuara me garanci shtetërore, të cilat kanë karakterin e investimeve më të sigurta dhe të cilat duke pasur parasysh qasjen aktive ndaj menaxhimit me rezervat valutore, në mënyrë të dyfishtë rritën pjesëmarrjen në totalin e investimeve. Fokusi në instrumentet më të sigurta, së bashku me ndërprerjen e përkohshme të plasmanit në bankat afariste, ndikuan në uljen e pjesëmarrjes vjetore të letrave në vlerë të lëshuara nga bankat afariste. Një pjesë e rezervave valutore në

⁶² Struktura valutore është analizuar në raport me gjenden e rezervave valutore e zvogëluar për shumën e arit.


⁶³ Ka të bëjë a.q. "bërthama e eurozonës", në të cilën përfshihen: Gjermania, Austria, Luksemburgu, Finlanda, Holanda, Franca dhe Belgjika.

⁶⁴ "Vendet e tjera të eurozonës dhe BE" janë të përfshira: Suedia, Lituania, Polonia, Çekia dhe Sllovenia.

vitin 2020 mbaheshin edhe në llogaritë rrjedhëse (mesatarisht rreth 8,4%), edhe atë kryesisht te bankat qendrore, ndërsa një pjesë e vogël edhe në bankat e huaja afariste.


Në strukturën e rezervave valutore, pjesëmarrja mesatare e arit u rrit mesatarisht, nga 9,3% në vitin 2019 në 10,4% në vitin 2020, e cila në sasi të pandryshuar, është tërësisht rezultat i rritjes së çmimit të tij në treg. Në fakt, në kushtet e rritjes së interesit nga investitorët globalë për të investuar në instrumente më të sigurta financiare në mes të shqetësimeve të shkaktuara nga pandemia dhe nënçmimit të dollarit amerikan, çmimi i këtij metali të çmuar ka shënuar rritje të lartë vjetore (prej 24.2%) dhe në fund të vitit 2020 ishte 1898 dollarë amerikan për ons.

Grafikoni 78
Struktura vjetore mesatare e investimeve sipas rejtingut kreditor




*në kategorinë të tjera janë klasifikuar FMN, BIS
Burimi: BPRMV.

Grafikoni 79
Struktura gjeografike vjetore mesatare e investimeve




*INF dhe BZHM – Institucionet ndërkombëtare financiare dhe bankat zhvillimore multilaterale.

Grafikoni 80
Struktura e investimeve sipas instrumenteve, mesatarisht në vit



Burimi: BPRMV.

Графикон 81
Struktura sipas llojeve të letrave në vlerë, mesatarisht në vit



6.4. Rezultatet nga menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

Qasja fleksibile e menaxhimit me rezervat valutore në pajtim me kushtet e tregjeve financiare ndërkombëtare, së bashku me arritjet e favorshme nga instrumentet të cilat përmbajnë premi kreditore (instrumentet e korporatave të bankave afariste dhe lëshuesit e periferive e eurozonës) kontribuan në kthim pozitiv nga menaxhimi me rezervat valutore.


Norma e përgjithshme e kthimit të investimeve në rezervat valutore në vitin 2020 ajanë 0,33%, e cila përkundër realizimit të hyrave nga investimet përfshijnë edhe

ndryshimet çmimore të llogaritura të letrave në vlerë dhe ndryshimet e kursit të realizuar nga arbitrazhet me valuta. Kontributin më të madh në ecurinë pozitive financiare për të gjithë vitin e ka pasur rritja e çmimeve të instrumenteve të lëshuara nga shteti që konsiderohen si të sigurt. Rezultatet u plotësuan nga rritja e theksuar e çmimeve të obligacioneve të cilat përmbajnë premi të kreditëve, e sidomos në tremujorshin e dytë të vitit, si dhe nga arritjet e favorshme nga menaxhimi aktiv me rezervat valutore.

Analizuar sipas portofoleve, portofoli operativ në euro ka një kontribut negativ në të hyrat nga investimi në rezerva valutore, duke pasur parasysh nevojën e mbajtjes së menjëhershme të fondeve të disponueshme në euro në llogaritë rrjedhëse te bankat qendrore dhe afariste, ndërsa të cilat zbatohet norma negative e interesit. Portofoli i investimeve në euro, i cili mbulon pjesën më të madhe të rezervave valutore dhe përfshin instrumente me afatizues më të gjata (edhe përkundër instrumenteve më të sigurt përmban edhe investime në instrumente të cilat ofrojnë premi për rrezikun kreditor), nën ndikim të lëvizjeve të çmimeve ka pasur norma pozitive të kthimit. Përkundër kësaj, instrumentet në përbërjen e portofolit të likuiditetit në euro⁶⁵ kanë një kohëzgjatje më të shkurtër krahasuar me portofolin e investimeve dhe në kushtet e mbizotërimit të kthimeve negative të instrumenteve në eurozonë, kontribuan në kthimin negativ të moderuar të këtij portofoli. Realizimi në të gjitha portofolet në euro ishin më të larta se portofolet përkatëse të referencës, të cilat përmbajnë vetëm instrumentet më të sigurt me kthime të konsiderueshme negative⁶⁶.


Portofoli i likuiditetit në dollarë amerikanë ka pasur një kthim më të lartë në raport me portofolet në euro, për shkak të kthimeve pozitive në SHBA, pavarësisht se FED gjatë vitit uli objektivin e normës së interesit të referencës me një total prej 150 pikë bazë, edhe atë në nivel prej 0% - 0,25%. Për arritje pozitive të këtij portofoli ka kontribuar edhe rritja e lartë e letrave shtetërore me vlerë amerikane, e shkaktuar nga rritja e kërkesës për këto instrumente, në kushtet e pasigurisë në tregjet financiare në nivel global.

Grafikoni 82
Norma e kthimit të rezervave valutore
Në përqindje



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 83
Norma e kthimit sipas portofoliove në vitin 2020



Një pjesë e investimeve në rezervat valutore brenda portofolit të investimeve drejtohen edhe drejt letrave në vlerë të cilat ruhen deri në pagesë⁶⁷. Këto letra me vlerë, sipas karakteristikave të tyre, kanë një kthim të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm dhe për rrjedhojë ulin ekspozimin ndaj rrezikut të interesit. Niveli i portofolit deri në pagesë në euro gjatë vitit 2020 ka qenë relativisht i stabil. Ky portofol ka arritur norma pozitive të kthimit,

⁶⁵ Të cilat janë të dedikuara për kënaqjen e të daljeve kontratura dhe potenciale gjatë një viti.

⁶⁶ Borxhi shtetëror i dhënë nga shtetet anëtare të eurozonës me rejtin kreditor prej AAA deri në AA.


⁶⁷ Letra me vlerë të klasifikuara në instrumente financiare që maten me vlerën e amortizuar të furnizuar.

duke pasur parasysh se ishte i përbërë nga obligacionet shtetërore të lëshuara nga vendet anëtare të eurozonës që kanë një hyrje pozitive deri në pagesë.


Grafikoni 84

Karakteristikat e portofolisë deri në pagesë në vitin 2020

Në miliona euro



Në përqindje



*HTM (Held-to-maturity) – letrat në vlerë deri në pagesë Burimi: BPRMV.

Shtojca 3. Përsosja dhe ngritja profesionale e kapacitetit institucional

Procesi i menaxhimit të rezervave valutore, duke filluar nga muaji mars 2020, është përshtatur me rrethanat e jashtëzakonshme të shkaktuara nga virusi Covid-19. Në përputhje me mënyrën e ndryshuar të kryerjes së aktiviteteve të rregullta, ka ndryshuar edhe mënyra e aftësimin profesional dhe zhvillimit profesional. Në fakt, gjatë vitit u vazhdua me ngritjen e njohurive dhe ndërtimin e kapacitetit institucional në Bankën Popullore përmes pjesëmarrjes të të punësuarve të përfshirë në procesin e menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore në punëtori të specializuara virtuale të organizuara nga Banka Botërore (në kuadër të programit këshilldhënës për menaxhim me rezerva valutore), bankat qendrore dhe afariste, si dhe përmes pjesëmarrjes në videokonferenca. Të gjitha pjesëmarrjet në punëtorit profesionale përdorën për të thelluar njohuri dhe informacione rreth zhvillimeve në tregut financiar ndërkombëtar, mënyrën e përshtatjes me kushtet e ndryshuara të tregut, si dhe për shqyrtimin e çështjeve nga fusha e menaxhimit me rezerva valutore. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për ruajtjen e një niveli të lartë të efikasitetit, profesionalizmit dhe cilësisë së resurseve njerëzore të angazhuar në procesin e menaxhimit me rezervat valutore.

VII. Shërbimet pagesore dhe sistemet e pagesave

Në pajtim me autorizimet ligjore, Banka Popullore themelon, regjistron dhe kryen mbikëqyrje mbi sigurinë, stabilitetin dhe efikasitetin e sistemeve të pagesave, shlyerjeve dhe kliringut. BPRMV është pronar dhe operator i Sistemit të pagesave ndërbankare të Maqedonisë (SPNM)⁶⁸ për pagesa të mëdha dhe urgjente në denarë ndërmjet pjesëmarrësve të tij, përmes të cilit kryhet shlyerja e transaksioneve të pagesave lidhur me zbatimin e politikës monetare, shlyerja përfundimtare e sistemeve tjera të pagesave kryhen dhe sistemet e shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe transaksionet e pagesave për shtetin dhe organet shtetërore dhe pjesëmarrësit e tjerë në sistem. Në të njëjtën kohë, BPRMV ka kompetenca mbikëqyrëse mbi funksionimin e sistemeve të pagesave, si dhe kompetenca mbikëqyrëse mbi bankat dhe subjektet e tjera që ofrojnë shërbime pagesash në vend. Roli rregullator dhe katalizator i BPRMV është e drejtuar drejt harmonizimit të rregullativave kombëtare me rregullativat evropiane, monitorimin e tendencave zhvillimore dhe krijimin e një mjedisi për zbatimin e tyre në vend në kuadër të procesit të integritit në BE-në.

7.1. Harmonizim i legjislacionit kombëtar me atë evropian

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë evropian në fushën e shërbimeve pagesore dhe sistemeve të pagesave, BPRMV dhe Ministria e Financave finalizuan Projekt-ligjin për shërbimet pagesore dhe sistemet e pagesave në të cilën janë përfshirë aktet kryesore⁶⁹ të legjislacionit të BE-së në këtë fushë. Korniza e re juridike, e cila do të mundëson hyrje të ofruesve të ri të shërbimeve pagesore në tregun e brendshëm do të qon në rritjen e konkurrencës dhe efikasitetit në sferën e pagesave dhe do të nxitë procesin e transformimit digjital të pagesave. Njëherit, Projekt-ligjisiguron një transparencë dhe informim më të madh të shfrytëzuesve të shërbimeve pagesore për kompensim të ofruesve të caktuar të shërbimeve, niveli i lartë i mbrojtjes së konsumatorëve, përmes mundësive ligjore të përcaktuar për zgjidhjen e ankesave të mundësme, si dhe zgjidhjen e kontesteve jashtë gjyqit, ashtu që procedurat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimeve pagesore janë qartë të definuara në pajtim me praktikat bashkëkohore të kësaj fushe. Gjithashtu, me dispozitat e Projekt-ligjit do të mundësohet krahasueshmëria e kompensimeve për shërbimet e pagesave dhe përzgjedhja e ofruesit më të favorshëm të shërbimeve pagesore. Një përfitim i veçantë është se ligji parashikon kompensim të kufizuara zëvendësimi me karta pagese, ndërsa për kategori të caktuara konsumatorësh do të mundësohet hapja e llogarive me funksione bazë përmes të cilave mund të kryhen një sërë transaksionesh pagesash pa pagesë.

⁶⁸ SPNM - Sistemi i pagesave ndërbankare të Maqedonisë është sistem për shlyerje bruto në kohë reale (RTGS) të pagesave në denarë dhe kryesisht përdoret për pagesa me vlerë të lartë dhe pagesa urgjente ndërbankare.

⁶⁹ Direktiva e Shërbimeve të Pagesave të Tregut të Brendshëm (2015/2366/KE), Direktiva për shlyerje përfundimtare (98/26/KE dhe 2009/44/KE), Direktiva e Parasë Elektronike (EMD2 2009/110/KE), Direktiva e Krahasueshmërisë së kompensimeve për shërbimet në lidhje me llogaritë e pagesave, transferimi i llogarive të pagesave dhe aksesit në llogaritë e pagesave me funksione bazë (2014/92/KE), pjesë e dispozitave të Direktivës së Pestë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (2018/843) të cilat kanë të bëjnë me themelimin e një regjistri të vetëm të llogarive dhe kasafortave, Rregullativa për kompensimet e zëvendësimit për transaksionet e pagesave me kartelë (2015/751) dhe Rregullativa për vendosjen e kërkesave teknike dhe afariste për transfertat e kredisë dhe huamarrje direkt në euro (260/2012), në pjesën e provizioneve që lidhen me huamarrjen direkte.


Paralelisht me aktivitetet e finalizimit të Propozim – ligjit për shërbime pagesore dhe sistemit të pagesave, Banka Popullore punoi në mënyrë aktive në hartimin e projekt-rregullativave nënligjore për implementim të Ligjit pas miratimit të tij. Për këto aktivitet u sigurua ndihmë teknike nga BE⁷⁰ në kuadër të së cilës u rishikuan përvojat më të mira praktike dhe standardet e zbatuara te disa banka qendrore të vendeve anëtare të BE-së.

7.2. Qarkullimi pagesor i realizuar me instrumente të pagesave jo të gatshme

Vlera totale e pagesave⁷¹ në vend në vitin 2020 shënoi rënie vjetore prej 5% dhe arriti në 3,859 miliardë denarë, me 140 milionë transaksione të kryera dhe rritje vjetore të numrit të transaksioneve prej 10,2%. Mbizotërojnë sërish transfertat e kredisë (98,1%), me rritje të pjesëmarrjes strukturore me 3.3 p.p. e vlerës së transfertave të kredive të iniciuara në mënyrë elektronike (pjesëmarrja prej 53,5%) në kurriz të uljes së pjesëmarrjes së transfertave të kredive të iniciuara në letër me 3.8 p.p. (pjesëmarrja prej 44,6%) dhe rritje prej 0.5 p.p. (ose pjesëmarrje prej 1,9%) e kartave pagesore në vlerën totale të realizuar me instrumente pagesash pa para të gatshme.

Grafikoni 85

Pjesëmarrja strukturore e instrumenteve të pagesave pa para jo të gatshme dhe numri i total i pagesave



Burimi: BPRMV.

Ndryshimi në strukturën e pagesave vihet re veçanërisht në numrin e transaksioneve të kryera me instrumentet individuale të pagesave pa para të gatshme. Ashtu që, në vitin 2020 ka vazhduar tendenca e rritjes së numrit të transaksioneve me karta pagesore, duke arritur një pjesëmarrje prej 56,2% në totalin e numrit të pagesave (ritje e pjesëmarrjes prej 6,2 p.p. në bazë vjetore), pothuajse me pjesëmarrje të barabartë edhe transferat kreditore të iniciuara në letër ose elektronike (përkatësisht 22,4% dhe 21,4%). Ndryshimet në strukturë, të shkaktuara nga rritja e pjesëmarrjes së kartelave pagesore dhe rënia vjetore e përdorimit të transferave kreditore të nisura në sportelet e bankave (për 5.5 p.p.) në një masë të konsiderueshme nën ndikimin e krizës së koronës, tregojnë padiskutim ndryshim i zakoneve të qytetarëve dhe kompanive, më saktë, rritja e përdorimit të përfitimeve të digjitalizimit në tregun e shërbimeve pagesore.

⁷⁰ Projekti i financuar nga BE-ja me titull "Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt rrugës së tij për anëtarësim në SEBQ" u zhvillua në një periudhë prej 18 muajsh. Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte mbështetja e Bankës Popullore në ruajtjen e stabilitetit të sistemit makroekonomik dhe financiar, duke harmonizuar legjislacionin, politikën, rregullat dhe standardet e funksionimit me kërkesat e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

⁷¹ Pagesat i referohen transaksioneve të personave juridikë dhe fizikë (duke përjashtuar sektorin e institucioneve financiare monetare). Instrumentet pagesore që përdoren për kryerjen e pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë transfertat e kreditit dhe kartelat pagesore, ndërsa çeqet ishin në përdorim deri në vitin 2007, ndërsa huamarrja direkte ende nuk është futur si instrument pagese. Njëherit, edhe përkundër mundësisë ligjore, nuk ekzistojnë transaksione me para elektronike.

7.2.1 Transferet kreditore

Numri total i pagesave të kryera nga transfertat e kreditit në vitin 2020 arriti në 61,3 milionë transaksione dhe shënoi një rënie vjetore prej 3,6%.

Tabela 3
Transferet kreditore si instrument pagesor pa para të gatshme për personat juridikë dhe fizikë

Nurmi i transferet kreditore (pjesëmarrja strukturale) (viti 2020)	Personat fizikë (%)	Personat juridikë (%)
<i>Sipas mënyrës së inicimit</i>		
në letër	69,3	43,9
elektronike	30,7	56,1
<i>Sipas aparatit që janë inicuar transfertet kreditore elektronike</i>		
kompjuter personal	66,7	98,5
telefon celular	32,6	1,5
bankomat	0,7	/

Burimi: BPRMV.

Në strukturën e transfertave të kredisë nga aspekti i përdoruesit, personat juridikë vazhdojnë të mbizotërojnë me 71,2% (70,1% në vitin 2019) ndërsa pjesa tjetër prej 28,8% iniciohen nga personat fizikë. Edhe pse qytetarët përdornin më së shumti sportelet bankare për të kryer pagesat e transfertave të kreditit

(69,3%), megjithatë që nga fillimi i krizës së koronës e këndej, vihet re se personat fizikë gjithnjë e më tepër i përdorin dobitë e bankimit elektronik (pjesëmarrja në këto transaksione është 30,7%, krahasuar me 22% në vitin paraprak). Madje, 66,7% i kanë përdorur kompjuterë personalë, 32,6% kanë përdorur aplikacione celulare, dhe një përqindje e vogël e popullsisë përdorte bankomate për këtë qëllim. Ndryshe nga personat fizikë, personat juridikë më së shumti, ose 56,1% e totalit të transfertave të kredisë, i kanë kryer ato në mënyrë elektronike. Ashtu si te qytetarët, ashtu edhe me personat juridikë nga kanalet elektronike, mbizotëron përdorimi i kompjuterit personal, madje me 98,5%, ndërsa vetëm 1,5% kanë përdorur aplikacionet celulare bankare për këtë qëllim.

Edhe pse mënyra elektronike e inicimit të pagesave për shkak të efikasitetit, komoditetit dhe shpejtësisë së saj po pranohet gjithnjë e më shumë në vend, megjithatë të dhënat krahasuese tregojnë se në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një pjesë strukturore relativisht më të ulët të numrit të transaksioneve të transfertave të kredisë të iniciuara në mënyrë elektronike. (48,7%), krahasuar me vendet e vjetra anëtare të BE-së⁷² dhe vendet e EQJ⁷³, ku pjesëmarrja e transfertave të kredisë të iniciuara në mënyrë elektronike në numrin total të transaksioneve të transfertave të kredisë është përkatësisht 94% dhe 89%⁷⁴.

7.2.2 Kartelat pagesore

Numri i përgjithshëm i transaksioneve me kartela pagesore të lëshuara nga lëshuesit vendas të pajisjeve të vendosura në vend në vitin 2020 arriti në 106,4 milionë transaksione dhe shënoi një rritje vjetore prej 15,6%. Madje, si në këtë, ashtu edhe në vitet e kaluara, pjesëmarrja strukturore e numrit të transaksioneve në pikat fizike të shitjes po rritet me 3 p.p. duke arritur në 70%, në kurriz të uljes së pjesëmarrjes me 6 p.p. e transaksioneve të tërheqjes

⁷² Austria, Belgjika, Gjermania, Greqia, Danimarka, Irlanda, Italia, Mbretëria e Bashkuar, Portugalia, Finlanda, Franca, Holanda, Suedia dhe Spanja.

Bullgaria, Estonia, Qiproja, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Çeke, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Hungaria dhe Kroacia.


⁷⁴ Të dhënat më të fundit të disponueshme për shtetet anëtare të BE-së i referohen vitit 2019.

së parave të gatshme nga bankomatet (23%). Ndryshimi i zakoneve të qytetarëve për shkak të kushteve të imponuara nga pandemia e Covid-19 kontribuoi në rritjen e ndjeshme të përdorimit të kartelave pagesore në pikat e shitjes virtuale (internet) të brendshëm, që është 7%, por ende relativisht i ulët, ndërsa e ulët është edhe përdorimi i kartelave për deponim të parave të gatshme në bankomatet e vendit.

Në vitin 2020 në pajisjet e lokalizuara në vend, me kartelë pagesore të lëshuara nga lëshuesit e jashtëm janë realizuar 4,4 milionë transaksione (rënie vjetore prej 35,6%). Zvogëlimi i këtyre transaksioneve është dukuri e pritur për shkak të mbylljes së kufijve dhe udhëtimeve të reduktuara si pasojë e krizës globale shëndetësore. Megjithatë, nga apsketi i strukturës dhe vetive të përdorimit të kartelave pagesore të huaja në vend, akoma është e dukshme përdorimi i tyre gjithnjë e më shumë për pagesë në vendet fizike të shitjes (pjesëmarrje prej 73%), me një stabilitet dhe përdorim të pandryshuar për tërheqjen e parave të gatshme nga bankomatet (pjesëmarrja prej 20%). Madje është evidentuar rritje vjetore prej 4 p.p., përkatësisht pjesëmarrje prej 7% të përdorimit të kartelave të huaja pagesore për pagesë në vendve virtuale (internet) të brendshme të shitjes.

Grafikoni 86

Pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të transaksioneve me kartela pagesore



Burimi: BPRMV.

Me kartelat pagesore të dhëna nga lëshuesit vendas të pajisjeve të vendosura jashtë vendit, në vitin 2020 janë kryer 5.7 milionë transaksione, që është një rënie e ndjeshme prej 31.5% krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i mbylljes së kufijve dhe procedurave për dalje nga vendi në koha e pandemisë. Për dallim të përdorimit të madh të bankomateve në vend për tërheqjen e parave të gatshme me kartela pagesore nga lëshuesit e brendshëm, por edhe të lëshuesve të jashtëm, bartësit e kartelave të lëshuara nga lëshuesit e brendshëm gjatë udhëtimit të tyre jashtë shtetit nuk i shfrytëzojnë shpesh bankomatet e huaja dhe nuk tërheqin shumë të caktuar të parave të gatshme (pjesëmarrje prej 3% nga totali i transaksioneve me kartelë të lëshuesve të brendshëm në pajisjet jashtë vendit). Në kushtet e pandemisë, është e pritur rritja e përdorimit të kartelave pagesore të lëshuesve të brendshëm për pagesë virtuale (internet) vende për shitje të subjekteve të huaja (48,4%) e cila shënon rritje prej 7p.p në raport me vitin 2019, me çka pothuajse është barazuar pjesëmarrja e pagesave e vendeve fizike të shitjes (48,6%)

7.3. Infrastruktura pagesore

Numri i përgjithshëm i llogarive të transaksionit në vend të hapura te bankat afariste deri në fund të vitit 2020 është 3.82 milionë, nga të cilat 95% janë për persona fizikë ndërsa 5% për persona juridikë. Pothuajse çdo i katërti person fizik ka llogari përmes të cilave mund

të kryejë pagesa elektronike, ndërsa për personat juridikë 36% e numrit të përgjithshëm të llogarive të transaksionit mundësojnë pagesa elektronike, që është rritje prej 5 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2019.

Numri i përgjithshëm i kartelave pagesore të lëshuara nga subjektet vendase në fund të vitit 2020 arriti në 2.1 milionë kartela dhe krahasuar me fundin e vitit 2019 shënon rritje prej 14.6%. Kontributin më të madh në rritjen vjetore të numrit të kartelave pagesore në qarkullim e ka lëshimi i kartelës vendore pagesore, si një nga masat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për rimëkëmbjen e ekonomisë së Maqedonisë në kushte të Covid 19. Në vitin 2020, lëshuesit e kartaëve pagesore në vend vazhduan të aplikojnë teknologjitë e avancuara mbi të cilat bazohen operacionet e kartelave pagesore në mbarë botën. Në këtë kontekst, krahas kartelave të reja pagesore të lëshuara në kuadër të projektit të Qeverisë, u përshpejtua zëvendësimi i kartelave të kontaktit me kartelat me teknologjinë kontakt-pa kontakt, duke përfshirë zëvendësimin e kartelave pagesore të cilave ende nuk u ka skaduar afati, që në fund të vitit 2020, pjesëmarrja e kartelave kontakt- pa kontakt ishte 62% e konsiderueshme e numrit të përgjithshme të kartelave me funksion pagesor, që është rritje prej 9 pikë përqindje, krahasuar me përqindjen në fund të 2019-ës. Në vitin 2020 është vërejtur përparim në pjesën e ofertës së kuletave virtuale nëpërmjet integritit të kartelës pa kontakt me aplikacionin celular.⁷⁵ Me këtë inovacion teknologjik, kur të gjitha elementet e domosdoshme për kryerje të sigurt dhe efikas të pagesës integrohen me aplikacionin celular, tregu vendor i shërbimeve pagesore pasurohet me mënyrë moderne, komode dhe të sigurt për kryerjen e pagesave, që e përjashtim përdorim fizik të kartelës së plastikës pagesore.

Për zbatimin e teknologjisë pa kontakt, paralelisht me rritjen e numrit të karteave kontakt- pa kontakt prej 34,5% në nivel vjetor në vitin 2020, vërehet edhe rritje vjetore prej 16% (pse rritje dyfish më e lartë vjetore nga ajo që është evidentuar në fund të vitit 2019) të numrit të pajisjeve të instaluar në pikat e shitjes, që krahas teknologjisë me kontakt mbështesin edhe teknologji pa kontakt, me çka aritën pjesëmarrje të lartë prej 73% në numrin e përgjithshëm të pajisjeve për pagesa elektronike në pikat fizike të shitjes në fund të vitit 2020 (24.466 pajisje të instaluar kontakt- pa kontakt nga gjithsej 33.699). Oferta e rritur dhe përdorim të pajisjeve moderne digjitale për kryerjen e pagesave në vitin 2020 vërehet edhe nëpërmjet rritje vjetore prej 18 të numri të aparateve bankare me funksion shtesë për deponim të parave në dorë (193 bankomate) ndërsa numri i bankomateve me funksion shtesë për iniciimin e transferit kreditor (359) është relativisht i qendrueshëm.

Në fund të vitit 2020, gjatë rritjes jo të konsiderueshme prej 0,1%, numri i përgjithshëm i tregtarëve në vend që pranojnë pagesa me kartela pagesore arriti në 13.256, ku pjesëmarrje më të madhe prej 90,4% kanë tregtarë që i pranojnë pagesat e pikave fizike të shitjes (11.987) ndërsa 9,6% ose 1269 janë tregtarë që i pranojnë pagesat me kartela në pikat virtuale të shitjes. Si pasojë e krizës së koronës, distanca sociale dhe nevojat për mbrojtjen e qytetarëve, kompanitë filluan me hapjen e një numrit të madh të shitoreve virtuale, kështu që, krahasuar me vitin e kaluar, vërehet rritje e dukshme vjetore e numrit të tregtarëve që pranojnë pagesa me kartela në pika virtuale të shitjes (për 45%) kurse ka rënie mesatare të numrit të tregtarëve që pranojnë pagesa me kartelsa në pikat fizike të shitjes (3,1%).


⁷⁵ Në vitin 2020, edhe një bankë ofroi kuletë virtuale, bazuar në integrimin e kartelës pa kontakt me aplikacionin celular, me çka këtë shërbim tashmë e kanë tre banka.

7.4. Sistemet e pagesave në vend

Në vitin 2020, vlera e përgjithshme e transaksioneve në vend përmes sistemeve të pagesave arriti në 15,729 miliardë denarë, duke shënuar rritje vjetore prej 10,9%, gjatë realizimit të 29,6 milionë transaksione, të cilat shënuan rënie të moderuar vjetore prej 3,6%. Nga aspekti i vlerës së transaksioneve, shumica e tyre janë bërë përmes sistemit të pagesave SPNM, edhe atë 97%, ndërsa pjesa e mbetur prej 3% e totalit të pagesave janë bërë përmes sistemit të pagesave KIBS⁷⁶. Një pjesë e parëndësishme është kryer përmes sistemit të pagesave KASIS⁷⁷. Në strukturën e numrit të transaksioneve në të njëjtën periudhë, pjesëmarrje shënojnë sistemi i pagesave KIBS (78%), i ndjekur nga sistemi i pagesave SPNM me 22%, ndërsa KASIS ka një pjesëmarrje të vogël (0.03%).

Grafikoni 87

Pagesat e realizuara përmes sistemit të pagesave në vitin 2020



Burimi: BPRMV.

Shlyerja neto e pagesave përmes sistemit të pagesave KIBS dhe sistemit të pagesave KASIS kryhen në baza të rregullta përmes sistemit të shlyerjes MIPS, i cili në vitin 2020 ka punuar 247 ditë dhe ka ofruar akses për pjesëmarrësit në sistem prej 99.97%.

7.5. Mbikëqyrja e sistemit të pagesave në pajtim me standardet ndërkombëtare të pranuar

Aktivitetet e mbikëqyrjes së Bankës Popullore përfshinë mbikëqyrje të operatorëve të sistemeve të pagesave dhe analizë të të dhënave dhe informacioneve të siguruara nga ana e operatorëve, në pajtim me kornizën juridike kombëtare e cila e rregullon mbikëqyrjen⁷⁸ në të cilën janë përfshirë edhe standardet e pranuar ndërkombëtare për mbikëqyrje⁷⁹. Banka Popullore e kryen mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave në mënyrë të drejtpërdrejt, me këqyrje tek operatorët i cili menaxhon dhe udhëheq me sistemin e pagesave dhe në mënyrë tërthorazi, përmes monitorimit të rregullt jashtë terrenit të punës së sistemit të pagesave. Këto aktivitete para se gjithash kanë qëllimin të identifikojnë rreziqet potenciale me menaxhimin

⁷⁶ Shtëpia Kliring "Sistemi ndërbankar Kliring" SHA Shkup është operator i sistemit të pagesave për neto shlyerje shumëpalëshe të shtyrë për procesimin e pagesave të vogla, shumica e të cilave nuk tejkalon 1.000.000 denarë.

⁷⁷ Sistemi i Kartelave Internacionale SHA Shkup (KASIS) është sistem për shlyerje neto shumëpalëshe të shtyra të pagesave me markat vendore të kartelave pagesore.

⁷⁸ Vendim për mënyrën dhe metodologjinë e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/16) dhe Vendim për kriteret dhe standardet e punës së sistemeve të pagesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/16).

⁷⁹ „Parimet e infrastrukturës së tregut financiar“ (PITF) të Komitetit të sistemit për pagesa dhe shlyerje dhe Komitetit teknik i Organizatës ndërkombëtare të komisioneve për letrat me vlerë.

përkatës të tyre do të mundësohet funksionim efikas, i pandërprerë dhe të sigurtë të sistemit të pagesave.

Në këtë kuptim, gjatë vitit 2020 Banka Popullore e përfundoi pjesën e terrenit të mbikëqyrjes së drejtpërdrejt të pjesërishme të operatorit të sistemit të pagesave KIBS për vlerësim të harmonizimit të punës së këtij sistemit të pagesave me kërkesat e shtatë parimeve tjera të rëndësishme të sistemit të pagesave⁸⁰. Aktivitetet në vijim janë duke u zhvilluar për përgatitjen e raportit me supozimet e identifikuara dhe dorëzimin e tij në KIBS për veprime të mëtutjeshme. Pas përfundimit të kësaj mbikëqyrjeje, mbikëqyrja e sistemit të pagesave të KIBS-it do të kompletohet në përputhje me të gjitha kërkesat e parimeve të zbatueshme për sistemet e rëndësishme të pagesave. Gjithashtu, është përfunduar pjesa në terren e mbikëqyrjes së pjesërishme të drejtpërdrejtë të operatorit të sistemit të pagesave MIPS për vlerësimin e përputhshmërisë me nëntë parimet.

Gjatë fundit të vitit 2020, Banka Popullore filloi me mbikëqyrjen të drejtpërdrejtë të pjesërishme të sistemit të pagesave MIPS me pjesën e mbetur të kërkesave për rëndësinë sistematike të sistemeve të pagesave dhe filloi me mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të plotë të operatorit të sistemit të pagesave KASIS për vlerësimin e harmonizimit të kërkesave nga parimet që janë të zbatueshme në sistemet e tjera pagesore. Raportet me supozimet nga mbikëqyrja e realizuar e drejtpërdrejtë e pjesërishme mbi sistemet e pagesave MIPS dhe KASIS do të përpilohen gjatë vitit 2021, me çka do të rumbullaksohet mbikëqyrja e të gjitha sistemeve të pagesave sipas të gjithave parimeve përkatëse të zbatueshme.

Në të njëjtën kohë, në bazë të rregullt është realizuar mbikëqyrja jashtë terrenit të sistemeve të pagesave, në bazë të së cilës është konstatuar se gjatë vitit 2020 sistemet e pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë punuar në nivel të lartë operativ, qashmërisë dhe efikasitet, pa rënie dhe çrregullimeve të evidentuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kushtet kur vendi po përballë me krizë e koronës dhe është rezultat i procedurave të paracaktuara dhe të testuara për sigurimin e vazhdimësisë së punës në përputhje me standardet për funksionimin e tyre të përcaktuara nga Banka Popullore. Në kushte të pandemisë, Banka Popullore ndërmori varg masash duke siguruar nivel të sigurisë së informimit, si dhe masat mbrojtëse për të punësuarit, duke siguruar funksionim të pandërprerë të proceseve kritike të ndërlidhura me operacionet e sistemeve të pagesave. Në përgjithësi, sistemet e pagesave në vitin 2020, edhe përkundër sfidave të paraqitura nga pandemia Covid-19 që ndryshuan mënyrën e kryerjes së proceseve të punës (puna nga shtëpia dhe me ndërime rotacione në hapësirat e punës së vendeve operative), punuan në mënyrë efikase ashtu që siguruan kryerjen e pagesave të pandërprera dhe stabile në Republikën e Maqedonisë së Veriut.


⁸⁰ Mbikëqyrja e KIBS për vlerësimin e harmonizimit të punës së këtij sistemit të pagesave me gjashtë kërkesat e mbetura të parimeve zbatueshme të rëndësishme për sistemin e pagesave janë kryer me dy mbikëqyrje të pjesërishme. I pari i cili ka të bëjë me dy parimet e filluara në nëntor 2017 mbaroi me plotësimin e të gjitha rekomandimeve nga ana e operatorit KIBS në nëntor 2019. I dyti mbikëqyrja e pjesërishme qëllimi i të cilës ishin katër parimet filloi në dhjetor 2018 dhe mbaroi me plotësimin përkatës të rekomandimeve në dhjetor 2020

VIII. Lëshimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut- operacionet e thesarit

8.1. Paratë e lëshuara në qarkullim

Më 31.12.2020, shuma e përgjithshme e parave të lëshuara në qarkullim është 50.029 milionë denarë dhe krahasuar me fundin e vitit 2019 ato shënojnë rritje me 6.706 milionë denarë ose 15,5%⁸¹. Struktura e parasë në qarkullim tregon se në fund të vitit, kartëmonedhat marrin pjesë me 97,8% dhe monedhat 2,2% të vlerës së përgjithshme. Nga aspekti i numrit të parave të lëshuara në qarkullim, pjesëmarrja e kartëmonedhave është 28,6% (110,3 milionë copë) dhe monedha 71,4% (275,2 milionë copë).

Grafikoni 88
Paratë e lëshuara në qarkullim




Burimi: BPRMV.

Kartëmonedhat me emërtim 1000 denarë (44,7%), 500 denarë (36,51%) dhe 2000 denarë (13,1%) zënë pjesëmarrjen më të madhe në vlerën e përgjithshme të emetimit të kartëmonedhave. Kartëmonedhat e mbetura përbëjnë 5,7% të vlerës së përgjithshme. Në vitin 2020, vlera më e madhe në vlerë të arkës kanë prerjet prej 10 denarë (30,9%), 50 denarë (26,1%) dhe 5 denarë (18,9%).


⁸¹ Në të dhënat e paraqitura për paratë e lëshuar në qarkullim, nuk përfshihen sasi dhe vlera e monedhave për qëllime koleksionuese, që Banka Popullore për arsye artistike, kulturore dhe promovuese i përgatiti dhe lëshoi në qarkullim. Monedhat për qëllime koleksionuese janë në dispozicion kryesisht jashtë vendit, por edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vlera e monedhave për qëllime koleksionuese në qarkullim, më 31 dhjetor 2020, arriti në 11,2 milionë denarë

Grafikoni 89⁸²



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 90



Burimi: BPRMV.

Në strukturën e parave të lëshuara në qarkullim sipas numrit të copave, kartëmonedhat kanë pjesën më të madhe në emërtimin e 10 denarë – polimer (21,1%), 1000 denarë (19,8%), 10 denarë (15,4%) dhe 100 denarë (14%). Kartëmonedhat e mbetura përbëjnë 28,7% të totalit të kartëmonedhave në qarkullim. Pjesëmarrje më të madhe në monedhat e emetuara gjithsej ka emërimi prej 1 denarë (40,1%) dhe 2 denarë (28,4%).


Paratë e polimerit në strukturën e parave të lëshuara në qarkullim kanë një vlerë papërfillshme të pjesëmarrjes (1%) në raport me monedhat e mbetura, ashtu që duhet të kihet parasysh vlera e tyre e vogël nominale dhe periudha e shkurtë relative e qarkullimit. Sipas sasisë, pjesëmarrja e parave polimere në numrin e monedhave në para në qarkullim vërehet dhe arrin 27%, duke pasur parasysh rolin e tyre të rëndësishme në shitblerjet e vogla.

⁸² Me shkronjë "p" në grafikun janë të shënuara para polimere.

8.2. Furnizimi i bankave dhe qendrave të parasë me kartëmonedha dhe monedha

Banka Popullore, gjatë vitit 2020, bëri lëshimin e parave të bankave dhe qendrave për para të gatshme⁸³ në vlerë prej 26.599 milionë denarë (rritje prej 17,9% në raport me vitin 2019). Në të njëjtën kohë, janë pranuar para të gatshme nga bankat dhe qendrat e parasë në vlerë prej 20.256 milionë denarë (rritje prej 6,3% krahasuar me vitin 2016). Analiza e strukturës sipas emërimit të kartëmonedhave dhe monedhave tregon se në qarkullimin total, të parave prej letre një pjesëmarrje më e madhe vërehet në emërtimin prej 1000 denarë nga 25,5% në vitin 2020 (përkatësisht 38,7% në vitin 2019) kurse në monedhat mbizotëron emërtimi prej 2 denarësh, me një pjesëmarrje prej 40,9% në vitin 2020 (krahasuar me 29,9% në vitin 2019).

Grafikoni 91



Burimi: BPRMV.

8.3. Përpunimi dhe shkatërrimi i kartëmonedhave dhe monedhave

Gjatë vitit 2020, në procesin e kontrollit të cilësisë së kartëmonedhave që ishin në qarkullim, janë përpunuar gjithsej 36,6 milionë copë nga të cilat për shkak të papërshtatshmërisë të qarkullimit u shkatërruan 4,1 milionë copa (12,7 milionë kartëmonedha në vitin 2019). Pjesëmarrje më të madhe të shkatërrimit kanë kartëmonedhat prej 100 denarë (52,1%) dhe 500 denarë (23,2%). Në 2020, 3,7 milionë copë monedha u përpunuan në emërtimet e 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë, nga të cilat 16 mijë copë u tërhoqën si të papërshtatshme për qarkullim.

8.4. Ekspertizë për paratë e dyshimta /të falsifikuara

Në kuadër të përgjegjësive të saj si institucion i vetëm i autorizuar për përcaktimin e origjinalitetit të kartëmonedhave dhe monedhave të shprehura në denarë dhe në monedha të huaja, Banka Popullore edhe gjatë vitit 2020 me sukses e realizoi funksionin për ekspertizë të parave të falsifikuara. Me qëllim të përforcimit të kapaciteteve për të zbuluar me saktësi paratë e dyshimta dhe të falsifikuara në subjektet që operojnë të holla ditore, Banka Popullore gjatë vitit 2020 kishte qëllim që t'i përforcojë trajnimet e specializuara të të punësuarve në bankat dhe qendrat për të holla, por për shkak të masave për parandalim të përhapjes së virusit covid-19 u prolonguan. U prolonguan edhe trajnimet të planifikuara në pajtim me planin

⁸³ Gjatë vitit 2020, në aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e furnizimit me para të gatshme edhe më tej mbeten aktive të funksionojnë dy qendrat ku janë transferuar një pjesë e operacioneve të parave të gatshme nga bankat afariste.

kombëtar për trajnim, në kuadër të së cilës, ekspertët e Bankës Popullore duheshte të sigurojnë trajnime për nëpunësit policor dhe të punësuarit në institucionet tjera të përfshira në luftën kundër falsifikimit të parave.


Sa për numrin e hetimeve të kryera gjatë vitit 2020, nga totali i dorëzuar prej 62 kartëmonedha të dyshimta të shprehura në denarë, gjatë ekspertizës profesionale u vërtetua se të gjitha mostrat ishin të falsifikuara, që paraqet zvogëlim për 83% në raport të kartëmonedhave të zbuluara gjatë vitit 2019. Në numrin e përgjithshëm të kartëmonedhave të falsifikuara të denarit në vitin 2020, më së shpeshti është emërtimi i 2000 denarëve (23 copë) ose 37,1% të numrit të përgjithshëm të falsifikimeve, e ndjekur nga emërtimi 500 denarë (16 copë) ose 25,8% të numrit të përgjithshëm të falsifikimeve dhe emërtimi i 100 denarëve (15 copë), ose 24,2% të numrit të përgjithshëm të falsifikimeve. Vlera e përgjithshme e denarëve të falsifikuar në vitin 2020 është 61.900,00 denarë dhe ka peshë të parëndësishme në raport me vlerën e përgjithshme të parave në qarkullim.

Në kuadër të autorizimeve të saj, për shkak të përcaktimit të mundësisë së ndërrimit në bazë të kriterëve të shënuara, Banka Popullore në këtë periudhë kohore realizoi edhe ekspertizë profesionale të 164 mostrave të parave të dëmtuara të dorëzuara nga bankat dhe qendrat për para të gatshme.


Gjithashtu, Banka Popullore gjatë vitit 2020 bëri ndërrimin e parave të dëmtuara dhe të monedhave të cilat i dorëzojnë personat fizik, si dhe ndërrim të parave të cilat u tërhoqën nga qarkullimi, për të cilat nuk ekziston kufizim kohor për ndërrimin e tyre. Gjithsej është bërë ndërrimi i 1.053 para në letra dhe 17.698 copa të parave në letra janë tërhequr nga qarkullimi.

Grafikoni 92

Pasqyrë të denarëve të falsifikuar



Pasqyrë të parave të huaja të falsifikuara



Burimi: BPRMV.

Sa i përket ekspertizës së kryer të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshimta të paraqitura në monedhë të huaj në vitin 2020, nga gjithsej 279 analiza të bëra rezultuan 236 para të falsifikuara dhe 43 para origjinale. Në numrin e përgjithshëm të parave të falsifikuara të letrës, më të zakonshmet janë kartëmonedhat në euro (212 copë) dhe dollarët amerikanë (11 copë). Si dhe vitet paraprake, numri i falsifikimit të monedhave është i parëndësishëm dhe paraqet një sasi të përgjithshme prej 3 copa të falsifikuara të monedhave edhe atë të emërimit prej 2 euro. Vlerësimi i përgjithshëm është se paratë-letra dhe monedhat e falsifikuara kanë cilësi relativisht të dobët të prodhimit, gjë që mundëson zbulimin e thjeshtë dhe të lehtë dhe përcaktimin e karakteristikave të tyre⁸⁴.

⁸⁴ Gjatë ekspertizës së teknikës për përpunimin e kartëmonedhave të falsifikuara, u konstatua se ato ishin kryer kryesisht me letër të zakonshme, pa elemente të mjaftueshme mbrojtëse, duke përdorur teknologjinë kompjuterike (skanim dhe shtypje) ose duke përdorur një fotokopjues me ngjyrë.

Në tetor 2020, Banka Popullore lidhi [Kontratë për bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane \(BQE\) në sferën e mbrojtje së bankotave në euro të falsifikuara](#). Me këtë rumbullakohet korniza e bashkëpunimit në raport të mbrojtjes së euros së falsifikuar, duke pasur parasysh edhe Kontratën me Komisionin Evropian për Bashkëpunim në Fushën e Mbrojtjes së monedha në euro nga falsifikimi, e cila u lidh vitin e kaluar.

8.5. Kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kriterëve për punë me para në dorë te bankat dhe qendrat e parasë

Duke i respektuar masat për parandalim të përhapjes së virusit covid-19, Banka Popullore gjatë 2020 i ka kushtuar kontrolleve të drejtpërdrejta të të dhënave për llojin dhe numrin e makinave për përpunim të parave, lokacionet ku janë vendosur dhe sasinë e parave të përpunuar përmes makinave për përpunim të parave dhe parat të përpunuar me dorë, të cilat në tremujorshe bankat dhe qendrat e parasë i dorëzojnë deri te Banka Popullore.

Në periudhën referuese janë realizuara gjithsej 30 testime të rregullta për përpunim makinerik të kartëmonedhave dhe monedhave, për shkak të tejkalimit të kornizës kohore të vlefshmërisë së vërtetimit me të cilat dëshmohet aftësia e makinës për kryerjen përkatëset të përpunimit të parave.

8.6. Shitja e monedhave për qëllime koleksionimit

Monedhat për qëllime të koleksionimit janë unike, mostra përfaqësuese, me vlerë të jashtëzakonshme artistike dhe si pasojë të kontribuojnë në promovimin e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit. Edhe pse në shitjen e monedhave parësore për qëllime koleksionimit është dedikim dhe zhvillohet jashtë shtetit, shënohet interes për ta edhe në vend⁸⁵. Në vitin 2020, janë të shitura gjithsej 90 mostra të monedhave për qëllime koleksionit, nga të cilat përmes Bankës Popullore janë të shitura 69 copa, ndërsa përmes komisionarit 21 copa.

⁸⁵ Për shkak të rritjes së interesit për këto monedha dhe mundësisë për një disponimi më të madh për furnizim edhe në ditë jopune, Banka Popullore mundësoi shitejn e tyre përmes Institutit Kombëtar "Shtëpia Përkujtimore e Nënë Terezës", Shkup.

IX. Auditimi i brendshëm

Në vitin 2020, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) zbatoi plotësisht programin e tij të punës. Përmes vlerësimit sistematik dhe rekomandimeve për përmirësimin e procesit të menaxhimit të rrezikut, përshtatshmëria dhe efektiviteti i kontrolleve të brendshme, si dhe proceset e menaxhimit, auditimi i brendshëm ka arritur qëllimet e tij primare, duke siguruar:

1. përdorimin efektiv dhe ekonomik të burimeve;
2. ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurt të mjeteve;
3. besueshmërinë dhe integritetin e informatave financiare dhe të tjera; dhe
4. pajtueshmërinë e veprimeve me ligjet dhe aktet nënligjore, politikat e brendshme dhe procedurat për punë.

Në vitin 2020, janë kryer gjithsej 17 auditime (14 auditime të rregullta dhe 3 auditime të jashtëzakonshme) ku janë përfshirë 17 procese të punës. Për raportet e vërtetuara janë dhënë gjithsej 22 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Në baza të rregullta tremujore, është ndjekur zbatimi i rekomandimeve të dhëna, dhe gjetjet nga monitorimi i kryer treguan se rekomandimet kryesisht respektohen dhe zbatohen brenda afatit të caktuar. Niveli i realizimit të gjithsej 28 rekomandimeve të dhëna, nga viti i kaluar (12) dhe nga viti 2020 (16) në afatin e realizimit në vitin 2020 është 82%, pra vetëm pesë rekomandime nuk janë realizuar dhe për ta është caktuar afat i ri për realizim.

Përveç auditimit të rregullt, auditimi i brendshëm ka pasur aktivitete shtesë përmes zbatimit të Programit për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e punës të DAB. Nga ky aspekt, në kuadër të këtij programi, gjatë vitit 2020 janë kryer revidim dhe është miratuar Rregulloren dhe Udhëzim Teknik i Ri për Punën e Auditimit të Brendshëm, është përpiluar Udhëzuesi për Kryerjen e Auditimit të Projekteve dhe Metodologjia përkatëse për vlerësimin e rreziqeve të projekteve, si dhe aktivitete të tjera nga fusha e auditimit të brendshëm.


Puna e DAB-it ka qenë e mbikëqyrur nga afër nga Komiteti i Auditimit, i cili zhvilloi seanca të rregullta gjatë vitit 2020.

X. Menaxhimi me resurset njerëzore

Menaxhimi me resurset njerëzore është një nga faktorët kyç për funksionimin e suksesshëm të secilës tërësi organizative. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut është një institucion që vazhdimisht kujdeset dhe investon në të punësuarit e tij, për shkak të forcimit aftësive dhe kompetencave të tyre dhe rritjen e njohurive profesionale, me qëllim që të krijojë një kuadër kompetent që do t'i përgjigjet në mënyrë adekuate sfidave për arritjen e suksesshme të qëllimeve të punës.

Në fund të vitit 2020, numri i të punësuarve⁸⁶ në Bankën Popullore është 434 dhe shënon ulje të saj në raport me fundin e vitit 2019 (440 të punësuar). Në pajtim me të, shënohet edhe ndryshim i vogël në strukturën gjinore të punëtorëve në Bankën Popullore në krahasim me vitin paraprak. Në fakt, popullsia femërore në vitin 2020 arrin 57,6%, kundrejt popullsisë mashkullore 42,4% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, e cila në vitin 2019 ishte 58,3% popullsia femërore, kundrejt popullsisë mashkullore e cila ishte 41,7%.

Grafikoni 93
Struktura e kualifikimit të të punësuarve në Bankën Popullore sipas kornizës nacionale të kualifikimeve në RMV (me përqindje, gjendja deri më 31.12.2020)



Burimi: BPRMV.

realizimin e procesit të vlerësimit të suksesshmërisë së punët, sfidat me të cilat ballafaqohen vlerësuesit, rekomandimet e vlerësuesit në lidhje me procesin e vlerësimit, si dhe lidhshmëria e procesit të vlerësimit dhe arritje e angazhimit të punëtorëve.

Banka Popullore vazhdimisht investon në aftësimin profesional e të gjithë të punësuarve, në mënyrë që të përmbushen qëllimet strategjike, misioni dhe vizioni i institucionit. Gjatë vitit 2020, u organizuan gjithsej 443 trajnime profesionale në vend dhe jashtë shtetit.

Krahasuar me vitin paraprak 2019, mund të shihet se numri i trajnimeve profesionale shënon një rritje të më shumë se dyfishë, e cila në masë të madhe i reflektohet mënyrës së organizimit të tyre. Në fakt, për shkak të përshtatjes drejt kushteve të reja të funksionimit, si përgjigje ndaj pandemisë, organizatorët e trajnimit profesional pjesë të madhe të ngjarjeve


Nga aspekti i strukturës së kualifikimit, pjesëmarrje më të madhe prej 43,6% shënojnë punëtorët me arsim të lartë (studime katërvjeçare), pastaj vijojnë punëtorët me master studime me 22%. Sa i përket strukturës së moshës, moshë mesatare e të punësuarve në vitin 2020 është 44,8 vjet, në dallim të moshës mesatare prej 44,2 vjet në vitin 2019.

Proceset e zhvillimit profesional, vlerësimi i performancës dhe shpërblimi janë procese të cilat Banka Popullore i zbaton me qëllim që të ndikojnë në zhvillimin e punëtorëve dhe karrierës së tyre. Edhe këtë vit u zhvilluan konsultime në nivelet e njësive organizative (këtë vit virtuale) të ndërlydhura me mënyrën e

⁸⁶ Së bashku me numrin e të punësuarve të angazhuar nga Agjencia për punësime të përkohshme, numri i përgjithshëm është 440. Grafikonet në këtë pjesë janë përgatitur sipas numri të përgjithshëm të të punësuarve.

të parashikuara të mbahen me prani fizike, i realizuan në formatin virtual, e cila krijojë hapësirë për numër më të madh të pjesëmarrësve.

Grafikoni 94
Numri i trajnimeve profesionale të realizuara në vend dhe jashtë vendit



Burimi: BPRMV.

krahasuar me vitin paraprak 2019. Rritja e numrit të punëtorëve që kanë ndjekur trajnime profesionale vjen si pasojë e rritjes së numrit të trajnimeve profesionale, si dhe pjesëmarrjes së më shumë punëtorëve në të njëjtin ngjarje virtuale.

Organizatorët kryesorë të jashtëm të trajnimeve profesionale janë bankat qendrore evropiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në bashkëpunim me Institutin e Bashkuar të Vjenës, Banka për Shlyerje Ndërkombëtare, me të cilat Banka Popullore bashkëpunon intensivisht përmes programeve për bashkëpunim të ndërsjellë. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i trajnimeve profesionale janë realizuar në kuadër të projekteve të financuara nga fondet e para-anëtarësimit të Bashkimit Evropian. Si organizatorë kryesor të aftësimeve profesionale në vend paraqiten qendrat e brendshme të edukimit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ndryshimin e rregulloreve ligjore, në fushën e punës së Bankës Popullore.

Përkundër kësaj, me qëllim të shpërndarjes së njohurive dhe shfrytëzimit të kapaciteteve të brendshme njerëzore për shkak të përforcimit dhe përmirësimit të shkathtësive digjitale të punëtorëve, në vitin 2020 në Bankën Popullore u realizuar edhe e-trajnime të specializuara me ligjërues të brendshëm, e cila do të vazhdojë si praktikë edhe në vitin 2021 .

Madje, trajnimet profesionale të organizuara nga ana e organizatorë të huaj dhe vendas kanë shënuar rritje të dyfishtë në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak 2019. Madje, nga gjithsej 443 trajnime profesionale të realizuara përfshijnë e-kurse, seminare, punëtori, vebinare (gjithsej 128 vebinare të realizuara në vend dhe jashtë vendit). Në të njëjtën kohë, u rrit edhe numri u punëtorëve të cilët kanë vizituar trajnim profesional në vitin 2020 shënon rritje prej 19,3%,

XI. Realizimi i Programit për punën për vitin 2020

Hyrje

Gjatë vitit 2020, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka arritur qëllimet e saj strategjike në kushte të jashtëzakonshme dhe të vështira si pasojë e pandemisë shëndetësore të COVID-19. Në përputhje me masat për mbrojtje nga përhapja e virusit, si dhe praktikat e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe komunitetit bankar qendror, Banka Popullore ndërmori disa aktivitete konkrete, para së gjithash, për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, duke përfshirë edhe të punësuarit e saj. Aktivitetet dhe masat e ndërmarra kanë mundësuar gjithashtu punën e pandërprerë të Bankës Popullore dhe realizimin e përditshëm të qëllimeve dhe funksioneve të saj ligjore.

Për të zbutur efektet e mundshme në ekonomi të shkaktuara nga pandemia Covid-19, Banka Popullore miratoi disa vendime dhe masa në përputhje me kompetencat e saj për të ruajtur stabilitetin monetar dhe financiar, si dhe për të përmirësuar mjedisin e përgjithshëm të punës së kompanive dhe përkrahjen e ekonomisë së Maqedonisë. Kështu, Banka Kombëtare qëndroi e qëndrueshme në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe monedhës vendase dhe sistemi bankar tregoi se në mënyrë të suksesshme po ballafaqohet me krizën e koronës. Edhe në kushtet e pandemisë nga Covid-19, Banka Popullore ka punuar në mënyrë aktive në realizimin e aktiviteteve të planifikuara programore, dhe me këtë edhe në forcimin e kapaciteteve të saj institucionale.

[Programi i punës së Bankës Popullore për vitin 2020](#) (në tekstin e mëtejshëm: Programi i punës) është një përpunim i detajuar i njëmbëdhjetë qëllimeve strategjike të parapara me [Plani Strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2020-2022](#) (në tekstin e mëtejshëm: Plani Strategjik). Programi i punës përmban 151 aktivitete programore, ku pjesa më e madhe e aktiviteteve programore mbulojnë procese të rregullta të punës që janë të lidhura drejtpërdrejt me qëllimet strategjike dhe detyrat ligjore të Bankës Popullore dhe realizohen gjatë gjithë vitit. Gjithashtu, pati edhe aktivitete të jashtëzakonshme që dolën nga kushtet e krijuara të reja të punës. Gjatë vitit janë realizuar edhe një numër i madh i projekteve, të cilat mundësojnë realizimin e vizionit të parashikuar të Bankës Popullore, e cila është që të jetë e njohur si institucion i pavarur, përgjegjës, profesional dhe transparent, kredibileti dhe integritetit i të cilës vazhdimisht dëshmohen.

Qëllimi strategjik 1 - Ruajtja e stabilitetit të çmimeve përmes kursit stabil të denarit kundrejt euros

Në vitin 2020, aktivitetet për ruajtjen e stabilitetit monetar u kryen në kushte që kërkonin vendime të menduara mirë, në kohë dhe të duhura që zbusnin efektet negative në ekonomi të shkaktuara nga pandemia Covid-19 dhe sigurimi i kushteve për funksionimin normal të sistemit bankar dhe kompanive në vend. Në lidhje me **zbatimin e politikës monetare**, Banka Popullore ka kryer rregullisht operacione monetare, duke marrë parasysh rrethanat e jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me përhapjen e Covid-19. Për shkak të rritjes së likuiditetit të sistemit bankar dhe mbështetjen e flukseve kreditore në ekonomi, Banka Popullore, **në bazë të monitorimit të vazhdueshëm dhe analizës së mundësive për sigurimin e mjeteve likuide për bankat përmes set instrumenteve monetare**, ka kryer më shumë ndryshime në instrumentet monetare të cilat mundësuan mbështetje të likuiditetit të sistemit bankar dhe të ekonomisë së vendit. Gjithashtu, në gusht 2020, me qëllim të plotësimit të nevojave të mundshme për likuiditet në euro, në kushtet e çrregullimeve të tregut për shkak të krizës nga Covid-19, BQE i ka ofruar Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut **repo-linje** në vlerë prej 400 milionë euro për sigurimin e likuiditetit

në valutë në euro për institucionet financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes Bankës Qendrore.

Në procesin e zbatimit operativ të politikës monetare, **vëmendja e Bankës Popullore u përqendrua në zhvillimet e tregut valutor, me qëllim të sigurohet qëndrim i mëtutjeshëm stabil të kursit të denarit në raport me euron.** Në këtë kontekst, janë ndërmarrë një sërë aktivitetesh **për ruajtjen e stabilitetit të kursit të denarit**, të cilat përfshinin: analiza të gjithanshme dhe monitorim aktiv të zhvillimeve dhe trendeve në tregun e brendshëm valutor; komunikimet e përditshme me bankat për të ofruar informacion shtesë të nevojshëm për të kuptuar më mirë zhvillimet; riaktivizimi i mundësisë së bankave vendase për vendosjen e depozitave në valutë në Bankën Popullore; dhe prania e Bankës Popullore në tregun valutor përmes ndërhyrjeve me bankat mbështetëse.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve programore në fushën e vendosjes së politikës monetare lidhur me përgatitjen e projeksioneve makroekonomike, anketat dhe analizat e rregullta hulumtuese të cilat përdoren gjatë sjelljes së vendimeve të politikës monetare u zhvilluan me dinamikë të rregullt dhe kontribuan për ruajtjen e stabilitetit të çmimit përmes kursit stabil të denarit në raport me euron, si qëllim strategjik bazë të Bankës Popullore.

Aktivitetet programore për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës analitike të projeksioneve makroekonomike janë realizuar rregullisht. Përveç kontrolleve të zakonshme dhe përmirësimeve të modeleve ekzistuese, u realizuan aktivitete në lidhje me konstruktimin e modelit DSGE për analizë të politikave në Maqedoninë e Veriut me ndihmë të misionit teknik të Bankës Popullore të Çekisë.

Gjatë vitit 2020, është bërë azhurimi i treguesve bazë në të cilat bazohet strategjia ekzistuese monetare, përmes rivlerësimit të transmisionit monetar të normave të interesit dhe vlerësimit të përputhshmërisë së kursit valutor real efektiv me fundamentet e saja me zbatimin e dy qasjeve (BEER dhe FEER)⁸⁷. Gjatë vitit janë shqyrtuar treguesit për cenueshmërinë e ekonomisë së Maqedonisë dhe për vendet e caktuara të rajonit, ndërsa u realizua edhe auditimi i rregullt i qëndrueshmërisë së borxhit të jashtëm, si dhe qëndrueshmërisë së borxhit publik. Në bazë të rregullt u realizuan Anketat e aktivitetit kreditor, si dhe Anketa e inflacionit të pritur dhe për pritjet zhvillimeve të PBB reale për shkak të marrjes së elementeve kyçe hyrëse gjatë parashikimit të flukseve të ardhshme makroekonomike. Për nevojat e projeksionit të bilancit të pagesave, janë kryer anketa mbi planet e biznesit të eksportuesve dhe importuesve më të mëdhenj.

Për të perceptuar zhvillimet e fundit në ekonominë e Maqedonisë në tërësi dhe në sektorë të caktuar të ekonomisë së vendit, si dhe vlerësimit të ndikimeve të tyre në politikën monetare, janë përgatitur **raporte të rregullta mujore dhe tremujore, si dhe raport vjetor për punën e Bankës Popullore.** Për shkak të sigurimit të transparencës së politikës monetare, rregullisht janë përgatitur dhe publikuar njoftime dhe prezentime për publikun në të cilat janë dhënë përshkrim të detajuar të pritjeve për periudhën e ardhshme dhe efektet e saja mbi vendimet monetare .

Duke pasur parasysh mjedisin e pasigurt në vitin 2020 dhe ndikimi i tij në ekonomi, u përgatitën disa prezantime, analiza dhe hulumtime të brendshme mbi temat aktuale në fushën e makroekonomisë. Gjithashtu u prezantuan analizat lidhur me infeksionin e ri viral Covid-19 dhe efektet e mundshme mbi ekonominë e vendit, perceptimet e bankave dhe ndikimi i kanalit të besimit mbi depozitat e populltës dhe kërkesa për valuta. Në të njëjtën kohë u publikuan

⁸⁷ BEER-Behavioral Equilibrium Exchange Rate: FEER-Fundamental Equilibrium Exchange Rate.

disa analiza makroekonomike, në formë të [artikujve analitikë](#) në kuadër të raporteve të rregullta tremujore, ndërsa pjesë të tyre ishin të ndërlidhura me efektet e pandemisë mbi tregun këmbimor dhe mbi ekonominë në tërësi.

Qëllimi strategjik 2 - Ruajtja e sistemit stabil dhe të sigurt bankar, si parakusht themelor për stabilitetin financiar dhe rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit

Gjatë vitit 2020, Banka Popullore edhe më tej e **përmirësojë rregullativ ligjore nga fusha e punës bankare dhe mbikëqyrjes** në pajtim me dispozitat e direktivës së BE⁸⁸ dhe rekomandimet e misionit vlerësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, FSAP⁸⁹. Gjithashtu, pjesë të **ndryshimeve në aktet nënligjore janë të ndërlidhura edhe me efektet e krizës së koronës për shkak të përshtatjes së kushteve të reja të punës**⁹⁰. Ashtu që, në prill 2020, u miratuan ndryshime rregullatore me të cilat bankat dhe kursimore ju mundësohet me ndryshimin e kushteve të kontraktuara t'ju lehtëson ngarkesën financiare të kreditoshfrytëzuesve, ndërsa në maj 2020 [u ndërprerë kompensimi për dhënien e të dhënave të personave fizik nga Regjistri Kreditor](#) për borxhin ndaj bankave dhe kursimoreve, me çka u kontribua në zvogëlimin e tregut të tyre financiar.

Gjatë vitit, janë hartuar Projekt –ligji për ndërhyrje në banka dhe Projekt –ligji për mbikëqyrje makroprudenciale, si dhe projekt aktet nënligjore për ndërhyrje në banka dhe dy projekt aktet të cilat dalin nga Ligjit për institucione pagesore dhe sistemet e pagesave. Gjithashtu është hartuar Lgji për stabilitet financiar, ndërsa punoheshte edhe në rregulloret nënligjore të fushës së [rreziku i likuiditetit, identifikimi i palëve të lidhura dhe kufijtë e ekspozimit, rreziku kreditor, metodologjia e menaxhimit të rrezikut, metodologjia për identifikimin e bankave me rëndësi sistematike dhe mjaftueshmëria e kapitalit](#).

Shtojca 4 Përmirësimi i rregullores me qëllim harmonizimin me dispozitat e rregullores evropiane për kërkesat kapitale dhe për efikasitetin e analizave të sistemit bankar dhe stabilitetit financiar

Gjatë vitit, u hartua një rregullativ e re për **menaxhimin e rrezikut të likuiditetit**, e cila futi normën e mbulimit të likuiditetit (angl. Liquidity Coverage Ratio), si një standard likuiditeti afatshkurtër që bankat e ndjekin dhe e respektojnë, duke filluar nga 1 janar 2021. Në hartimin e rregullativës së re janë ndjekur kërkesat e rregullativës evropiane për kërkesat kapitale të institucioneve kreditore dhe shoqërive investuese, duke përfshirë edhe ndryshimet e kësaj rregullative në maj 2019, si dhe aktet përkatëse të Komisionit Evropian. Krahas kësaj risie, rregullativa e re mundëson përmirësimin e mëtejshëm të mënyrës së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, kryesisht në fushën e monitorimit të rrezikut të likuiditetit duke monitoruar normën e mbulimit të likuiditetit në nivel agregat dhe sipas çdo monedhe të rëndësishme, duke vendosur dhe mbajtur një afatizues strukturor të përshtatshëm, përcjellja e burimeve të mjeteve dhe koncentrimi i tyre, përcjellja e mjeteve të disponueshme të pangarkuara dhe përcaktimi, përcjellja dhe ruajtja e treguesve të brendshëm të likuiditetit. U përpiluan raporte të reja të rrezikut të likuiditetit në pajtim me Vendimet e reja për menaxhim të rrezikut të likuiditetit. Gjithashtu, në lidhje me vendimet e marra për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, si dhe Vendimin për mënyrën e përcaktimit të palëve të lidhura dhe kufijtë e ekspozimit, u bë azhurimi i përgjigjeve të dhëna të pyetësorit të marrë nga EBA në lidhje me harmonizimin e rregullativës vendore me atë evropiane. Me ndryshim dhe plotësim të Vendimit për

⁸⁸ Direktiva për kërkesat kapitale - Capital Requirements Directive CRD dhe Direktiva për rimëkëmbje dhe ndërhyrje në banka – Bank Recovery and Resolution Directive.

⁸⁹ FSAP (anglisht.: FSAP – Financial sector assessment program).

⁹⁰ [Vendim për metodologjinë e menaxhimit me rrezikun kreditor, Vendim për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit, Vendim për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të regjistrimit kreditor, Udhëzues për zbatimin e këtij vendimit](#).

metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, sigurohet zbatimin më të përshtatshëm të dispozitave të rregullativave evropiane për kërkesat kapitale. Në vitin 2020, BPRMV ka punuar vazhdimisht në përmirësimin e efikasitetit të **analizës së sistemit bankar dhe stabilitetit financiar** në fushën e monitorimit të burimeve potenciale të **realizimit të rrezikut kreditor** në operacionet e bankave. Për këtë qëllim është paraparë të krijohet një databazë e të dhënave nga Regjistri Kreditor, i cili do të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe fleksibël të të gjitha të dhënave të futura në Regjistrin Kreditor.

Gjatë vitit, u kryen disa aktivitete për **përmirësimin e analizës së sistemit** në mbështetje të politikave makroprudenciale për ruajtjen e stabilitetit financiar. Kështu, u finalizuan aktivitetet për shqyrtimin dhe nënshkrimin e memorandumeve për shkëmbimin e të dhënave me rregullatorë të tjerë të institucioneve financiare, me qëllim rritjen e frekuencës së analizave për institucionet e tjera financiare⁹¹. Gjithashtu u futën edhe praktika e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta, ashtu që u realizuan disa takime me Ministrinë e Financave dhe Komisionin për Letrat në Vlerë. Në prill 2020, për të forcuar koordinimin për stabilitetin financiar, u lidh një Memorandum i ri [për bashkëpunim ndërinstytucional të rregullatorëve](#), në përputhje me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore. Me lidhjen e Memorandumit për bashkëpunim forcohet kapaciteti institucional dhe niveli i bashkëpunimit ndërmjet organeve të mbikëqyrjes financiare në monitorimin e situatës në sistemin financiar, identifikimin në kohë të rreziqeve sistematike dhe marrjen e masave dhe aktiviteteve të duhura për parandalimin dhe uljen e ndikimit të tyre në sistemin financiar, me çka në mënyrë plotësuese përforcohet qëndrueshmëria e sistemit financiar ndaj goditjeve. Gjithashtu, në përputhje me dispozitat e Memorandumit, rritet roli dhe zgjerohet përbërja e Komisionit të Stabilitetit Financiar⁹² (duke përfshirë të gjithë rregullatorët financiarë⁹³ dhe Fondin e Sigurimit të Depozitave), sipas shembullit të Bordit Evropian të Sistemit të Rrezikut. Për monitorimin e rrezikut sistematik është përcaktuar dhe përgatitur një listë e treguesve të paralajmërimit të hershëm dhe në kuadër të Twinning projekti⁹⁴ me Bankën Qendrore të Kroacisë është përgatitur një projekt-rregullorë për shitjen e arkëtimit.

Për monitorimin e lëvizjeve në sistemin bankar dhe financiar publikohen rregullisht të dhënat për sistemin bankar dhe janë përgatitur [raportet tremujore](#) mbi rreziqet në sistemin bankar. Për sa i përket stabilitetit financiar, u monitoruan indekset e stabilitetit financiar, ndërsa përmbajtja e Raportit të stabilitetit financiar [Raportit të stabilitetit financiar](#) u përmirësuar dhe u pasurua me shtojca të reja të cilat kanë të bëjnë me:

Anketa për vlerësimin e rrezikut financiar për stabilitetin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe [Anketa për perceptimet bankare për aktivitetet afariste dhe rreziqet operative](#) e cila realizohet një herë në vit, në fund të tremujorit të parë të vitit dhe pasqyron vlerësimet dhe pritshmëritë e bankave për periudhën e mëtejshme të vitit.

Dy projekte të rëndësishme në të cilët është punuar gjatë vitit 2020 janë: Projekti për [përgatitja e Strategjisë për aplikimin e teknologjiave financiare dhe Projekti për aktivitete për mbrojtjen e konsumatorëve](#). Me asistencë teknike dhe financiare nga EFSE, në kuadër të

⁹¹ Është përgatitur një analizë e lëvizjeve të shoqërive financiare, fondeve të pensioneve dhe shoqërive të sigurimit.

⁹² Në kuadër të Komitetit u krijuan dy nënkomisione, si organe operative - Nënkomiteti për monitorimin e rreziqeve sistematike dhe propozimin e masave makroprudenciale dhe Nënkomiteti për përgatitjen për menaxhimin e krizave financiare. Në vitin 2020, Komiteti i Stabilitetit Financiar ka mbajtur tri seanca, ndërsa nënkomitetet kanë mbajtur dy seanca të rregullta.

⁹³ Banka Popullore, Ministria e Financave, Komisioni i Letrave me Vlerë, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve Pensionale të financuara plotësisht dhe Fondi i Sigurimit të Depozitave.

⁹⁴ ["Forcimi i kapaciteteve institucionale të Bankës Popullore në rruqën drejt anëtarësimit të saj në SEBO"](#).

fazës së dytë të aktiviteteve lidhur me strategjinë, është realizuar një [anketë hulumtimi](#) Me asistencë teknike dhe financiare nga EFSE, në kuadër të fazës së dytë të aktiviteteve lidhur me strategjinë, është realizuar një [studim të arritshmërisë së zhvillimit të fintek-sektorit në vend](#), e cila do të shërbej si bazë e zhvillimit të fintek-strategjisë kombëtare për periudhën e ardhshme.

Sa i përket aktiviteteve për mbrojtjen e konsumatorëve, duhet theksuar se Propozim - Strategjia për edukim financiar dhe inkluzion financiar, e cila është në fazën përfundimtare të shqyrtimit, përfshin më shumë propozim masash për mbrojtjen e konsumatorëve. Janë bërë kontakte me disa shoqata nga sektori civil aktiv në këtë fushë dhe me njërin prej tyre është lidhur memorandum bashkëpunimi. Që nga mesi i vitit 2020, në Bankën Popullore është formuar një Grup punues, me përfaqësues të njëjësive të ndryshme organizative, të cilët realizuan takime të rregullta dhe në periudhën e ardhshme zhvilluan aktivitete për përmirësimin e informimit të klientëve të bankave dhe analiza e përvojës të vendeve të caktuara në këtë segment.

Gjatë vitit janë kryer rregullisht aktivitete mbikëqyrëse jashtë terrenit, përgatitja dhe monitorimi i masave korigjuese bazuar në mospërputhjet dhe parregullsitë e konstatuara në funksionimin e bankave dhe kursimoreve, mbajtja e takimeve të rregullta vjetore me shoqëri të auditimit të jashtëm dhe anëtarë të bordit drejtues dhe mbikëqyrës të bankave, vlerësimi PIK⁹⁵ i bankave, si dhe aktivitetet e licencimit të bankave, kursimoreve, këmbimoreve dhe ofruesve të shërbimeve të transfertave të shpejta të parave. Për përafrimin e mëtejshëm të praktikave mbikëqyrëse me udhëzimet e EBA dhe praktikat e BQE-së, gjatë vitit është punuar për përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë së brendshme për vlerësimin e modeleve të biznesit të bankave. Madje, pas testeve dhe analizave të bëra, u finalizua procesi i zhvillimit të një mjeti për analizën e qëndrueshmërisë së modeleve afatgjata të biznesit, i cili do të përdorej në vlerësimin vjetor të rrezikut mbikëqyrës për vitin 2021. Edhe këtë vit vazhduan aktivitetet për përmirësimin e procesit të përgjithshëm të vlerësimit të rrezikut dhe në këtë kontekst u punua në forcimin e kapaciteteve institucionale për vlerësimin e procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm nga bankat, aktivitet ky që u zhvillua në kornizë të Twinning projekti të mbështetur nga Bashkimi Evropian. Aktivitetet kontribuan në zhvillimin e një instrumenti mbikëqyrës për vlerësimin e këtij procesi, gjegjësisht Banka Popullore zhvilloi një metodologji të brendshme, e cila përmban parime, udhëzime që do të përpiqet për zbatimin e qëndrueshëm të qasjes në vlerësimin mbikëqyrës të këtij procesi, si dhe përmirësimin e kuadrin dhe menaxhimin e këtij procesi në banka. Për sa i përket aktiviteteve për monitorimin jashtë terrenit të lëvizjeve në bankat me rëndësi sistematike, një projekt i realizuar në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore është në fazën përfundimtare dhe i referohet të gjithë procesit të vlerësimit të planeve të rimëkëmbjes, e cila përfshinë edhe përgatitje të metodologjisë për vlerësimin e tyre.

⁹⁵ Procesi i përcaktimit të kapitalit të brendshëm të bankave.

Tabela 4

Kërkesat e shqyrtuara për pajtim paraprak të lëshuar në vitin 2020

Llojet e lejeve/pajtueshmërive (bankat)	lëshuara	refuzuara	ndërprera
Pajtueshmëri për përvetësimin e aksioneve në bankë	/	/	1
Pajtueshmëri për fillimin e kryerjes së aktivitetit financiar	3		/
Pajtueshmëri për ndryshim dhe plotësim të statutit	12	/	1
Pajtueshmëri për emërimin e anëtarit në bordin mbikëqyrës	44	/	4
Pajtueshmëri për emërimin e anëtarit në bordin drejtues	19	/	1
Pajtueshmëri për përfshirjen e fitimit në kapitalin bazë të rregullt	4	/	/
Llojet e lejeve/pajtueshmërive (kursimoreve)	lëshuara	refuzuara	ndërprera
Pajtueshmëri për emërimin e drejtorit	1	/	/
Gjithsej	83	0	7

Duke pasur parasysh situatën e krijuar të re në lidhje me rrezikun e përhapjes së Covid-19, gjatë vitit 2020 janë kryer **kontrolle të rregullta në terren** në respektim të të gjitha rekomandimeve të lëshuar për parandalimin e pasojave negative të pandemisë. Ashtu që, gjatë vitit 2020 janë kryer gjithsej 9 kontrolle në bankat afariste, si dhe dy kontrolle të ofertuesit e shërbimeve për transfere të shpejta të parave.

Gjatë vitit 2020 është përmirësuar metodologjia për vlerësimin e riskut gjatë kontrolleve në vend, përmes përmirësimit të procedurave të brendshme për vlerësimin e rrezikut të më të ndarë të bankave afariste, gjatë të cilës janë kryer dhe harmonizimit i tyre me ndryshimet më të reja në rregullativat ligjore dhe nënligjore, si dhe rregullat e BQE. Në kuadër të harmonizimit të praktikave mbikëqyrëse dhe duke ndjekur shembullin e BQE-së, si dhe të bankave të tjera qendrore të Bashkimit Evropian, është hartuar një metodologji për përcaktimin e nivelit agregat të rrezikut të IT (PSOR-IT - Procesi i vlerësimit të rrezikut mbikëqyrës) të bankat afariste. Metodologjia përmban udhëzime të përgjithshme për krijimin e praktikave efektive të vlerësimit mbikëqyrës, me theks në rrezikun e TI-së. Për përmbushjen e këtij qëllimi, pyetësorët iu dërguan bankave afariste dhe përmes analizës së përgjigjeve, u qas drejt krahasimit dhe përshtatjes së mjeteve e cila përdoret në procesin e vlerësimit mbikëqyrës të rreziqeve të TI-së.

Sa i përket aktiviteteve për forcimin e kornizës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në vitin 2020 përfundoi me sukses projekti për **përforcimin e kapaciteteve të institucioneve financiare jobankare**, i realizuar me mbështetjen e Programit Global për Luftimin e Financave Rrjedhëse Ilegale pranë Shoqërisë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ). Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar trajnime për ofruesit e shërbimit të transfertave të shpejta të parave dhe nënagjentët e tyre si dhe për këmbimoret e autorizuara. Një pjesë e veçantë e trajnimeve iu kushtua rezultateve të **Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut, si dhe ndryshimeve në Ligjin për PSHPFT** që do të pasojnë si rezultat i harmonizimit të këtij ligji me Direktivën e Pestë të Bashkimit Evropian për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimi i Terrorizmit PSHPFT. Qëllimi i trajnimeve të tilla është rritja e ndërgjegjësimit dhe kapacitetit të ofruesve të shërbimeve të transfertave të shpejta të parave dhe nënagjentëve të tyre dhe këmbimoreve të autorizuara për të zbatuar detyrimet e tyre në këtë segment të punës.

Qëllimi strategjik 3 - Ruajtja dhe menaxhimi i rezervave valutore në përputhje me parimet e sigurisë dhe likuiditetit dhe sigurimi i kthimit optimal

Për shkak të rritjes së luhatshmërisë së lëvizjeve në tregjet financiare ndërkombëtare **në përputhje me kushtet e ndryshuara të tregut**, rezultoi deri në **menaxhim aktiv të portofolit me rezervat valutore**, si dhe monitorim të vazhdueshëm aktiv dhe **reagim me kohë të Bankës Popullore për zbutjen e pasojave të rreziqeve që rezultojnë nga zhvillimet e ndryshuara të tregut dhe pasojat e krizës shëndetësore në sektorin bankar në ekonomitë e zhvilluara**. Për këtë qëllim, u përgatit analiza për vlerësimin e vëllimit të mbështetjes fiskale dhe ndikimi i masave fiskale në vendet ku investohen rezervat valutore, perspektivën për periudhën në vijim dhe sigurinë e sistemit bankar në kushtet e jashtëzakonshme monetare, fiskale dhe lehtësime rregullatore. Si rezultat i analizës, janë rinovuar plasmanet në bankat afariste. Gjithashtu, janë bërë analiza e pasojave të mundshme të Bregzimit mbi menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore, të cilat kanë qenë bazë për vendimet e ardhshme për investime në lidhje me plasmanin e rezervave valutore. Në kuadër të procesit të investimit të rezervave valutore dhe për të përfituar nga mundësitë e favorshme investuese, **u futën dhe u aplikuan aktivisht instrumente të reja financiare** (repo-transaksione me valuta të kryqëzuara dhe svop-transaksione me ar dhe jen japonez).

Qëllimi strategjik 4 - Rritja e efikasitetit të sistemit të furnizimit dhe përpunimit të kartëmonedhave dhe monedhave dhe rritja e cilësisë dhe funksionalitetit të parave të gatshme në qarkullim ⁹⁶

Gjatë vitit 2020, Banka Popullore, si **institucioni i vetëm përgjegjës për furnizimin e bankave dhe qendrave të parave të gatshme me kartëmonedha dhe monedha, vazhdoi me kryerjen e rregullt të aktiviteteve**. Madje, për shkak të kushteve specifike të punës të shkaktuara nga kriza shëndetësore, është marrë parasysh efikasiteti i sistemit të krijuar të furnizimit me para të gatshme, si dhe ndërmarrja në kohë të masave përkatëse. Në pajtim me masat për ballafaqim me pandeminë, **kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kriterëve për operacionet me para të gatshme** në banka dhe qendra për para të gatshme është i kufizuar në kontrole indirekte, derisa të krijohen kushte të plota sigurie për kryerjen e këtyre aktiviteteve përmes kontrolleve të drejtpërdrejta në terren. Sa i përket projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e zgjidhjeve softuerike që mundësojnë zbatim më efikas të proceseve, aktivitetet zhvillohen me dinamikën e parashikuar⁹⁷. Në kornizë të aktiviteteve të rregullta, Banka Popullore e monitori kërkesën e parave efektive të huaja për nevojat e Bankës Popullore, institucioneve shtetërore dhe organet e administratës dhe në kohë intervenojë për përmbushjen e nevojave përkatëse.

Për shkak të masave për mbrojtje nga pandemia, janë prolonguar aktivitetet për zbatimin e platformës së standardizuar për trajnimin e stafit të bankave dhe qendrave për para të gatshme për kontrollin e vërtetësisë dhe përshtatshmërisë së parave në qarkullim, si dhe për realizimin e planin nacional për trajnim, në pajtim me rekomandimet nga Twinning projekti „Forcimi i kapacitetit të sistemit për luftën kundër falsifikimit të euros”. Këto aktivitete do të vazhdojnë kur të krijohen kushtet për mbajtjen e trajnimeve të tilla me praninë e më shumë pjesëmarrësve.

⁹⁶ Në mënyrë më të detajuar në kapitullin VIII. Lëshimi dhe menaxhimi me katërmonedhat dhe monedhat në Republikën e Maqedonisë së Veriut – operacionet e thesarit.

⁹⁷ Ka përfunduar projekti për pasurimin e funksionaliteteve të sistemit të aplikimit për punë në para të gatshme. Me zgjidhjen e prezantuar të projektit, mundësohet shkarkimi i të dhënave për makineritë e përpunimit të parave nga periudha e mëparshme dhe korigjimi i tyre nëse është e nevojshme. Gjithashtu, janë mundësuar edhe format të reja të raportimit me kërkesë të klientëve dhe rishikimet në nivele të ndryshme qasjes.

Qëllimi strategjik 5 - Funkcionimi i sigurt dhe efikas i sistemeve të pagesave dhe zhvillimi i tregut të shërbimeve të pagesave

Edhe në kushtet e pandemisë, Banka Popullore ka kryer me sukses rolin operativ , , me çka siguroi **funkcionim të sigurt dhe të pandërprerë të sistemeve pagesore në vend**, përpunimin dhe shlyerjen e transaksioneve që lidhen me zbatimin e politikës monetare dhe menaxhimin e rezervave valutore dhe realizimin e qarkullimit pagesor me vendet e jashtme për organet shtetërore. Me këtë qasje dhe masat mbrojtëse të ndërmarra për rezistencës e hapësirës digjitale, Banka Popullore ka zbatuar praktikrat më të mira karakteristike të bankave qendrore moderne.

Nga aspekti i rolit mbikëqyrës **të sistemeve pagesore, , operatorët e sistemeve pagesore edhe në kushte të jashtëzakonshme në mënyrë të pandërprerë kryeni operacionet e tyre**. Kjo për shkak të procedurave të përcaktuara dhe të testuara më parë për sigurimin e funksionimit të pandërprerë, në përputhje me standardet për funksionimin e tyre nga Banka Popullore. Gjithashtu u monitorua funksionimi i sistemeve pagesore në kushte krize. Me këtë aktivitet do të vazhdohet edhe në periudhën e ardhshme, deri në stabilizimin e situatës lidhur me krizën shëndetësore Covid-19.

Në kuadër të rolit të tyre **zhvillimor dhe katalitik në fushën e sistemeve pagesore**, Banka Popullore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave u angazhua në mënyrë aktive në kompletimin e Propozim - ligjit për shërbime pagesore dhe sistemeve të pagesave, ashtu që vazhdoi procesi i konsultimit me sektorin bankar dhe palët e prekura të tjera dhe institucionet shtetërore. Për përforcimin e kapacitetet për këtë qëllim strategjik, Banka Popullore ka realizuar një numër të madh të e-trajnimeve në bashkëpunim me bankat qendrore të shteteve anëtare të BE-së (Belgjika, Rumania, Portugalia, Sllovakia, Gjermania, [Lituania](#), [Kroacia](#)) në kuadër të **Twining projekti të BE-së** , të cilat janë mbështetje në përgatitjen e rregullave nënligjore për zbatimin e Ligjit i cili pritet të hyjë ofrues të rinj të shërbimeve të pagesave, ndërsa paragjithash nga fintek-sektori, si dhe inkurajimi i transformimit digjital të ofruesve ekzistues të shërbimeve të pagesave.

Qëllimi strategjik 6 - Mbështetja e zhvillimit të tregjeve financiare të vendit

Përkrahje e zhvillimit të tregut financiar vendor realizohet përmes më shumë aktivitete, edhe atë: përcjellja e rregullt e tregtimit ndërbankar me depozita, tregtimi me mjete valutore, si dhe tregu sekondar të letrave në vlerë, si dhe shpallja e të dhënave dhe informacioneve për zhvillimet e tregut financiar në tregun valutor në faqen zyrtare të internetit. Duke pasur parasysh ndryshimet e vazhdueshme në trendin e tregut valutor, analizat e rregullta ishin të plotësuara me rishikimet të detajuara të zhvillimeve të këmbimoreve dhe personave fizik, si dhe ndjekja e pozitës së valutave në banka në kontekst të nevojës për intervenim në tregun valutor. Andaj në mënyrë plotësuese është përforcuar bashkëpunimi me bankat afariste në fushën e komunikimit në kohë, ditore për bazën e transaksioneve më të mëdha për blerje dhe/ose shitjen e valutave për të gjitha llojet e klientëve. Në vazhdimësi ka vijuar dhe bashkëpunimi profesional me ACI Maqedoni – Shoqata e tregut financiar, ndërsa në nëntor 2020, Banka Popullore mori pjesë aktive në Kuvendin vjetor të kësaj shoqate.

Qëllimi strategjik 7 - Nxitja dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i veprimtarisë hulumtuese në fushat që janë vendimtare për arritjen efikase të qëllimeve të Bankës Popullore

Veprimtaria hulumtuese në fushën e politikës monetare, stabilitetit financiar dhe rregullimit të kujdesshëm janë thelbësore për arritjen efektive të objektivave të Bankës Popullore. Prandaj, një nga njëmbëdhjetë qëllimeve strategjike i kushtohet nxitjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të veprimtarisë hulumtuese. Me këtë, Banka Popullore numërohet mes bankave qendrore të cilat në vazhdimësi investojnë në veprimtarinë hulumtuese dhe përforcimi i vazhdueshëm i infrastrukturës analitike në pajtim me trendet moderne. Hulumtimi dhe analiza janë bazë për marrjen e shumë vendimeve nga puna e përditshme e Bankës Popullore dhe janë një kontribut pragmatik në formulimin e duhur të politikës monetare dhe forcimin e stabilitetit financiar dhe funksionit mbikëqyrës të bankës qendrore. Andaj janë realizuar më shumë aktivitete. Ashtu që, u përfunduan materialet e punës në lidhje me hulumtimet mbi matjen e efekteve të politikës monetare përmes përdorimit të qasjes së FAVAR⁹⁸, analiza e efekteve të politikës monetare mbi normën e inflacionit specifik për grupe të ndryshme të të ardhurave familjare, vlerësimi i baraspeshës së normës së interesit, hulumtimi i efikasitetit dhe efektiviteti monetar kundrejt transmisionit makroprudencial dhe vlerësimi i nivelit optimal të euroizimit dhe përcaktuesve të euroizimit në ekonominë tonë. U shqyrtuan efektet e tregtisë së shërbimeve në rritjen ekonomike, ndikimi i flukseve të kapitalit në investimet e brendshme në vendet e përzgjedhura në tranzicion, si dhe efektet e rritjes së pagës minimale mbi realizimet e firmave. Gjithashtu, u bë analiza e sfidave për politikën monetare në vendet e zhvilluara, për pozicionin e investimeve ndërkombëtare të vendeve të rajonit, me vëmendje të veçantë për ekonominë e Maqedonisë, si dhe analiza të tjera të nevojshme në procesin e sjelljes së vendimeve.

Në kuadër të Twinning projektit „Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore në rrugën drejt anëtarësimit të saj në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore”, u punua në hulumtimin e lidhjes ndërmjet cikleve reale dhe financiare në ekonominë e Maqedonisë, përmes aplikimit të modelit dinamik stokastik i ekuilibrit të përgjithshëm (modeli DSGE) me euroizim të pjesshëm⁹⁹. Hulumtimi i bazuar në këtë model është i rëndësishëm për politikëbërësit sepse ofron një analizë gjithëpërfshirëse të ciklit ekonomik në vendin tonë në 15 vitet e fundit. Njëherit, është i pari i këtij lloji, i cili do të jetë një referencë e rëndësishme për hulumtime dhe analiza të mëtejshme të ndikimit të zhvillimeve në sektorin financiar mbi ekonominë. Me qëllim të forcimit të transparencës së Bankës Popullore, në përgatitje është edhe analiza e nivelit të kuptueshmërisë së komunikimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut me publikun. Krahas këtyre, janë në përgatitje e sipër edhe disa materiale të tjera pune në fushën e makroekonomisë¹⁰⁰.

Në aktivitetet hulumtuese për përgatitjen e punimeve analitike për nevojat e **stabilitetit financiar**, është përgatitur një punim i shkurtër për tregun e pasurive të patundshme, por aktiviteti do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm. Gjithashtu janë përgatitur edhe dy anketa: Anketa e kapaciteteve të reja prodhuese dhe Anketa e angazhimit të anëtarëve të bordeve mbikëqyrës të bankave. U përgatit edhe analiza e kursimeve në kushte të normës së ulët të interesit, si dhe analizë të edukimit financiar dhe inkluzionit financiar.

⁹⁸ FAVAR model - Factor-augmented vector autoregressive (FAVAR) model.

⁹⁹ Punimi titullohet "Modeli dinamik stokastik i ekuilibrit të përgjithshëm (modeli DSGE) me euroizim të pjesshëm: rasti i ekonomisë së Maqedonisë". Është prezantuar në <https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-izvestuvane-za-38-sesija-na-klubot-na-istrazuvacite.nsp> Sesioni i 38-të i Klubit të Hulumtuesve _172 .

¹⁰⁰ Indikacione nga Anketa mbi aktivitetin kreditor për kapitalin e tepërt për vendet e EMU dhe krahasimi me vendet e Ballkanit Perëndimor; Analiza e komponentit të ndërlidhjes dhe importit të sektorëve kryesorë ekonomikë në ekonominë e Maqedonisë përmes përdorimit të tabelave me komponentë hyrëse dhe dalëse; Matja e hendekut të kredisë duke përdorur filtrin shumëvariak të Hodrikut dhe Preskötit; A mund të shpjegohet inflacioni i ulët i CESEE me plakjen e fuqisë punëtore; Efektet e politikës monetare nëpërmjet VAR me parametra të ndryshueshëm gjatë kohës.

Fusha e "financat e gjelbërta" paraqet një fushën e hulumtimit e cila po bëhet gjithnjë më e rëndësishme dhe lidhet me rolin dhe vizionin strategjik të Bankës Popullore, si një institucion i përgjegjshëm shoqëror, duke pasur parasysh rëndësinë dhe aktualitetin e rritjes së gjelbër dhe të qëndrueshme në mbarë botën. Kjo do të jetë veçori edhe të pjesë të hulumtimeve të cilat në periudhën e ardhshme do të përgatiten në Bankën Popullore.

Banka Popullore vazhdoi me promovimin e aktiviteteve hulumtuese edhe përmes organizimit të **Klubit të hulumtueseve**¹⁰¹, ku prezantohen materialet dhe hulumtimet e punës për rrjedhat kapitale edhe investimet e vendit, analizë të kreditove të bankave, si dhe tema të ndërlidhura me tregun e punës. Gjithashtu, për nxitjen e zhvillimit të mendimit shkencor në ved, si dhe për shkak të afirmimit të kuadrove të reja profesionale, katërmëdhjetë vite me radhë shënohet përvjetori i themelimit monetar në vend, Banka Popullore **ndan Shpërblimin vjetor për hulumtuesit e ri**, Punimi i shpërblyer u prezantua në **Sesionin e 36 të Klubit të hulumtuesve**.

Qëllimi strategjik 8 - Sigurimi i të dhënave kualitative statistikore, në përputhje të plotë me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane, duke marrë parasysh peshën e raportimit dhe përhapjen e tyre efikase, në kohë dhe të lehtë për përdoruesit

Gjatë vitit 2020 janë mbledhur, përgatitur dhe publikuar vazhdimisht të dhëna statistikore në fushën e statistikave monetare dhe të jashtme. Njëkohësisht, gjatë vitit është punuar më tej në zhvillim dhe ngritje të mëtejshme në segmente të caktuara, lidhur me shpërndarjen e të dhënave statistikore dhe përmirësimin metodologjik të tyre. Është veçanërisht i rëndësishëm fakti se **tronditja negative për shkak të pandemisë Covid-19 nuk ka ndikuar në cilësinë dhe vazhdimësinë e procesit të përgatitjes, e me këtë edhe në shpërndarjen e të dhënave statistikore të Bankës Popullore**. Rrjedhimisht, të dhënat u publikuan në përputhje me Kalendarin e Publikimit të të Dhënave, pa vonesa kohore, ndërsa shtrirja dhe cilësia e burimeve dhe e prodhimit të të dhënave mbetën të pandryshuara, krahasuar me periudhën para pandemisë.

Edhe përkundër rrethanave specifike, Banka Popullore e pasuroi portofolin me publikimin e të dhënave për statistikën e llogarive financiare dhe ka realizuar më shumë aktivitete për përmirësimin e mëtejshëm të komunikimit me përdoruesit e të dhënave statistikore, gjë që çon drejt plotësimit të kërkesave më të larta statistikore dhe zbatim të parimeve dhe rregullave ndërkombëtare të statistikës. Aktivitetet më të rëndësishme të cilat e shënuan vitin 2020 në fushën e statistikave janë:

- **Në dhjetor 2020, për herë të parë u publikuan të dhënat për llogaritë vjetore financiare të ekonomisë së Maqedonisë**. Statistikat e llogarive financiare, si një statistikë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe në të njëjtën kohë një nga statistikën më komplekse, është një mjet analitik i rëndësishëm dhe burim i rëndësishëm i informacionit për shqyrtimin e ecurisë financiare në sektorët të ekonomisë nacionale dhe kanaleve kryesore për fitim dhe investim të mjeteve financiare në ekonominë nacionale. Në ueb-faqen e Bankës Popullore, të dhënat për llogaritë financiare, bilancet janë publikuar në tabela të standardizuara raportuese (seritë kohore për periudhën 2013-2019), në baza jo të konsoliduara. Në të njëjtën kohë, u publikuan shpjegime dhe prezantime metodologjike, të cilat përmbanin informacion më të detajuar për përcaktimin dhe klasifikimin e sektorëve institucionalë dhe instrumenteve financiare, si dhe burimet e të dhënave dhe metodat e përdorura në përgatitjen e llogarive financiare.

¹⁰¹ Klubi i hulumtuesve për shkak të pandemisë kishte ndërprerje, pastaj filloi të mbahet në mënyrë virtuale.

- **Harmonizimi i mëtejshëm i statistikave të investimeve direkte me kërkesat e BE-së**, përmes dorëzimit të raporteve të reja statistikore deri tek Eurostat-i, në pajtim me strukturën paraprake të definuar të të dhënave. Përmirësimi është arritur në raportet për të ardhurat nga investimet direkte, ku të dhënat paraqiten sipas vendeve dhe veprimtarive, si dhe në raportet për investimet direkte – bilancet dhe lëvizjet, sipas zonave ekonomike dhe gjeografike.

Në fushën e **statistikave të llogarive financiare**, në kuadër të Twinning projektit të Bankës Popullore, komponenti 3 "Harmonizimi i mëtejshëm i statistikave të llogarive financiare në Bankën Popullore me standardet e BQE", janë kryer tre misione teknike me ekspertë të bankave qendrore të Kroacisë dhe Rumanisë, me fokus kryesor në llogaritë financiare tremujore dhe flukset vjetore, si dhe zhvillimin e një sistemi të ri softuerësh për përgatitjen e llogarive financiare në BPRMV.

Në fushën e **statistikave të jashtme**, nga tetori 2020, u fillua me publikimin e rregullt të pasqyrave më të detajuara të reja për gjendjen e investimeve të rezidentëve në letra me vlerë të huaj. Pasqyrat e reja janë një pamje tërthore e të dhënave të investimeve të portofolit sipas sektorit institucional dhe vendit të lëshuesit të letrës së huaj me vlerë, si dhe sipas sektorit institucional i investitorit vendas dhe sektori institucional i lëshuesit të letrës së huaj në vlerë, për një grup të caktuar vendesh. Me prezantimin tërthor të të dhënave të shënime të caktuara, në mënyrë të dukshme u rrit vlera analitike e publikimit të të dhënave për mjetet portofolit investues. Njëherit, pasqyrat e reja u dorëzuan edhe deri te Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në kuadër të hulumtimit të portfolios investime (KPPI¹⁰²), si pjesë e standardit statistikor SDDS plus. Sipas KPPI, Banka Popullore, mori pjesë gjithashtu në pilot-projektin e FMN-së për shkëmbimin e parë vjetor të informacionit sektorial mbi lëshuesit e letrave me vlerë.

Për të krijuar një sistem efikas njoftimit për nevojat e statistikave të jashtme, gjatë vitit 2020 është punuar në disa **projekte për racionalizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave** (për punët e kredive me vendet e jashtme dhe investimet e direkte) përmes futjes së raportim elektronik, si dhe rritje të shkallës së automatizimit të proceseve të punës (për raportim tremujor për investimet të huaja).

Në fushën e **statistikave monetare**, në kuadër të projektit afatgjatë për ngritjen e një sistemi të integruar raportues për nevojat e statistikave dhe mbikëqyrjes ISIDORA, janë ndërmarrë disa aktivitete, të lidhura kryesisht me përmirësimin e zgjidhjes konceptuale për përdorimin e të dhënave nga regjistri i kredive për nevojat e statistikave dhe përmirësimin e saj në të ardhmen për nevojat raportuese të Bankës Popullore në tërësi.

Gjatë vitit ka vazhduar bashkëpunimi ndërinstitucional i Bankës Popullore, Ministrisë së Financave (MF) dhe Entit Shtetëror të Statistikave (ESSH) në fushën e statistikave të llogarive financiare, statistikave fiskale për borxhin dhe deficitin e tepërt, si dhe në projekte të përbashkëta të ndihmës teknike për zhvillimin e mëtejshëm të fushave të shumta statistikore. Pjesëmarrja e Bankës Popullore në Projektin e statistikave qeveritare të FMN-së me MF-së dhe ESHS-në është veçanërisht e rëndësishme, si dhe pjesëmarrja në projektin IPA 2017 të ESSH për statistikën e tregtisë së jashtme me shërbimet, synimi kryesor i të cilës është zëvendësimi i burimit ekzistues të të dhënave për eksportin dhe importin e shërbimeve dhe vendosja e raportimeve të drejtpërdrejta.

¹⁰² Pyetësori i koordinuar për portfolion e investimeve - CPIS, Coordinated Portfolio Investment Survey, IMF

Gjatë vitit 2020 janë mbajtur **ngjarje për forcimin e transparencës dhe përmirësimin e komunikimit me publikun, si dhe për përmirësimin e bashkëpunimit me bankat qendrore në rajon:**

- Në kuadër të projektit për përmirësimin e disponueshmërisë dhe kuptimit të njoftimeve, informacioneve, të dhënave dhe analizave të Bankës Popullore, u mbajt [e-punëtorja e parë për gazetarë](#), kushtuar të dhënave dhe raportimet për lëvizjet e rëndësishme tek institucionet tjera financiare (ITF);
- Me iniciativë dhe organizim të Bankës Popullore, u mbajt [punëtorja virtuale rajonale statistikore](#), kushtuar sfidave statistikore të imponuara nga pandemia Covid-19. Në punëtori, statisticienët nga bankat qendrore të rajonit shkëmbyen përvojat dhe praktikat e deritanishme dhe ofruan zgjidhje për tejkalimin e sfidave që lindin nga kriza e koronës.

Qëllimi strategjik 9 - Përgatitja e Bankës Popullore për qasje dhe anëtarësim në SEBQ

Në vitet e mëparshme, pavarësisht të pandemisë Covid-19, aktivitetet lidhur me përcaktimin strategjik të Bankës Popullore për adaptimin e praktikave më të mira evropiane ka vijuar në mënyrë të pandërprerë. Vazhduan aktivitetet e rregullta në lidhje me organizimin dhe koordinimin e pjesëmarrjes së Bankës Popullore në përgatitjen e Programit Nacional për Miratimin e të Drejtës së BE (NPAA), Programit të Reformës Ekonomike (ERP), si dhe në zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociacim (MSA) përmes pjesëmarrjes në dy nënkomitetet. Gjithashtu, Banka Popullore ka ndjekur edhe në konstatimet dhe rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vendi ynë pati [rezultatet më të mira në rajon](#) në lidhje me rekomandimet e Komisionit Evropian nga Programi i Reformës Ekonomike, për periudhën nga maji 2019 deri në janar 2020, të cilat i referoheshin masave të reformës në përforcimin e stabilitetit financiar dhe krijimit të vendeve të punës.

Përveç aktiviteve të rregullta, zhvillohen edhe aktivitetet projektuese. Në kuadër të Twinning projekti „Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore në rrugën drejt anëtarësimit në SEBQ”, i cili filloi në tremujorin e fundit të vitit 2019, pas një pauze prej tre muajsh (prill-qershor) për shkak të fillimit të pandemisë, aktivitetet në mënyrë të suksesshme janë zhvilluar pandërprerë përmes formës virtuale. Gjatë vitit janë mbajtur pesë mbledhje të komitetit drejtues të Twinning projektit dhe janë përgatitur dhe publikuar 3 botime të buletinit të rregullt tremujor për projektin, përmes të cilave monitorohet realizimi i aktiviteve të parashikuara¹⁰³. Projekti u rumbullaksua më 11 mars 2021, ashtu që në [konferencën përfundimtare të projektit](#), në mënyrë të hollësishme u prezantuan arritjet e arritura në kuadër të katër komponentëve të projektit - shërbimet pagesore dhe sistemet e pagesave, rregullativa bankare dhe mbikëqyrjet, statistika e llogarive financiare dhe analiza e politikave.

Edhe në kuadër të Programit Rajonal për Bankat Qendrore të Ballkanit Perëndimor, aktivitet u realizuan përmes mënyrës virtuale. Në kuadër të këtij programi u mbajt takim përgatitor për zbatimin e masës dypalëshe me Bankën Qendrore të Kroacisë, e orientuar drejt përforcimit të funksionit të marrëdhënieve ndërkombëtare në Bankën Popullore. Për shkak të pandemisë Covid-19, kohëzgjatja e programit është vazhduar edhe për nëntë muaj, përkatësisht parashihet që programi të përfundojë në dhjetor 2021.

¹⁰³ Buletinet mund të merren në faqen e interentit të Bankës Popullore: [Македонски - Билтени за проекти \(nbrm.mk\)](#)

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Statistikor të financuar nga Programi Shumëpërdorues IPA 2017, gjatë vitit 2020, përfaqësues të Bankës Popullore në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Statistikave dhe EUROSTAT-in kanë marrë pjesë në projekte në fushën e statistikave. Nëpërmjet instrumentit të ndihmës teknike afatshkurtër TAIEX, në vitin 2020 virtualisht u realizua një mision ekspertësh, në fushën e funksionit të përputhshmërisë.

Gjatë pandemisë, bashkëpunimi teknik dypalësh i Bankës Popullore me bankat e tjera qendrore ka vijuar në volum më të zvogëluar. Megjithatë, tre projekte u zbatuan me Bankën Qendrore të Turqisë, si dhe nga një projekt me bankat qendrore të Holandës dhe Gjermanisë përmes videokonferencës, ndërsa me bankat qendrore të Belgjikës dhe Polonisë u zbatuan projekte për shkëmbimin e mendimeve dhe njohurive përmes korrespondencës elektronike.

Qëllimi strategjik 10 - Përmirësimi i mëtejshëm i menaxhimit të korporatës, transparenca dhe përgjegjësia sociale e institucionit

Realizimi i aktiviteteve programore të ndërlidhura me përmirësimin e menaxhimit korporativ, transparenca dhe përgjegjësia sociale përfshinë shumë aspekte të punës së Bankës Popullore¹⁰⁴.

11.1. Marrëdhëniet me publikun, bashkëpunimin me institucionet vendore dhe huaja, punë botuese

Në vitin 2020, vazhduan aktivitetet e Bankës Popullore për rritjen e **transparencën dhe të përmirësimit të komunikimit me publikun** (media, gazetarët, komuniteti i biznesit, qytetarët, publiku i gjerë dhe profesional, organizatat përkatëse ndërkombëtare). Aktivitetet në fushën e komunikimit me publikun u intensifikuan më tej pas fillimit të krizës së koronës, për shkak të përpjekjeve të Bankës Popullore që përmes më shumë kanaleve të komunikimit¹⁰⁵ të informojë publikun në kohë për mënyrën dhe masat e ndërmarra nga banka qendrore për ballafaqim me pandeminë e covid-19, ndërsa janë në fushën e punës së saj. Madje, Banka Popullore përballoi me sukses sfidën dhe të gjitha aktivitetet rreth komunikimit me publikun i përshtati me kushtet e reja të krijuara. Gjatë gjithë kohës komunikimi ka vijuar pandërprerë dhe me intensitet dhe volum të shtuar, duke pasur parasysh rëndësinë e komunikimit transparent të bankës qendrore me publikun në kushtet e krizës shëndetësore dhe ekonomike.

Krahas aktiviteteve të rregullta të planifikuara, në fushën e marrëdhënieve me publikun, Banka Popullore ka realizuar një sërë aktiviteteve projektuese që synojnë përafrimin dhe kuptimin më të mirë të rolit, funksionit dhe politikave të zbatuara nga banka qendrore. Andaj, Banka Popullore futi një praktikë të re të organizimit të punëtorive tematike për gazetarët nga redaksitë ekonomike. Për shkak të pandemisë Covid-19, ky aktivitet u realizua përmes një serie të e-punëtorive në të cilat u përpunonin temat aktuale të cilat dilnin nga puna e bankës qendrore. E para nga seritë e-punëtoritë iu kushtua statistikave të institucioneve të tjera financiare (ITF).

¹⁰⁴ Aktivitetet të ndërlidhura me auditimin e brendshëm dhe resurset njerëzore janë pjesë e kësaj qëllimi strategjik në pjesën IX dhe X të Raportit vjetor të BPRMV.

¹⁰⁵ Lajmërime, deklaratat, fjalime, materiale edukative, duke përfshirë edhe përmes postimeve të rregullta në faqen e internetit dhe faqet e saja në rrjetet sociale.


11.2. Edukim dhe inkluzion financiar

Banka Popullore, si institucion me përgjegjësi shoqërore, ka vazhduar të investojë në edukimin financiar të popullatës edhe në vitin 2020. Investimi në edukimin financiar është gjithashtu një investim në arritjen e një prej objektivave ligjore - ruajtjen e stabilitetit financiar. Andaj u realizuan projekte për popullatën e rritur, përkatësisht u vazhduar me tekstet edukative nga seria “Ekonomia për secilin”, ndërsa u botuan edhe videomateriale të reja [nga seria e videomaterialeve të animuara “Me Bankën Popullore në botën e financave”](#) e cila është e përpiluar me përkrahje të Fondit Evropian për Evropën Juglindore (FEEJ). Videomaterialet e reja i referoheshin kryesisht përdorimit të kartave pagesore dhe mënyrave të tjera moderne të pagesës, si dhe përdorimi dhe mbrojtja nga rreziqet gjatë bankimit elektronik, gjë që kontribuoi në informimin më të madh të popullatës në rritjen e orientimit për përdorimin e këtyre shërbimeve, në kushte e pandemisë dhe nevojës për mbrojtjen e shëndetit.

Në lidhje me ngjarjet ndërlidhura me edukimin financiar, prezantimet klasike edukative për nxënësit e shkollave fillore me vizitë fizike në Bankën Popullore për shkak të krizës së koronës u zëvendësuan me prezantime virtuale. Në periudhën shkurt-qershor 2020 ishin të zhvilluara aktivitete për [“Kuizi evropian të parave”](#), mes të cilave u mbajt një mbledhje pune me mësuesit dhe profesorët për përgatitjen e këtij kuizi. Në muajin tetor, me rastin e Ditës Botërore të Kursimit u organizua konkursi tradicional për punimet e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, i cili edhe këtë vit hasi në interes të madh të popullata e re. Në kuadër të “Ditës së Edukimit Financiar”, në muajin nëntor u realizuan tre prezantime virtuale – për politikën monetare, stabilitetin financiar dhe sistemet e pagesave dhe shërbimet pagesore, të cilat u ndoqën nga një numër i madh i qytetarëve që aplikuan në thirrjen publike. Në nëntor, u mbajt edhe trajnimi i parë për trajnuesit të cilët do të angazhohen rreth edukimit të popullatës, me çka pritet të rritet rrjeti i edukimit financiar dhe përfundim të efekteve nga përhapje e njohurive të kësaj fushe. Ky aktivitet realizohet në bashkëpunim me sektorin qytetarë, duke pasur parasysh se bashkëpunimi në mes rregullatorëve financiar dhe organizatave qytetare janë të domosdoshme për arritjen e rezultateve më të dukshme.

Në kuadër të ndihmës teknike të Ministrisë së Financave të Holandës dhe Rrjetit Ndërkombëtar të Edukimit Financiar të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (INFE-OECD), [u shpallën rezultatet nga matja në vitin 2019 për nivelin të edukimit financiar të popullsisë së rritur në rajonin e Evropës Juglindore](#).

Grafikoni 95
Treguesit për edukimin financiar sipas komponentëve
Në kllapa është treguar vlerësimi i përgjithshëm të nivelit të edukimit financiar



Burimi: OECD.

Popullata në Maqedoninë e Veriut edhe në vitin 2018 dhe 2019 arriti 56% të maksimumit (treguesit agregatë 11,8 prej të cilave në vitin 2019, 3,9 për njohuritë financiare, 5,1 për sjelljen financiare dhe 2,8 për qëndrimet financiare). Këto rezultate janë rreth mesatares së nivelit të Evropës Juglindore (treguesit agregatë 12), përkatësisht 57% të maksimumit, e cila është më e ulët nga rezultatet e arritura në vendet e BE dhe OECD (përkatësisht 64% dhe 65%). Rezultatet e theksojnë nevojën e përpjekjeve të mëtejshme në këtë fushë, e cila do të shndërrohej edhe në masa konkrete në kornizë të Strategjisë nacionale për edukim financiar dhe inkluzion financiar e cila është në fazë përfundimtare.

11.3. Aktivitet e muzeut, bibliotekës dhe arkivit

Gjatë vitit 2020 u sigurua qasje deri te baza elektronike e të dhënave, revistave dhe gazetave për nevojat e të punësuarve për shkak të informimit të tyre dhe realizimit të detyrave të punës. Fondi i bibliotekës së Bankës Popullore rregullisht është pasuruar me tituj të ri për të cilat të punësuarit janë informuar përmes botimit të Buletinit. Gjatë vitit 2020 u përpunua materiali arkiv i mbledhur nga hulumtimet e kaluara për shkak se nuk kishte mundësi objektive për bashkëpunim me bartësit e materialeve arkivore. Me këtë u plotësuan të dhënat për fondet e krijuara në aplikacionit Arkivi historik digjital. Bashkëpunimi me bartësit e materialeve arkivore, si dhe aktivitet të ndërlidhura me përmbledhjen numizmatike dhe edukimit muzeik do të vazhdojë pas normalizimit të kushteve.

11.4. Strategjia dhe preventiva

Zyra për Strategji dhe Preventivë, si njësi e veçantë organizative e pavarur në Bankën Popullore për **linja e dytë e mbrojtjes**, gjatë vitit 2020 dhe në rrethana të jashtëzakonshme ka vazhduar të kryejë funksionet e saj të planifikimit strategjik, menaxhimit të rrezikut operativ, sigurimi i pandërprerë të punës, siguri të sistemit të informacionit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacione të klasifikuar, si dhe kontroll të përputhshmërisë së punës. Që nga fillimi i krizës globale të korona-virusit, **Banka Popullore ndërmoi aktivitet konkrete për mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve të saj, duke përfshirë edhe të bashkësisë, si dhe masa për lehtësimin e rrezikut nga ndërprerja e proceseve të punës për shkak të humbjes së personelit kyç.** Për këtë qëllim u aktivizua **Plani për vazhdimësi të punës (PVP)** të Bankës Popullore me disa përshtatje të caktuara. Në fakt, u sigurua funksionimi i plotë i të gjitha proceseve të punës, u fut një lokacion fleksibël për kryerjen e proceseve të punës, ndarja e personelit kyç në ekipe për kryerjen e proceseve të punës dhe shpërndarja e tyre në lokacione të ndryshme (lokacioni primar, lokacion rezerve dhe punë në kushte shtëpiake), si dhe përshtatje të pajisjeve informatike dhe softuerëve për punë në kushte shtëpiake. Banka Popullore monitoroi në mënyrë aktive situatën me përhapjen e infeksionit¹⁰⁶, rreziqet operative që mund të ndodhin dhe solli vendime për zbutjen e tyre. **Që nga fillimi i krizës është siguruar vazhdimësia e të gjitha proceseve të punës.**

Me qëllim të ngritjes së vetëdijës të të punësuarve për **sigurinë e sistemit informativ, mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar**, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar trajnime për më shumë se 200 të punësuar në Bankën Popullore. Rregullisht kontrollohej përputhshmëria e punës me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, gjendja dhe siguria e informacionit të klasifikuar, si dhe përputhshmëria e Bankës Popullore me kontrollet e detyrueshme të sigurisë tek klientët e SWIFT¹⁰⁷. Të dhënat për përputhshmërinë e Bankës Popullore me të gjitha kontrollet e detyrueshme të përcaktuara në Kornizën për kontrolle të sigurisë tek klientët SWIFT ishin të publikuara në kohë në regjistrin përkatës¹⁰⁸.

Me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë me dispozitat e Ligjit të ri dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, u bë identifikimi i akteve nënligjore të brendshme të Bankës Popullore të cilat duhet të kontrollohen nga aspekti i tyre i

¹⁰⁶ Në periudhën prej marsit deri në dhjetor 2020, Shtabi i Krizave i Bankës Popullore ka mbajtur 14 seanca.

¹⁰⁷ (CSCF Assessment Template for Mandatory Controls 2020 v3).

¹⁰⁸ KYC Registry Security Attestation.

përputhshmërisë. U hartua Plan Aksionar për arritjen e përputhshmërisë, sipas të cilit kontrolli i akteve do të përfundonte më së voni deri në fund të marsit 2021, ndërsa përputhshmëria e plotë me ligjin e ri do të arrihej në afatin ligjor të përcaktuar.

Në vitin 2020, Banka Popullore vazhdoi të realizojë misionin dhe vizionin e saj bazuar në Planin Strategjik për periudhën 2020-2022¹⁰⁹. **Ndryshimet klimatike**, si një nga kërcënimet më të mëdha globale, po fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi në aktivitetet e bankave qendrore, si institucione me përgjegjësi shoqërore. Duke pasur parasysh këto trende, Banka Popullore plotësoi Planin Strategjik për periudhën 2020-2022¹¹⁰ me përfshirje të aktiviteteve për monitorim dhe menaxhim me rreziqet e ndryshimeve klimatike, si dhe analizë të ndikimeve të rreziqeve të cilat dalin nga ndryshimet klimatike mbi sistemin bankar. Me këtë, Banka Popullore, si institucion me përgjegjësi shoqëror, do të përpiqet të jetë shembull dhe të kontribuojë në krijimin e një ekonomie "të blerët" dhe të qëndrueshme, e cila në fund do të siguronte një standard më të lartë të jetesës dhe do të përmirësonte cilësinë e jetës së qytetarëve. Duke marrë parasysh rrethanat e jashtëzakonshme në të cilat ka funksionuar Banka Popullore gjatë vitit 2020, u bë rishqyrtimi i realizimit të aktiviteteve programore për vitin 2020 sipas objektivave të caktuara strategjike, me çka është vërejtur se nuk ka devijime të theksuara në raport me atë që është parashikuar, përkatësisht pritet se pjesa më e madhe e aktiviteteve programore do të realizohet. Aktivitetet programore¹¹¹ përcaktuan më konkretisht proceset e punës dhe aktivitetet projektuese, të cilat i referohen arritjes së objektivave strategjike. Me qëllim të zbatimit efikas të projekteve që janë mbështetja kryesore për arritjen e objektivave dhe detyrave të Bankës Popullore, u bë përmirësimi i rregullave për udhëheqje me projekte përmes futjes së kriterit të seleksionit dhe përdorimi i metodës agile të projektet për zhvillimin e zgjidhjeve softuerike.

Lidhur me menaxhimin e **rreziqeve operative**, në vitin 2020 është bërë një vlerësim i thelluar i ekspozimit të punës së Bankës Popullore ndaj rreziqeve operative. Me këtë u bë rishqyrtimi dhe vlerësimi i madhësive të rreziqeve, bazuar në probabilitetin dhe pasojat e mundshme të një ngjarjeje të rrezikshme, ndërsa janë të definuara edhe planet me masa për ballafaqim me rreziqet operative, për shkak të parandalimit të ngjarjeve të cilat mund të ndikojnë mbi arritjen e objektivave, rezultate financiare dhe reputacionin e Bankës Popullore. Në përputhje me rekomandimet nga bashkëpunimi teknik me FMN-në, u bënë ndryshimet më kornizën e menaxhimit me rreziqe operative për një monitorim më të shkathët të ekspozimit ndaj rreziqeve operative. Andaj, në përputhje me praktikën më të mira të punës së korporatave, parashikohen edhe aktivitete të mëtejshme për të përmirësuar efikasitetin e kornizës së menaxhimit të rreziqeve operative.

Funksioni i përputhshmërisë punoi në përgatitjen e akteve të brendshme për punën e funksionit të përputhshmërisë dhe në aktet për raportim të brendshëm të mbrojtur në Bankën Popullore. Ajo koordinoi dhe mori pjesë aktive në procesin e hartimit të Kodit të ri të Etik të Bankës Popullore në pajtim me përvojat e BQE-së, bankave të tjera qendrore evropiane dhe në pajtim me rregulloret nacionale. Në baza të rregullta tregonte për rrezikun e mundshëm të mos harmonizimit të propozim rregullave nënligjore të Bankës Popullore dhe në kërkesë të udhëheqësisë së Bankës Popullore hartonte mendime juridike. Në periudhën e gjendjes së jashtëzakonshme në RMV, lindi nevoja për monitorim të intensifikuar dhe informim

¹⁰⁹ Në muajin prill, u rishqyrtua struktura e përgatitjes dhe revidimit të planit strategjik në kontekst të përvojave dhe praktikave të bankave të tjera qendrore në këtë fushë. Në bazë të analizës së bërë, janë bërë ndryshime në Rregulloren për planifikim strategjik dhe operativ, ashtu që në vend të revidimit vjetor të planit strategjik u përcaktuar kornizë kohore e planit strategjik të Bankës Popullore të jetë me vlefshmëri prej 3 vite, ndërsa nëse në periudhën e kohëzgjatjes së saj ndodhin ndryshime më të rëndësishme në mjedisin, parashihet mundësia e rishqyrtimit, përkatësisht miratimit të Planit strategjik të ri.

¹¹⁰ [Plani strategjik i Bankës Popullore për vitin 2020-2022](#).

¹¹¹ [Programi i punës për vitin 2021](#).

të rregullt të udhëheqësis dhe të punësuarve për zgjidhet ligjore të reja të miratuara që prekshin punën e Bankës Popullore, për të cilat funksioni i përputhshmërisë në kohë i dorëzonte informacionet.

Funksioni i përputhshmërisë kreu kontrolle për përputhshmërinë e punës me rregullat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësim të punës brenda tyre. Njëherit, bëri monitorim të rekomandimeve të dhëna të përputhshmërisë nga vitet paraprake. Kontribut të tij dha edhe në procesin e vlerësimit të rreziqeve operative të Bankës Popullore në vitin 2020, veçanërisht në aspektin e rreziqeve që rrjedhin nga mospërputhja etike ose ligjore.

Me qëllim të përmirësimit dhe zhvillimit të funksionit të përputhshmërisë në Bankën Popullore, në nëntor 2020, misioni ekspert i TAIEX u realizua nga bankat qendrore të Sllovenisë dhe Austrisë me temën "Forcimi i përputhshmërisë me standardet dhe parimet etike evropiane". Në përputhje me rekomandimet nga bashkëpunimi teknik, janë ndërmarrë aktivitete për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të funksionit të përputhshmërisë në Bankën Popullore.

Për llogaridhënie dhe transparencë ndaj Këshillit të Bankës Popullore, për aktivitetet e ndërmarrura dhe punën e funksionit të përputhshmërisë, si dhe për përputhshmërinë në Bankën Popullore në periudhën 2019-2020, funksioni i përputhshmërisë ka përgatitur Raport vjetor për përputhshmërinë në nivel të Bankës Popullore e cila iu dorëzua Këshillit.

11.5. Aktivitete të tjera të korporatës

Në sferën e **evidencave të kontabilitetit dhe raportimit financiar**, gjatë vitit 2020, vazhdimisht u përmirësua funksionimi, ashtu që u përpiluan propozim - ndryshime dhe plotësime të politikeve dhe rregullave të kontabilitetit të Bankës Popullore. Gjithashtu, u bë ndryshim i disa akteve të brendshme që rregullojnë procesin e planifikimit operativ, si dhe aktet që kanë ndërlidhen drejtpërdrejt me procesin e planifikimit dhe kontrollit financiar. Në lidhje me **projektet**, u realizua Projekti për auditimin e vendosjes së Komitetit të Auditimit dhe harmonizimi me rekomandimet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira për rolin dhe detyrat e këtij organi në bankat qendrore. Është përpiluar informacion krahasues për vendosjen e Komitetit të Auditimit në bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare dhe Bankën Popullore. Me qëllim të përmirësimit të procesit të regjistrimit në Bankën Popullore, u shqyrtuan përvojat për mënyrën e kryerjes së regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve të më shumë banka qendrore, pas çka u miratua rregullore e re.

Gjatë vitit 2020, **furnizimet publike** janë realizuar rrjedhshëm dhe në kohë për shkak të funksionimit të pandërprerë të punës së Bankës Popullore, madje duke mbajtur llogari edhe për shfrytëzimin racional dhe efikas të fondeve të Bankës Popullore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar transparencës, nxitjes së konkurrencës dhe sigurimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, si parime bazë të këtij procesi, të përshkuara me ligj. Plani vjetor i furnizimeve publike (PVFP) për vitin 2020 është publikuar në Sistemin Elektronik të Furnizimeve Publike. Në mars 2020, u miratua Udhëzuesi i ri për realizimin e furnizimeve në Bankën Popullore, me të cilën u bë harmonizimi me Ligjin e ri për Furnizime Publike ("Gazeta Zyrtare" nr. 14/19) dhe aktet nënligjore në këtë fushë. Në bazë të Udhëzuesit të ri për realizimin e furnizimeve në Bankën Popullore, janë përforcuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm në bashkëpunim me njësitë organizative të përfshira, ndërsa në mënyrë të hollësishme janë parashikuar edhe mënyra e realizimit të furnizimeve të cilat paraqesin përjashtim nga Ligji për Furnizime Publike. Në fushën e planifikimit janë vendosur udhëzime më të qarta për afatet e planifikimit të procedurave, si dhe përmirësim të përfshirjes së të dhënave përmes të cilave

mbikëqyret realizimi i planit. Në fund të vitit 2020, u përgatit dhe miratua Plani vjetor për furnizime publike për vitin 2021.

Mbështetja juridike është ofruar në vazhdimësi, përmes ndihmës juridike në hartimin dhe shqyrtimin e akteve ligjore dhe nënligjore, akteve juridike të përgjithshme dhe individuale, memorandumeve të bashkëpunimit, protokolleve, marrëveshjeve dhe kontratave të Bankës Popullore, si dhe mendime juridike konsistente për nevoja të caktuara.

Aktivitetet për **mirëmbajtje teknike dhe sigurim fizik**, si mbështetje logjistike për funksionet e tjera të Bankës Popullore, u zhvilluan në përputhje me kushtet e reja të krijuara për shkak të krizës së koronës. U ndërmorën një sërë masash specifike në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke ofruar udhëzime për të punësuarit në pajtim me mesat dhe rekomandimet e Qeverisë dhe Shtabit të Krizave të Bankës Popullore punonjësit në përputhje me masat dhe rekomandimet e Qeverisë dhe Shtabit të Krizave të Bankës Popullore.

Aktivitetet për ngritjen dhe përmirësimin e rregullores në fushën e sigurisë përmes përditësimeve, ndryshimeve dhe plotësimeve të akteve, kanë filluar dhe pritet të përfundojnë gjatë vitit 2021.

Qëllimi strategjik 11 - Ruajtja e sistemi dhe përmirësimi i tij në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare

Edhe këtë vit në kushte jashtëzakonisht të veçanta pune, Banka Popullore i ndërmori të gjitha aktivitetet e nevojshme për mbajtjen e **sistemit informatikë stabil**, me çka u sigurua shkallë më e lartë e qasjes të sistemit informues dhe mundësoi funksionimin e pandërprerë dhe zbatimin e rregull të detyrave të punës në kuadër të të gjithave njësive organizative të Bankës Popullore. Me përhapjen e virusit të koronës në vend, që nga fillimi i vitit 2020, Banka Popullore u përball me një sfidë të vërtetë në një periudhë relativisht të shkurtër për të mundësuar punë nga shtëpia për një numër të madh të të punësuarve¹¹², si një mënyrë e re e punës që u fut pas fillimit të pandemisë. Gjithashtu, për shkak të funksionimit të pandërprerë të punës, ndërsa në të njëjtën kohë duke mbajtur llogari për mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve, u fut shërbimi i ri; dhoma për telekonferenca. Me këtë u zvogëluan kontaktet, pasi mbledhjet mbaheshin nëpërmjet internetit. Gjatë vitit, u paraqit nevoja për ndryshime urgjente dhe të paplanifikuara të disa aplikacione ekzistuese për shkak të përshtatjes së tyre ndaj masave për tejkalimin e krizës së koronës (p.sh. shtyrje e pagesave të kësteve të kreditëve), e cila u realizua në kohë të shkurtë në mënyrë cilësore dhe relative. Gjithashtu u punua në **projektet e zhvillimit të softuerit**, dhe përveç aktiviteteve aktuale dhe urgjente për shkak të krizës shëndetësore, **u vazhdua në përmirësimin e infrastrukturës SWIFT**, në përputhje me rekomandimet e SWIFT dhe mirëmbajtjen e rregullt vjetore. Lidhur me ruajtjen e nivelit të lartë të sigurisë së informacionit duke vendosur dhe përmirësuar masat për mbrojtje nga sulmet e mundshme informative, **Banka Popullore vazhdoi me aktivitetet për testimin e sigurisë së IT-sistemit**, gjatë të cilës nuk u konstatua mundësia për depërtim në sistem nga jashtë. Gjithashtu, kanë vazhduar kontrollat e brendshme, të cilat kontribuojnë në forcimin e sigurisë së bankës dhe kontrollin e cënueshmërisë së sistemit nëpërmjet një mjeti të automatizuar.

¹¹² Rreth 300 të punësuar, përkatësisht mbi 68,2% patën mundësi të punojnë nga shtëpia me qasje të aplikacioneve të nevojshme për realizimin rrjedhës të detyrave.